

“MINAT” NË RRUGËN DREJT EVROPËS



Koha në të cilën po jetojmë është një kohë e integritimeve të ndryshme dhe të rëndësishme për kombin tonë në përgjithësi. Në rrugën e këtyre integritimeve padyshim se na presin sfida të mëdha dhe në anën tjetër duhet të lirohemi nga shumë vese negative me të cilat do të kemi shumë vështirë të dëshmojmë, se ne jemi për ndryshime.

Kur jemi te pengesat që na dalin në këtë rrugë zakonisht nga elita jonë dëgjojmë analiza të ndryshme, të cilat në njëfarë mënyre na alarmojnë për minat e vendosura në këtë rrugë dhe të cilat në qoftë se nuk mënjanojnë me kujdes, padyshim se mund të na kushtojnë shumë më tepër se vetëm mosintegrimi atje ku jemi nisur. Nuk është për t'u habitur kur elita e një populli e kryen me përgjegjësi detyrën që ka marrë përsipër ndaj popullit të vet dhe i mëson ata se cilës rrugë duhet të mësyjnë për të dalë nga errësira në dritë. Por ajo që na bën të çuditemi është kur nga kjo elitë dëgjojnë zëra se njëra nga këto mina përmes së cilës mund të minohet në tërësi procesi i integritimeve mbarëkombëtare është identiteti fetar i shqiptarëve muslimanë.

Për çudi, një identitet i cili për një kohë të gjatë na ka bërë faktorë të rëndësishëm, jo vetëm në zhvillimet rajonale, por edhe ato ndërkombëtare, tashmë jo vetëm që na duhet ta harrojmë, por edhe ta konsiderojmë si një aksident të historisë sonë mbarëkombëtare.

Madje edhe në rastet kur nga elita evropiane dërgohen mesazhe të qarta se identiteti nuk diskutohet, por pengesë kryesore është “korrupsioni, luftërat e pafundme ndërmjet partive, mosgarantimi i të drejtave, ndërhyrjet në drejtësi dhe media etj.”, ata megjithatë këmbëngulin se zgjidhja për shqiptarët qëndron në fshirjen e kujtesës kolektive, kur bie fjala për identitetin fetar dhe hapja e një faqeje të re të një kombi në tërësi. Nga ky popull kërkohet pothuajse që ai të zhvishet nga vlera, të cilat megjithë zbehjen e tyre kanë bërë që të na mbetet një pikë nderi e burrërie.

Prandaj në vend që kjo elitë të jetë shpresa e tij, e cila me besim të madh në vetvete dhe në vlerat që bart do ta udhëheqë drejt integritimeve të dobishme dhe do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e tij, mu ajo e injoron veten dhe vlerat që ka duke menduar se me injorimin e vetes, madje edhe të prezantimit të rrejshëm të saj do të mund të arrihet ndokund.

Në anën tjetër disa të tjerë duke mos qenë të vetëdijshëm, se edhe ata janë pjesë e rëndësishme e kësaj elite, madje në disa raste edhe vendimtarë për shumë zhvillime parapëlqejnë për veten e tyre të qëndruarit në periferi, duke u bërë kështu pjesë e problemit e jo pjesë e zgjidhjes.

Kjo situatë më kujton rastin e dijetarit të madh Imam Ahmedit nga i cili u kërkua të heqë dorë nga një e vërtetë, të cilën pushteti i asaj kohe dëshironte të ishte ndryshe. Atëherë ky dijetarë duke qenë i bindur në veten e tij, se ajo që ai po prezanton është e vërteta, atyre që i kërkuan atij një kompromis në dëm të së vërtetës iu drejtua me këto fjalë: **“Në qoftë se të pandershmia e përhapin vazhdimisht të pavërtetën, ndërsa në anën tjetër të diturit e heshtin të vërtetën, atëherë më thoni se kur do të vijë koha që ky popull ta njohë atë që është e vërteta.”**

Shpresoj që këto fjalë të arta të këtij dijetari të madh të lëkundin sadopak ambiciet tona për ta ngritur zërin jo vetëm që të dëshmojmë se ajo që ne po flasim është e vërteta, por edhe për shkak të këtij populli të ngratë, i cili nuk po mundet ende të dalë jashtë laboratorëve të eksperimenteve të ndryshme e lëre më të integrohet ndokund më tutje.

Në emër të redaksisë: Enis RAMA

AKTUALE

Mediet dhe “shpëlarja e trurit” **3-7**
Regjimi Iranian dhe shtirja e madhe! **8-11**

KËNDI IM

“Feja e shqiptarit është...” **12-18**
Islami dhe elitat shqiptare **19-21**
Mënyrat e përfitimit **22-24**

AKIDE

Kur vizita e varreve kthehet në idhujtari! **25-28**

FIKH

Betimet – rregulla dhe sqarime **29-31**

AVANCIMI PERSONAL

Propozime kreative **32-35**

LIBRI

Prijësi i drejtë dhe asket
Omer Bin Abdulaziz **36-38**

FAMILJA

Fëmijët dhe gurbeti **39-40**
Shqiptarja dhe mbulesa e saj fetare **40-43**

TEFSIR

Kush e nderoi këtë popull **44-46**

HADITH

Ëmbëlsia e imanit **47-50**

BOTA ISLAME

Irani, a thua sa është islamik? **51-54**

FETVA DHE KONSULTIME

Nacionalizmi dhe racizmi nuk kanë prioritet
para Fesë Islame **55-57**

HISTORI

A e pranuan islamin me dhunë? **58-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,

Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: albislam@gmail.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhironlogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.revista-albislam.com

MEDIET DHE “SHPËLARJA E TRURIT”

Në këto media vihet re qartë një bajraktarizëm për të qenë “më katolikë se papa”, ndryshe sipas menaxhuesve të tyre, nuk mund të kapen trendet globale që sjellin përfitime politike dhe ekonomike

SHKRUAN: JUSTINIAN TOPULLI

Sot po përjetojmë një atmosfere ku propagandohet me të madhe liria e medias dhe pavarësia e saj dhe njerëzit për pasojë mendojnë, se me të vërtetë media është plotësisht e lirë dhe e pavarur. Në fakt këto dy koncepte “liria dhe pavarësia”, në terrenin ku vepron media sot, nuk janë gjithmonë rrjedhoja logjike të njëra-tjetrës. Ndërmjet tyre qëndron barriera e interesit. Dihet se mediet, sidomos ato të fuqishmet, nuk krijohen nga gazetarët, por nga biznese, të cilat kanë interesa politike dhe ekonomike të përcaktuara. Asnjë media në botë nuk mund të sigurojë mbijetesën e saj në mënyrë ta pavarur, pa mbështetjen e njerëzve të biznesit. Kjo nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër çdo biznesmen ka politikën e tij, që assesi nuk mund të cenojë interesat e tij ekonomike dhe politike, përkundrazi duke u nisur nga ky arsyetim



fare i thjeshtë, na bëhet e ditur se asnjë gazetar apo strukturë mediatike, sado e lirë që të jetë, nuk mund të dalë jashtë agjendave që përcaktohen nga punëdhënësi i tyre, ndryshe kjo armë kaq e fuqishme mund të kthehet në bumerang për mbështetësit apo krijuesit e tyre. E thënë shkurt, sot fjala e lirë dhe e pavarur pasqyron aq vërtetësi dhe objektivitet për aq sa ajo nuk bie ndesh me trendin e atyre që dominojnë politikën globale apo lokale.

Nëse hedhim sytë në zhvillimet e sotme globale dhe sidomos ato rajonale vihet re lehtësisht sesi kjo arenë edhe në aspektin mediatik dominohet nga trendet

proglobaliste, proamerikane dhe prope-rëndimore. Por në mediet tona lokale ky trend nuk ndalet vetëm këtu, por në pozitë e të voglit dhe të ndjesisë së inferioritetit, kjo kalon në caqet ekstreme të servilizmit dhe të zellit të hipokrizisë së tejskajshme. Në këto media vihet re qartë një bajraktarizëm për të qenë “më katolikë se papa”, ndryshe sipas menaxhuesve të tyre, nuk mund të kapen trendet globale që sjellin përfitime politike dhe ekonomike. Mendësia e interesit është ajo që ka pushtuar trurin e këtyre njerëzve dhe jo interesi për të vërtetën reale.

Mbas rënies së kampit lindor komunist dhe sidomos mbas ngjarjeve të 11 shtatorit, në arenën perëndimore dhe në atë botërore krahas trendit për përhapjen e globalizmit është bërë shoqërues i pandarë i tij edhe e ashtuquajtura “luftë kundër terrorizmit”. Natyrisht ideologët e kësaj “luftë të re” janë kujdesur mirë që “terrorizmi” në fjalë të marrë fytyrën e Islamit. Këtë objektiv të tyre askush nuk mund ta përmbushë më mirë sesa propaganda mediatike, mjet për të cilin Hitleri shprehej se: “shumë lehtë mund të gënjehej dhe po aq lehtë të besohej”. Duke qenë se kjo luftë kërkon t’i ndajë njerëzit “ose me ne, ose kundra nesh” të vegjlit dhe servilët e interesit, kanë rendur të parët për të rrokur flamurin e atij, që për sytë e shumicës shihet si fitimtari i kësaj beteje të stisur.

Kryesisht nën dritën e këtyre tre elementëve që parashtruan më sipër duhen parë “varësia”, “mungesa e objektivitetit” dhe “dezinformimi”, që karakterizon një pjesë të mirë të aktivitetit mediatik në rajonin tonë, dhe sidomos kur bëhet fjalë për tema, që kanë të bëjnë me Fenë Islame dhe Muslimanët.

“...Në mediet shqiptare i jepet një hapësirë kohe dhe liri shprehje shumë e madhe njerëzve armiqësorë ndaj Islamit, ndërkohë që privohen dhe kufizohen së tepërmi ata që e mbrojnë atë...”

Arti i dezinformimit

Dezinformimi, manipulimi, dhe spekulimet mediatike janë fenomene të hershme në shoqërinë njerëzore. Për këto forma të mashtrimit të njeriut Allahu na ka folur edhe në Kuran. Kështu Zoti ynë na tregon në Librin e Tij, sesi Iblisi arriti të mashtrojë prindërit tanë në xhenet duke ju thënë: *“Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm.” Dhe iu betua atyre (duke thënë): “Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sigurtë!” Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij.”*

Në këto ajete duket qartë se “mashtruesi” ka shfrytëzuar naivitetin njerëzor dhe është shfaqur në pamjen e një këshilltari të sigurtë, pas informacionit të të cilit nuk fshihet ndonjë interes personal, por vetëm e vërteta. Kjo metodë gjen fushë veprimi edhe tek mediet e sotme me emisionet, lajmet dhe dokumentarët televizivë, me të cilët pretendojnë se duan të informojnë publikun për një dobi apo për një rrezik të panjohur më parë prej tyre. Shembull tipik i tyre, kundrejt Islamit duket nga lajmet e rreme, që jepen shpesh për të

¹ Araf: 20-22.

ashtuquajturit “terroristë islamikë”, që zbulohen pa prituri e papandehur në kohë të caktuara, nga organet kompetente dhe që janë sinjerisht në shërbim të sigurisë kombëtare. Rasti më i fundit ishte ai i **Artan Kristos** nga Durrësi, apo jehona mediatike që iu bë para disa vitesh deklarimit të ish-shefit të SHISH-it **F. Klosi**, se studentë shqiptarë që arsimohen në vendet arabe bëjnë shkolla gjysmë ushtarake! Po kështu në këtë linjë mund të përmendet edhe rasti më flagrant i luftës ndaj Irakut, ku e gjithë propaganda u përqendrua tek armët e shkatërrimit në masë, që ai gjoja zotëronte dhe që rezultoi një falsitet i turpshëm kriminal.

Një formë tjetër e manipulimit është mos-publikimi i fakteve që mbështesin një tjetër realitet nga ai të cilin mbështet politika e një medie të caktuar. Allahu thotë për njerëz të tillë: ***“Kush e shpalli Librin që solli Musai si dritë dhe udhërrëfyes për njerëzit?! Librin që ju e keni shpërndarë në fletë, ca prej të cilave i tregoni, ndërsa shumicën e fshihni”***²

Kjo është praktika që njihet me emrin “politika e standardeve të dyfishta”, ku paraqiten vetëm faktet që inkriminojnë kundërshtarin dhe assesi ato që e lehtësojnë apo tregojnë pozitën e tij të pafajshme. Ndërkohë që një politikë mediatike tërësisht e kundërt ndiqet ndaj atij që mbështetet. Rasti tipik është ai i konflikteve të armatosura, si për shembull ai në Palestinë, ku shumë prej medieve perëndimore dhe ato shqiptare janë zëdhënese të njëanshme në favor të shtetit sionist. Apo siç është rasti kur në mediet shqiptare i jepet një hapësirë kohe dhe liri shprehje shumë e madhe njerëzve armiqësorë ndaj Islamit, ndërkohë që

“A. Kristo i akuzuar për “terrorizëm” kishte kritikuar lavdërimin e Bin Ladenit, ndërsa nga ana e disa medieve u paraqit e kundërta, sikur të ishte ai që e lavdëronte Bin Ladenin!...”

privohen dhe kufizohen së tepërmi ata që e mbrojnë atë.

Një formë tjetër e manipulimit është deformimi i fakteve dhe falsifikimi i tyre, në mënyrë të atillë që të favorizojnë dikë apo të inkriminojnë dikë tjetër. Allahu thotë në Kuran: ***“Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla.”***

Shtrembërimi këtu përfshin dy anë: shtrembërimin e drejtpërdrejtë të tekstit ose të faktit, si dhe shtrembërimi nëpërmjet interpretimit të gabuar. Mediet tona janë të mbushura me tilla forma manipulimi, një rast tipik skandaloz është edhe ai fundit ku A. Kristo i akuzuar për “terrorizëm” kishte kritikuar lavdërimin e Bin Ladenit, ndërsa nga ana e disa medieve u paraqit e kundërta, sikur të ishte ai që e lavdëronte Bin Ladenin! Meqë jemi tek ky shembull mund ta marrim atë edhe si fakt të shtrembërimeve në interpretime, ku A. Kristos një ligjëratë ku ai ka folur për xhiadin iu interpretua nga mediet si thirrje për terrorizëm!

Formë tjetër e manipulimit mediatik është edhe përzierja e fakteve të vërteta me ato të pavërteta, pasi kështu është më i lehtë

² Enam: 91.

³ Maide: 13.

“Unë nga lajmet politike që jepen nëpërmjet gazetave dhe TV marr vetëm 20% të tyre, ndërsa 80% që mbetet janë thjesht vetëm gënjeshtër dhe dezinformim...”

kalimi i tyre tek masat e gjera. Allahu thotë në Kuran: **“Mos e përzieni të vërtetën me të pavërtetën, dhe të vërtetën mos e fshihni me vetëdije.”** Dhe natyrshëm përzierja e gënjeshtërës me të vërtetën, nuk bën gjë tjetër vetëm se fsheh një të vërtetë më të madhe. Shembull për këtë mund të marrim deklaratimet e shpeshta mediatike, se në Shqipëri ka pasur “elementë islamikë” ekstremistë të ardhur nga bota islame, që kërkonin të kryenin akte terroriste në Shqipëri dhe të krijonin baza për aktivitetin e tyre terrorist në Evropë. Si argument për këtë paraqitej fakti, se ata kishin qenë njerëz të kërkuar apo edhe të dënuar në mungesë në vendet e tyre të origjinës. Ky fakt ishte i vërtetë, por siç do të shpjegojmë më pas po nëpërmjet medieve dy nga ish shefat e SHIK-ut, **B. Gazidede** dhe **F. Klosi** ishte se këta njerëz ndonëse ishin larguar nga vendet e tyre për arsye që thuheshin, ata nuk kishin ardhur në Shqipëri për të përmbushur ndonjë mision apo aktivitet terrorist, por thjesht kishin gjetur strehë për t’i shpëtuar ndjekjes së shteteve amë, duke u punësuar në shoqata të ndryshme arabe-islame. Mirëpo vitet kaluan dhe në mendjet e shqiptarëve u regjistrua vetëm e vërteta e shtrembëruar, ndërsa e vërteta

kaloi pa bërë aspak jehonë. Në një intervistë që CNN zhvilloi me **Zbigniew Brzezinski**, para luftës së Gjirit, ish-këshilltar për sigurimin kombëtar amerikan në presidencën e Niksonit, i cili u shpreh se: “Unë nga lajmet politike që jepen nëpërmjet gazetave dhe TV marr vetëm 20% të tyre, ndërsa 80% që mbetet janë thjesht vetëm gënjeshtër dhe dezinformim.”

Një tjetër formë është zhveshja e një ngjarje apo realiteti të caktuar nga ambienti, atmosfera apo konteksti, ku ajo ka lindur dhe është zhvilluar dhe më pas paraqitja e saj në kushte krejt të tjera dhe në një ambient krejt tjetër, në mënyrë të atillë që kjo ngjarje të kontrastojë dukshëm negativisht apo pozitivisht, sipas interesave të caktuara. Këtu si argument fetar mund të përmendim fjalën e Ibën Omerit, i cili shprehej shumë negativisht për havarixhët, sepse ata ajetet e Kuranit që kishin zbritur kohë më parë për jomyslimanët i aplikonin mbi besimtarët muslimanë! Apo më qartë se kjo është shprehja proverbiale e Aliut për këta njerëz, ku si slogan të tyre ngrinin fjalën e Zotit **“gjykimi i takon vetëm Allahut”** duke thënë: “Thonë të vërtetën, por nëpërmjet saj kërkojnë të pavërtetën”. Pra, se ajeti me të cilin ata argumentoheshin për të zhvlerësuar apo edhe për të nxjerrë nga feja sahabët ishte vërtetë fjala e Allahut, por se kjo fjalë ishte nxjerrë jashtë kontekstit kuranor për t’iu veshur një ngjarje që s’kishte të bënte fare me të. Kështu për shembull nga mediet e sotme ky lloj manipulimi kryhet me mjeshtërinë më të madhe, në lajme, reportazhe dhe dokumentarë të ndryshëm. Skena e ngjarjes apo e realitetit në këto raste vendoset e copëzuar dhe e shpërndarë në një atmosferë komentesh të ngjyrosura me një ngjyrë të

■
⁴ Bekare: 42.

caktuar, pozitive ose negative, të cilat në realitet nëse do të vendoseshin në truallin dhe ambientin e tyre real nuk do të kishin të njëjtin konotacion apo frymë, që atyre kërkohet t'u vishet me pa të drejtë. Kështu për shembull sulmet e “terroristëve islamikë” ndaj Izraelit, paraqiten nën një atmosferë që sundohet nga dëshira për të jetuar në paqe e këtij shteti dhe e drejta e tij për të ekzistuar, ndërkohë që anashkalohen apo ceken fare përciptazi dhuna e përditshme që provojnë palestinezët, embargo, shpronësimi, persekutimi, diskriminimi, shpërngulja dhe prishja e shtëpive... etj., duke i dhënë kështu rezistencës palestineze pamjen e një egërsire që kërkon të shqyejë çdo gjë të butë dhe të djeg çdo gjë të gjelbër!

Një tjetër formë e manipulimit është fryrja e një ngjarje apo një realiteti të caktuar tej përmasave të tij reale. Allahu thotë në Librin e Tij të shenjtë: ***“O Ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën! Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij...”***⁵ Një formë të tillë manipulimi me publikun ne e shohim nga shumë tituj bombastikë, që mbushin faqet e gazetave tona përditë, ndërkohë që realiteti është krejt ndryshe. Tituj si për shembull “Allahu” prish kishat” për disa mbishkrime murale që ishin bërë mbi ikonat në muret e kishave të Voskopojës. Apo “Al-Kaeda, zbulohen shtatë llogari bankare në Shqipëri” dhe kjo për llogaritë bankare të **Jasin El-Kadiut**, një biznesmeni saudit, që deri më sot nuk i kanë gjetur asnjë fakt, që të tregojë lidhjen e tij të supozuar me Al-Kaedën. Ndërsa një e përditshme tjetër po për këtë fakt shprehej “Al-Qaeda financues e një klani

biznesmenësh në Shqipëri”! apo “Terrorizmi, pranga islamikut shqiptar” për arrestimin e A. Kristos. “Hoxha” i fshatit, prodhues bombash” për një besimtar që vdiq aksidentalisht nga një lëndë shpërthyesë, që ai përdorte për të zënë peshk etj... Tituj të tillë i gjen kaq shumë në mediet tona të përditshme, saqë është e vështirë t'i numërosh.

Një formë tjetër është mungesa e profesionalizmit në mbledhjen e lajmeve. Kjo shfaqet jo vetëm nga mënyra sesi trajtohen ato, por sidomos kur lajmet kanë të bëjnë me Islamin dhe muslimanët, përcillen në mënyrë fare amatore dhe pa përgjegjësi për verifikimin e lajmit që përhapet. Allahu thotë në Kuran: ***“O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.”***⁶ E rëndësishme për këta njerëz është fakti se: edhe nëse është thashetheme, përderisa ai përbën lajm që tërheq vëmendjen duhet përhapur sa më shpejt, aq më tepër kur ky lajm prek një komunitet që vazhdimisht është nën sulmin e medieve.

Këto janë disa nga format e manipulimit mediatik që iu serviren masave të popullit, natyrisht dhe nuk janë të vetmet. Sot mënyrat e “shpëlarjes së trurit” janë kthyer në një art më vete, të cilat për shkak të lehtësisë së shpërndarjes, masivitetit dhe përthithjes vihen më së shumti në zbatim nëpërmjet mjeteve të informimit publik. Ato e kryejnë më së miri manipulimin e opinionit publik, për ta futur atë në hullitë e interesave të tyre ekonomike dhe politike. ■

⁵ Nisa: 171.

⁶ Huxhurat: 6.



REGJIMI IRANIAN DHE SHTIRJA E MADHE!

Para se të filloj me temën, të cilën synoj ta shtjelloj dua t'ju përcjell pikë së pari teorinë e rrejshme të armiqësisë së regjimit iranien me Perëndimin dhe Izraelin, dhe të argumentoj të kundërtën, duke ofruar para jush prova e dëshmi faktike dhe historike, me qëllim që të mos mbeten vetëm fjalë të pretenduara

PROF. HAMID IBËN HALEF OMERI

Pasi gjërat në Iran filluan të dalin nga kontrolli i regjimit në pushtet, **Hamenei** i ndjeu dridhjet e karriges së vet dhe kjo erdhi si rezultat i tërmetit që çoi në manipulimin e zgjedhjeve presidenciale, kurse regjimi iranien për pak muaj u shndërrua në njerëz të armatosur me armë konvencionale dhe këto armë ishin dy llojesh:

1. Shkopinj të trashë vdekjeprurës. 2. Tukje¹ (shtirje) dhe hipokrizi politike, që do të thotë; hyrje në luftë me vendet perëndimore dhe Izraelin nëpërmjet deklaratave dhe akuzave bombastike në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e njerëzve nga kriza që po kalojnë. Faktet tregojnë se kjo nuk është hera e parë që regjimi iranien i kthehet kësaj strategjie, por historia e saj është e vjetër sa edhe vetë revolucioni i Homeinit! Kjo strategji është e dështuar, edhe më shpejt se

¹ Tukje do të thotë shtirje, por në terminologjinë Shiite ka të bëjë me fshehjen e pikëpamjeve dhe të ideologjisë së tyre para të tjerëve, duke u shtirë si muslimanë të devotshëm dhe duke i fshehur pikëpamjet e tyre për t'i tërhequr njerëzit e për t'i bërë shiitë.

“Irani i ka ndihmuar shumë amerikanët në luftën e tyre kundër Afganistanit dhe Irakut. Po të mos ishte bashkëpunimi i Iranit, nuk do të kapitullonin aq lehtë Kabuli dhe Bagdadi...”

sa do të shkruhen këto rreshta, dhe kjo për të heshtur zërin e zhurmshëm të popullit, që ende mbahet peng për t'i bindur ata, me pretekstin se të gjitha këto kundërshtime të brendshme janë nga ndërhyrja e vendeve perëndimore dhe e Izraelit në punët e tyre të brendshme. Por udhëheqja sioniste ka njoftuar për mbështetjen dhe përshëndetjet që i ka drejtuar revolucionit, përveç kësaj ata kanë deklaruar qartë se do të kontribuojnë, që të vendosin sa më shpejt marrëdhënie diplomatike me kreun, posa që ai të fitojë.

Larg nga ngjarjet që po ndodhin në Iran unë do të doja të shqyrtoj paksa historinë ekspansioniste të regjimit në Iran me këtë lloj tujke (shtirje) politike, për suksesin e tij në fushën e propagandës dhe përfitimit sa më të madh prej saj. Para se të filloj me temën, të cilën synoj ta shtjelloj dua t'ju përcjell pikë së pari teorinë e rrejshme të armiqësisë së regjimit iranian me Perëndimin dhe Izraelin, dhe të argumentoj të kundërtën, duke ofruar para jush prova e dëshmi faktike dhe historike, me qëllim që të mos mbeten vetëm fjalë të pretenduara.

Prej dëshmimeve historike është skandali i njohur (Iran Gate), ose historia e bashkëpunimit ushtarak midis Iranit dhe Amerikës, që ndodhi në vitet e 80 të shekullit të kaluar me rastin e pushtimit të Ambasadës Amerikane në Teheran. Kur lufta e fjalëve

kishte arritur kulmin mes dy vendeve, Homeini me ndjekësit e tij vazhdonin mallkimin e atij që e quanin “Djali i Madh”. Presidenti Iranian, **Ebulhasan Beni Sadër** në Paris bëri një marrëveshje me zëvendës-presidentin George H. W. Bush në prani të përfaqësuesit të Mossadit, **Ari ben Minascia**, për t'i shitur Iranit lloje të përparuara të armëve amerikane nëpërmjet Izraelit, për t'u përdorur nga ushtria e Iranit në luftën e saj kundër Irakut, për një shumë prej 1.217.410 USD. Ky rast na u zbulua në dokumente të lëshuara nga U. S. Arkiva e Sigurisë Kombëtare Amerikane, më 10/11/2006, me gjithë detajet e rëndësishme në lidhje me këtë rast. Prej argumenteve është edhe deklarata e ish-zëvendës-presidentit iranian për çështjet ligjore dhe parlamentare **Mohamed Ali Abtahi**, në përfundim të kongresit “**Gjiri dhe sfidat e ardhshme**”, i cili u mbajt në emiratin e Abu Dabit në 13/1/2004, kur ai u shpreh me fjalët se: “Irani i ka ndihmuar shumë amerikanët në luftën e tyre kundër Afganistanit dhe Irakut. Po të mos ishte bashkëpunimi i Iranit, nuk do të kapitullonin aq lehtë Kabuli dhe Bagdadi.” Ndoshta do të duket edhe më qesharake se si forcat amerikane në Irak morën përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e presidentit iranian gjatë vizitës së tij në Irak vitin e kaluar, ata u përkujdesën në maksimum ndaj tij, që nga mbërritja e deri në largimin nga vendi!

Për sa i përket nivelit të marrëdhënieve ndërmjet Iranit dhe Izraelit do të mjaftonte deklarata e Ministrit të Punëve të Jashtme në qeverinë Netanjahu, **David Levy**, kur ai tha: “**Izraeli nuk ka thënë ndonjëherë se Irani është armik.**” Gazeta “Ha'aretz” 1/6/1997” Sharon në kujtimet e tij shkruan: “Nuk kam parë nga shiitet armiqësi ndaj Izraelit për një kohë të gjatë, armiqet tanë të vërtetë janë organizatat terroriste palestineze” Kujtimet e

Sharonit, një përkthim i Antoine Obeid- fq. 576” Fakti qëndron se ne këtë temë nuk ka vend për të sjellë më shumë argumente, dokumente apo deklarata. Ai që dëshiron ta bëjë këtë, nuk do ta këtë të vështirë, për shkak se ekzistojnë me dhjetëra dokumente dhe artikuj të botuar në internet, e që merren ekskluzivisht me këtë aspekt. Për fat të keq ka ende të atillë, që beson se Irani është ai që mbanë flamurin e xhihadit dhe të rezistencës kundër Amerikës dhe Izraelit, kjo fatkeqësi nuk mbetet e kufizuar vetëm tek masa e gjerë e popullit, por ka përfshirë edhe shtresat e intelektualëve!

Pyetja përsëri mbetet, çfarë e shtyn Iranin për të krijuar armiqësi me këto shtete? Dhe pse nuk deklarohet për marrëdhëniet e tij me ato si në kohën e “Shah-ut” (Reza Pahlevit)? Dhe pse këto vende shkëmbejnë deklarata armiqësie false? Në dukje qëndron, - ndërsa Allahu e di më së miri-, se në shfaqjen e Iranit si kundërshtar i Amerikës apo i Izraelit ka interesa të përbashkët për to, sepse me këtë arrihen dy objektiva:

I: Është ajo që disa janë shprehur si- “nevojë ekzistenciale për Izraelin”, është e ditur se Izraeli si gjithmonë paraqitet me petkun e dobësisë nga rreziku i pashmangshëm dhe i rrethuar nga një mur shtetesh armiqësore, që mund të marrë ndihma dhe armë nga kombet e mëdha perëndimore, dhe kemi parë se si bota bëhet aleat i saj për të parandaluar furnizimin me armë të Hamasit .

II: (Kjo është ajo që është e fshehtë për shumicën, pra tukje) Shkëlqimi dhe propaganda e shiitëve, me qëllim që të konkurrojnë ndaj Islamit Sunit, që nuk është i pranuar për projektin perëndimor, dhe kjo mund të kryhet nëpërmes paraqitjes së medhhebit shiit, si medhheb që ngrihet mbi bazën kryesisht në parimin e revolucionit dhe rezistencës ndaj armikut. Shumica jonë e kemi ndierë këtë ndikim me deklaratat e

zjarrra të **Nasrullah-ut** dhe **Nexhad-it** të përsëritura vazhdimisht kundër Izraelit. Ky objektiv përshkallëzohet nën qëllimin e madh amerikan që orvatet për të sjellë një ekuilibër mes forcave të rajonit, që të përdoren si mjete për të goditur njëri-tjetrin, dhe nga efektet e këtij qëllimi ka qenë vetë synimi i Amerikës që t’i japë shtrirje Iranit në Irak, për shkak të shumicës sunitë që Amerika dëshiron t’i frenojë ata. Të njëjtën një gjë e shohim në Liban, me qëllim dobësimin e sunive atje dhe t’i bëjë udhëheqësit e tyre aleatë të Amerikës. Realiteti flet dhe aludon se armiqësia iraniane kundër Amerikës dhe Izraelit në pjesën më të madhe mbetet vetëm retorikë boshe e kërcënimeve të pabaza, që nuk tregojnë asnjë lëvizje apo ndryshim real, përveç manovrimeve taktike. Sa i përket kërcënimeve në mënyrë specifike doja të përmend përleshjet e Hezbollahut me Izraelin, të cilat kanë dhënë prova se janë përleshje taktike të kodifikuara dhe të lidhura me llogaritë iraniane e jo diçka tjetër, dhe nuk ka prapa saj ndonjë fitore për umetin. Cili do të ishte komenti i Hezbollah-ut rreth asaj që ndodhi në Gaza gjatë agresionit të fundit sionist mbi ta. Mund të kuptohet nga ai që ndjek strategjinë e këtij organizimi, se qëllimi ka qenë të vendoset në Libanin jugor si një alternativë e milicisë së krishterë, e cila ka dështuar që të kufizojë veprimtarinë e grupeve palestineze në Liban, sepse ajo është më e aftë për të penguar grupet e armatosura palestineze që kanë qasje në pikat e kontaktit me armikun. **Dikush mund të pyesë: A nuk është Irani përkrasë i Xhihadit në Palestinë?** Ovacionet iraniane që vërejmë sot ndaj lidershit të Hamasit dhe Fatahut në Palestinë, nuk mund të jetë gjë tjetër vetëm se një manipulim politik i radhës nga ana e tyre. Unë mendoj se njerëzit e Hamasit janë shumë të zgjuar, që të mundet t’i mashtrojë Irani. Irani nuk jep diçka për hir të Zotit, kush i vrau palestinezët dhe i dëboi nga Iraku dhe i shtyri

të largohen nga shtëpitë e tyre e të jetojnë në hapësira pa kulm mbi kokë. Ai që i bëri këto në Irak nuk mund t'i mëshiroj në Palestinë. I nderuari vëllai im lexues, duhesh të jesh i sigurt se marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara, Izraelit dhe Iranit janë marrëdhënie të bashkëpunimit strategjik dhe jo e kundërta, unë do të ngre një pyetje që kërkon prej teje një qasje objektive.

1. Sa luftëra kanë shpërthyer midis Iranit dhe Amerikës, ose Izraelit, që prej fillimit të revolucionit e deri tani? Realiteti tregon që Amerika vetëm ka vazhduar luftërat kundër armiqve historikë të Iranit, Afganistani, i cili ende shkakton zemërimin racor iranian, për shkak të rënies së shtetit safavit nga duart e afganëve (1722-1729). Edhe për atë që sot po përballet Irani me Safavitët e ri, dhe kështu Irani mbetet një vend i sigurt për shkak të aftësive të tij nga përfitimi pikëtakimeve mes projektit të tij “të shtirjes” dhe projektit amerikan, këto pika që administrata e re e Obamës disa prej tyre i ka nxjerrë haptazi, nëpërmjet mbledhjeve të koordinimit të pozicioneve kundër Talibanit. Çfarë e lidh Iranin me Izraelin në mënyrë specifike? Ka nga ata që e shohin se kjo lidhje është më e lashtë se sa krijimi i këtyre dy shteteve. Hebrenjtë ende ndjehen mirënjohës ndaj persianëve, për shkak të komandantit persian “Siriusi i Madh”, që i lroi hebrenjtë nga robëria në Babiloni, ku dhe është gjetur një organizatë hebraike e të rinjve në Teheran nën emrin “Siriusi i Madh!” Është e çuditshme, se çifutët persianë janë ata që e derdhin më shumë gjakun e palestinezëve se të tjerët. Ish-zv. presidenti i qeverisë izraelite **Shaul Mofaz**, hartues i planit ushtarak për t'u përballur me rezistencën palestineze, e cila pati si rezultat masakrën në Nablus dhe Xhenin është persian i lindur në Teheran në vitin 1948. Familja e tij kishin emigruar në Palestinë në vitin 1957 dhe **Dan Halutz**, ish-shef i forcave ajrore izraelite me nofkën

“Gjenerali i konspiracioneve”, që dhe shënoi një nga masakrat më të rënda në korrik të vitit 2002, kur ai urdhëroi bombardimin e një ndërtese banimi për vrasjen e një udhëheqësi të Hamasit, ku ranë viktime 14 civilë dhe u përfshinë 9 fëmijë, është i fundit që i përket familjes së emigrantëve hebrej nga “Hageori” Iranian.

Së fundi, duke konfirmuar atë që u përmend më sipër, se nuk ka armiqësi reale (ideologjike) midis Iranit dhe këtyre vendeve, por kjo nuk ekziston as në doktrinën e medhhebit imamije (ithna asherije), që inkurajon për një armiqësi të tillë. Unë nuk mund të mohoj ekzistimin e disa mosmarrëveshjeve të interesave mes Iranit dhe këtyre shteteve, apo konkurrencës në vendet ku kanë influencë. Këto lloj mosmarrëveshjesh mund të zgjidhen me pakte politike, përkundër asaj që mosmarrëveshjet ideologjike, të cilat nuk mund të përfundojnë me marrëveshje politike. Kjo vlen edhe për mosmarrëveshjet, që lindin nga rrymat e këtyre dy projekteve, atij shiit dhe amerikan, në botën arabe dhe veçanërisht në vendet e Gjirit, dhe kështu është e lehtë të vihet re bashkëpunimi dhe koordinimi mes properëndimorëve dhe rrymave sektare në këto vende, kundër rrymave sunite.

Pyetja mbetet: A do të ketë sukses edhe kësaj radhe sistemi ekspansionist i shtirjes me mashtrimin e popullit të tij, ashtu siç kanë mashtruar më herët, dhe që arriti të mashtrojë edhe shumë muslimanë emocionalë? Një popullsi, të cilët jetojnë përafërsisht 14 milion njerëz nën kufirin minimal të varfërisë (në bazë të raportit të Bankës Qendrore Iraniane), e cila është lodhur me humbjen e burimeve të saj mbi zgjerimin e projekteve të hartuara nga ata që kanë vënë turbanë mbi kokat e tyre .■

Përshtati: Rashit ZYLFIU



“FEJA E SHQIPTARIT ËSHTË...”

një ushtri e tërë shkrimtarësh, gazetarësh, opinionistësh, intelektualësh, politikbërësish janë angazhuar për deformimin e realitetit historik, shpërfytyrimin e normave të Fesë Islame, dezinformimin e opinionit publik mbi gjoja pasojat që la Islamizimi i shqiptarëve

SHKRUAN: ISMAIL BARDHOSHI

Tashmë jemi mësuar që herë pas here të dëgjojmë ndonjë deklaratë, koment, prononcim, debat apo të lexojmë ndonjë

artikull gazete, ose librin e ndonjë përfundimori të përkthyer në shqip, ku kërkohet që muslimanët shqiptarë të reformojnë doktrinën dhe rregullat e Islamit, me qëllim që sipas tyre të përshtatet me realitetin ku ndodhet sot kombi shqiptar,

me fazat dhe proceset që ne po kalojmë, me sfidat që na presin në të ardhmen, me civilizimin perëndimor etj. Për ta bërë sa më të prekshme çështjen që po trajtoj më duhet të theksoj se tashmë në adresë të titullarëve dhe predikuesve të Fesë Islame bëhen jo vetëm akuza, por edhe kërkesa për t'i dhënë Fesë Islame një frymë të re të ashtuquajtur properëndimore, pasi gjithnjë sipas tyre, në të kundërt Islami që kemi trashëguar, apo që po na vjen nga vendet arabe do të bëhet pengesë për proceset që tashme kanë nisur. Është fare e qartë se ky projekt nuk është më thjeshtë një thirrje drejtuar hoxhallarëve, por në fakt një ushtri e tërë shkrimtarësh, gazetarësh, opinionistësh, intelektualësh, politikbërësish janë angazhuar për deformimin e realitetit historik, shpërftyrimin e normave të Fesë Islame, dezinformimin e opinionit publik mbi gjoja pasojat që la Islamizimi i shqiptarëve, ose që mund të ketë një devocion i mundshëm fetaro – islam në trojet shqiptare, duke synuar që nga njëra anë të parandalojnë masivizimin e njohjes dhe praktikimit të Islamit, dhe nga ana tjetër të ushtrojnë trysni dhe fobi mbi predikuesit e Islamit. Faktikisht muslimanët ndeshen kudo në botë me përpjekjet dhe propagandën e pareshtur për krijimin e një fryme fetare Islame të re, që në thelb duhet të shkëputet nga Islami burimor, por duke marrë parasysh kushtet gjeografike, politike dhe strategjike te trojeve tona, ballafaqimi bëhet akoma më i nxehtë dhe më i ndërlikuar.

Disa nga idetë apo projektet për formimin e kësaj fryme janë si më poshtë:

Normat etike–ligjore islame kanë qenë të përshtatshme për kohën kur filloi përhapja e Islamit, pasi në krahasim me qytetërimet dhe legjislacionet e mëparshme legjislacioni Islam është më i përparuar, por krahasuar me stadin e sotëm të lirive dhe të drejtave të njeriut, ku ka arritur civilizimi perëndimor

është i prapambetur, kështu që muslimanët duhet të bëjnë ndryshime dhe reforma rrënjësore për t'iu përgjigjur kërkesave të civilizimit bashkëkohor. Ky është mesazhi që jepet në shumë shkrime.

Përafrimi mes feve kryesore në trojet shqiptare nën pretekstin e ruajtjes dhe konsolidimit të traditës së tolerancës fetare. Një angazhim ky për të cilin bëhen takime të rregullta dhe të niveleve të ndryshme. Kjo nismë në thelbin e saj synon të krijojë frymën e lartpërmendur të një Islami, që nuk do të ketë lidhje esenciale me burimet e tij dhe do të eliminojë dallimet e veçoritë mes feve, çka me kalimin e kohës do të çojë në një shkrirje dhe asimilim gradual të identitetit të komunitetit musliman. Në fakt, toleranca dhe bashkëjetesa mes komuniteteve fetare në Shqipëri është pa më të voglin dyshim një traditë që e kanë krijuar muslimanët ndër shekuj, pasi sipas mësimave të Fesë Islame njeriu nuk detyrohet të ndryshojë fenë me dhunë, por toleranca fetare përdoret si një ombrellë për të realizuar qëllimin që cekëm më lart.

Propaganda intensive se shqiptaret janë pjesë e familjes perëndimore dhe për këtë arsye duhet të përqafojnë të gjitha ato, që sipas tyre quhen vlera perëndimore, madje duke deklaruar shpeshherë se jemi kthyer në familjen e vlerave perëndimore, apo se duhet të kapim nivelin e kulturës perëndimore.

Hoxhallarët e shkolluar në vendet arabe përbëjnë një rrezik për drejtimin që ka marrë kombi shqiptar, sepse sipas tyre po adaptojnë modelin e islamit arab, i cili është intolerant dhe i prapambetur.

Muslimanët duhet të ndjekin shembullin e të krishterëve në ndarjen e fesë nga sistemi i jetës.

Islami është shkaku i peripecive dhe prapambetjes së popullit shqiptar. Ai është shkaku që Perëndimi na sheh me dyshim,

prandaj: ose duhet të çrrënjohet, ose duhet të reformohet, në mënyrë që të bëhet i pranueshëm për Evropën.

Duhet të ndalohet dërgimi i studentëve në vendet arabe dhe të hapet një universitet në vendin tonë për përgatitjen e hoxhallarëve dhe kuadrove tanë, me qëllim që të mënjanohet Islami i modelit arab dhe të formohet një islam që përputhet gjoja me evropianizimin e shoqërisë shqiptare. Në fakt, do të ishte me interes hapja e një universiteti për përgatitjen e kuadrove këtu, sepse nevoja është e madhe, por ç'të keqe ka të shkojnë besimtarët muslimanë për të marrë dije në universitetet e vendeve arabe!?

Është e kuptueshme, se hedhja e këtyre ideve, ose angazhimi për zbatimin e këtyre projekteve vjen, ose nga dashakeqësia, ose nga mosnjohja e realitetit të Islamit. Por ajo që është me rëndësi të nxirret në pah në një përballje të tillë është realiteti i Fesë Islame, pasi në këtë mënyrë njerëzit do të arrijnë të kuptojnë sesa qëndrojnë idetë e mësipërme dhe se kush janë qëllimet e atyre që i parashtrojnë ato. Në fakt, sqarimi i realitetit, burimeve dhe synimeve të Islamit është një temë shumë e gjerë, porse këtu mund të cekim disa fakte në mënyrë shumë të përmblodhur për këto teza të hedhura vitet e fundit pas demokracisë.

Islami është feja që Allahu i Lartësuar zgjodhi për njerëzit, sikurse thuhet në Kuran: ***“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.”*** (Maide 3). Fjala Islam nga ana gjuhësore do të thotë: dorëzim dhe nënshtrim. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: ***“Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtroni Atij, para se t’ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t’ju ndihmojë kush.”*** (Zumer 54). Megjithatë në këtë ajet flitet për nënshtrimin e vullnetshëm ndaj Allahut të Lartësuar, në tekstet e shenjta

“...toleranca dhe bashkëjetesa mes komuniteteve fetare në Shqipëri është pa më të voglin dyshim një traditë që e kanë krijuar muslimanët ndër shekuj...”

vërejmë se fjala “Islam” është përdorur edhe për nënshtrimin e pavullnetshëm ndaj Allahut, që në fakt është një rrjedhim i pashmangshëm i ligjësive hyjnore. Kështu, sipas kuptimit të fundit të gjitha krijesat janë të nënshtruara ndaj Allahut, përfshi muslimanin dhe jo-muslimanin, të devotshmin dhe të shthururin, ngaqë të gjitha janë të dorëzuara plotësisht ndaj urdhrave dhe ligjeve të Allahut për krijim, formim, rregullim dhe harmonizim. Kjo do të thotë se çdo gjë në qiej dhe në Tokë ndodh dhe lëviz në zbatim e në harmoni të plotë me urdhrat dhe ligjësitë hyjnore. Ata që besojnë apo përqafojnë fe të tjera veç Islamit, jo vetëm që kundërshtojnë ligjet fetare, zbatimin e të cilave varet nga vullneti i tyre, por shkojnë edhe në kundërshtim me ligjet e krijimit dhe të formimit, e prandaj Allahu Fuqiplotë thotë: ***“A mos kërkojnë ata fe tjetër në vend të fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i nënshtrohen të gjithë krijesat në qiej dhe në Tokë, me hir e me pahir, dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?!”*** (Ali Imran 83).

Nga ana fetare termi “Islam” përdoret, edhe me kuptim të përgjithshëm, edhe me kuptim të veçantë e përjashtues. Kuptimi i përgjithshëm është: Dorëzimi ndaj Allahut, duke adhuruar vetëm Atë, duke iu nënshtruar atij me respekt, duke u dëllur e distancuar nga shirku (shokvënia ndaj Allahut, idhujtaria) dhe idhujtarët. Në këtë

përkufizim përfshihen të gjithë Pejgamberët dhe enbijatë (lajmëtarët), si dhe pasuesit e tyre të drejtë, kështu që sipas këtij kuptimi përfshirës feja e të gjithë Pejgamberëve, enbijave dhe pasuesve të tyre të drejtë ka qenë Islami. Ata të gjithë quhen muslimanë. Duke bërë të ditur se feja e të gjithë enbijave është një, Pejgamberi thotë: *“Enbijatë janë vëllezër për babë; nënat e tyre janë të ndryshme, por feja e tyre është një”*. Kjo do të thotë se feja dhe besimi i tyre është i njëjtë, edhe pse legjislacionet i kanë pasur të ndryshme. Kësisoj Feja Islame me kuptimin e përgjithshëm përfshin çdo umet, që ka pasuar me saktësi e përpikëri Pejgamberin, apo lajmëtarin, që ka qenë i dërguar nga Allahu posaçërisht për ta e ndër ta. E rrjedhimisht, pasuesit e drejtë të Teuratit para abrogimit të legjislacionit të Teuratit quhen muslimanë, të dëlirë, të distancuar nga idhujtaria (hunefa), në fenë e Ibrahimit, në Islam. Po kështu quhen edhe pasuesit e drejtë të Isait *alejhi selam*, para dërgimit të Muhamedit *alejhi salatu ue selem*. Nuk ka asgjë për t’u habitur, kur themi se feja e Pejgamberëve ka qenë vetëm një dhe ajo është Islami, sepse besimi, parimet dhe vlerat në të cilat ftonin ata kanë qenë të njëjta. Madje edhe parimet dhe synimet e përgjithshme të legjislacioneve të tyre kanë qenë unike. Thirrja që bënë të Dërguarit e Allahut bashkohet të paktën në këto tri pika:

Besimi se Zoti është një dhe se vetëm Ai meriton të adhurohet.

Besimi në profetët dhe në të gjitha lajmet e sjella prej tyre, si dhe zbatimi i mësimëve të tyre, si rruga e vetme kjo që të çon tek Allahu. Këtu fjala vjen mund të përmendim: namazin, zeqatin, agjërimin, xhihadin, drejtësinë, besnikërinë, ndershmërinë, pajisjen dhe promovimin e vlerave dhe virtyteve të larta dhe ndalimin e paturpësive dhe veseve të ulëta.

Njohja e njerëzve me gjendjen e tyre pas

vdekjes, si: besimi dhe pohimi i ringjalljes, botës tjetër, jeta e varrit, dënimi dhe begatimi në varr, fazat në të cilat do të kalojnë njerëzit në Ditën e Gjykimit, shpërblimi dhe ndëshkimi, xheneti dhe xhehenemi.

Atëherë edhe pse legjislacionet e pejgamberëve janë të ndryshme ato përputhen në ftësën për në teuhid, në realizmin e asaj që është në interes të njerëzve dhe në inkurajimin për sjellje dhe moral të lartë.

Allahu i lartësuar thotë: **“Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta zbuloi ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain...”**. [Esh Shura: 13]. **“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që tu thoshte): Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!”**. [Nahël: 36]. **“Ibrahimi nuk ka qenë, as hebre, as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë në një zot, musliman, i përlur ndaj Allahut dhe nuk ka qenë nga idhujtarët.”** [Ali Imran: 67].

“Thuaj: “O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se njëri-tjetrin nuk do ta mbajmë për zot, në vend të Allahut!” Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuajuni: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!” [Ali Imran: 64]

Ndërsa Islami me kuptim të veçantë dhe përjashtues është ai me të cilin u dërgua Muhamedi *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*, që përmban Sheriatin (legjislacionin) e Kuranit, sepse ky legjislacion i shfuqizoi të gjitha legjislacionet e mëparshme, kështu që kushdo që pason Muhamedin quhet musliman, ndërsa ai që e kundërshton atë nuk quhet musliman, qoftë edhe nëse pretendon se ndjek ndonjë pejgamber të mëparshëm. Për rrjedhim, nëse përmendet fjala “Islam” pa ndonjë përcaktim, ajo pa dyshim shënon vetëm Sheriatin që solli i

Dërguari ynë *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*. Dihet që Muhamedi është i dërguari i fundit për njerëzit dhe xhinët. Mesazhi që përçoi i Dërguari ynë është i vlefshëm dhe i detyrueshëm për çdo kohë dhe çdo vend deri në Ditën e Kiametit. Pas dërgimit të Muhamedit *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*, askujt nuk do t'i vlejë dhe nuk do t'i pranohet besimi, puna dhe adhurimi, nëse nuk e pranon atë si të dërguar dhe nuk i kryen veprat në përputhje me udhëzimet e tij. Për këtë fakt, Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju.” [A’raf: 158]. “Padyshim se feja e vërtetë dhe e pranuar tek Allahu është vetëm Islami.” [Ali Imran: 19]**

Ata që kërkojnë prej muslimanëve të shkëputen nga e kaluara dhe të sajojnë një frymë fetare të re, që sipas tyre do të përputhej me aspiratat evropiane, nisen nga ideja se:

Së pari, legjislacionet fetare qiellore në përgjithësi dhe Feja Islame në veçanti nuk janë hyjnore, por produkte njerëzore, që kanë ardhur si përgjigje ndaj kërkesave të kohës kur janë themeluar.

Së dyti, se njeriu ka aftësi logjike për të nxjerrë ligje, të cilat japin drejtësi dhe garantojnë jetë të qetë e të lumtur.

Së treti, se normat fetare që zbatuan të dërguarit dhe posaçërisht i Dërguari ynë Muhamedi *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*, duke qenë se janë produkt njerëzor kanë qenë të përshtatshme dhe të dobishme në të kaluarën, por ato nuk mund t'i përgjigjen kërkesave të kohës, nuk vlejnë për zgjidhjen e problemeve të sotme dhe nuk arrijnë stadin e zhvillimit dhe të përparimit bashkëkohor.

Si përgjigje për të gjitha këto mund të përmendim në mënyrë shumë të përmbledhur disa prej veçorive të normave fetare, që solli Muhamedi *paqja dhe*

“...Nuk ka asgjë për t’u habitur, kur themi se feja e Pejgamberëve ka qenë vetëm një dhe ajo është Islami, sepse besimi, parimet dhe vlerat në të cilat ftonin ata kanë qenë të njëjta...”

lavdërimi qoftë mbi të, për njerëzit:

1. Normat etike dhe ligjore që solli Muhamed *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*, nuk janë produkt njerëzor, por janë shpallur nga Allahu i Lartësuar. Kështu që feja, doktrina dhe normat për të cilat kërkohet të ndryshojnë nuk janë njerëzore apo tokësore, por hyjnore. Burimi i tyre i vetëm është Allahu i Lartësuar, ndërsa Muhamedi *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*, thjeshtë ua ka kumtuar njerëzve sipas shpalljes hyjnore. Duke qenë se legjislacioni që solli dhe zbatoi Muhamedi *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*, është hyjnor, ai assesi nuk mund të përmbajë ndonjë gabim, që domethënë se nuk mund të jetë kontradiktor, nuk mund të zhvlerësohet dhe nuk mund të jetë në dëm të njerëzve. Ndërsa ligjet që prodhon njeriu sado i gjykueshëm dhe i arsyeshëm të jetë dhe sado të përpiqet për të qenë objektiv, do të rezultojnë me të meta dhe me mangësi, madje shpeshherë edhe me pasoja të rënda për nevojat jetike të njerëzve. Kjo, sepse kapaciteti intelektual i njeriut është i kufizuar. Njeriu nuk e kapërcen dot dimensionin e kohës dhe të vendit ku jeton. Për më tepër që njerëzit kanë prirje, mide, shije dhe kapacitete të ndryshme, e rrjedhimisht atë që e shikon të arsyeshëm e të dobishëm njëri nuk e shikon të tillë tjetri.

Ligjvënësi në mënyrë që të prodhojë ligje e norma të drejta duhet të plotësojë disa kushte, si:

- Të njohë mentalitetet, prirjet, dëshirat dhe nevojat e njerëzve në të gjithë hapësirën kohore dhe vendore, në mënyrë që ligjet të jenë të vlefshme e të përshtatshme për të gjithë dhe të zgjidhin hallet e problemet e të gjithëve, gjë që njeriu nuk e arrin dot.

- Te jetë i zhveshur nga interesat, prirjet dhe dëshirat personale, në mënyrë që të mënjanojë subjektivizmin, por edhe këtë njeriu nuk e plotëson dot.

Pikërisht për këtë arsye ligjet e nxjerra nga njerëzit nuk janë të qëndrueshme e objektive, nuk garantojnë drejtësi për të gjithë, nuk sjellin stabilitet dhe qetësi për të gjithë. Ajo që vërejmë aktualisht është dëshmia më e madhe për këto që po themi.

2. Shenjtëria dhe pacenueshmëria. Muslimanët i zbatojnë normat etiko-ligjore me kënaqësi dhe respekt, sepse janë të vetëdijshëm se burojnë nga Ai që e di më mirë, se çfarë është në dobi të njeriut dhe çfarë është në dëm të tij.

3. Globalizmi. Njerëzit e të gjitha kombeve, ngjyrave, kohëve dhe vendeve rrjedhin nga një njeri i vetëm që është Ademi *alejhi selam*, dhe Feja Islame duke qenë se është shpallur nga Krijuesi i të gjithë njerëzve e ka kapacitetin që t'i shndërrojë të gjithë njerëzit pa dallim në një komunitet ose bashkësi të vetme, por me kusht që njerëzit të përmbushin qëllimin për të cilin janë krijuar, adhurimin e Allahut të Lartësuar, sipas mësimave të Muhamedit *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*. Shumë sisteme u janë paraqitur njerëzve si të afta për realizimin e diçkaje të tillë, por realisht kanë rezultuar të papërshtatshme, të dëmshme e të dështuara. Sot jemi dëshmitarë të rënies së ideologjisë dhe sistemit komunist, por edhe të dështimit të skemës së sistemit financiar kapitalist.

4. Gjithpërfshirja dhe përsosmëria.

5. Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia. Muslimanët udhëhoqën me normat ligjore islame shumë popuj për shekuj me radhë, ndonëse në vende dhe kohë të ndryshme, duke garantuar për ta drejtësi, qetësi dhe stabilitet, çka përbën një ndër argumentet më të mëdha mbi përfshirjen, përsosmërinë dhe qëndrueshmërinë e kësaj feje.

6. Elasticiteti, fleksibiliteti dhe përshtatshmëria. Kështu, Feja Islame është e përshtatshme për të gjithë njerëzit, në çdo kohë dhe në çdo vend. Përmes rregullave tërësore Feja Islame i jep shpjegim të gjitha fenomeneve, i përgjigjet kërkesave të të gjitha kohëve, zgjidh të gjitha problemet, plotëson të gjitha nevojat ligjore, e kanalizon përparimin dhe progresin material në dobi të njeriut, përputhet me prirjet e natyrshme njerëzore dhe me çdo të vërtetë shkencore. Në këtë drejtim po përmend tre ajete kuranore, të cilët përmbajnë nga një rregull të tërësishëm:

“Allahu do për ju të lehtën dhe jo të vështirën.” [El Bekare: 185].

“Allahu nuk e do prishjen, korrupsionin” [Bekare: 205].

“Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat dhe peshoren e (drejtësisë): që njerëzit të vënë drejtësi dhe të sillen me njëri-tjetrin me drejtësi.” [Hadid: 25].

7. **Drejtësia.** Ligjet e Zotit janë krejtësisht të drejta dhe një ndër aspektet që nxjerrin në pah drejtësinë e ligjeve të Zotit është edhe fakti se ato nuk i trajtojnë njësoj gjërat e diferencuara dhe as nuk bëjnë diferencim mes gjërave të barabarta. Kësisoj, në Fenë Islame drejtësia është parim absolut. Nuk është e mundshme që gjërat apo çështjet e barabarta të mos trajtohen njësoj në Fenë Islame. Këtu mund të japim një shembull: Megjithëse në shumë aspekte Feja Islame e trajton femrën të barabartë me mashkullin,

në disa aspekte për shkaqe absolutisht të arsyeshme dhe të qenësishme, si diferenca në kapacitete dhe në funksione intelektuale, fizike, biologjike, familjare, shoqërore etj., nuk i trajton të barabartë, por megjithatë secili prej tyre ka të drejtat dhe detyrimet e tij. Në këtë mënyrë mbrohet prejardhja gjenealogjike e njeriut, shumëzohen njerëzit, mbrohet nderi, virtyti dhe morali i lartë, arrihet prehja, qetësia mëshira dhe dhembshuria në familje, krijohet familja, ruhen dhe respektohen lidhjet farefisnore, formohet një shoqëri e ndershme dhe e rregullt, bëhet një ndarje e drejtë e të ardhurave në shoqëri, e të tjera synime të larta. Ndërsa po të shohim në krahun e atyre që e trajtojnë femrën të barabartë me mashkullin në të gjitha aspektet, ne do të konstatojmë se synimet e mësipërme nuk mund të realizohen plotësisht. Konstatojmë se:

- fisnikëria dhe nderi nuk mund të ruhen për shkak të marrëdhënieve të paligjshme,

- përqindja e lindjeve bie për shkaqet që dihen,

- familja pothuajse nuk ekziston, për shkak se femrat në masë kërkojnë të punësohen, bëhet një ndarje e padrejtë e të ardhurave në shoqëri dhe fëmijët mund të dalin jashtë kontrollit familjar,

- përhapet shthurja, imoraliteti, prostitucioni, veset e ulëta, bie niveli moral i shoqërisë,

- zbehet lidhja prind – fëmijë dhe mëshira e dhembshuria mes tyre, sepse ato mund të kultivohen vetëm në gjirin e familjes. Këto janë disa nga pasojat e lëvizjes feministe për barazinë gjinore, por ka edhe shumë tjera.

8. Mbrojtja dhe arritja e interesave të njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër. Synimet e Sheriatit Islam vërtiten rreth arritjes dhe kompletimit të gjërave, që janë në dobi të njeriut, si në këtë botë edhe në botën tjetër dhe rreth mënjanimimit apo

“Ligjet që prodhon njeriu sado i gjykueshëm dhe i arsyeshëm të jetë dhe sado të përpiket për të qenë objektiv, do të rezultojnë me të meta dhe me mangësi...”

minimizimit të gjërave të dëmshme, si në këtë botë edhe në botën tjetër. Gjërat që i urdhëron Islami janë: ose tërësisht të dobishme për njeriun, ose janë më shumë të dobishme sesa të dëmshme, dhe po ashtu edhe gjërat që i ndalon janë: ose krejtësisht të dëmshme, ose më shumë të dëmshme sesa të dobishme. Në mënyrë të veçantë Feja Islame mbron interesat jetike të njeriut, si: fenë, jetën, lindjet (shumëzimin e njerëzve, prejardhjen gjenealogjike dhe nderin), mendjen dhe pasurinë.

9. Mesataria.

10. Barazpeshimi mes interesave të individit dhe interesave të bashkësisë.

Një arsye më shumë që muslimanët e trojeve tona të mos ia vënë veshin thirrjeve të lartpërmendura është edhe paaftësia që tregojnë çdo ditë e më shumë ligjvënësit, politikbërësit dhe opinionistët e trevave tona për t'u dhënë zgjidhje problemeve të shumta, prej të cilave vuan dhe ankohet çdo ditë shoqëria jonë, si: krimi, korrupsioni, varfëria e skajshme, prostitucioni, shpërbërja e familjes, numri në rritje i divorceve, vetëvrasjet, padrejtësia, dhuna etj. Ndonëse shpesh krenohen duke deklaruar, se ligjet e hartuara prej tyre janë të shkëlqyeshme problemet e njerëzve sa vijnë edhe shtohen, çka do të thotë se mënyra e vetme për zgjidhjen e tyre janë normat hyjnore. ■

ISLAMI DHE ELITAT SHQIPTARE



mohimi i një pjese të identitetit do të rezultojë edhe me projektim jo të qartë në të ardhmen. Nëse një gjendje e këtillë do të lidhet me elitat shkencore, politike-shoqërore dhe joqeveritare, atëherë ndikimi negativ do t'i përfshijë të gjitha shtresat e kombit në shtrirjen e tyre horizontale dhe vertikale.

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Nuk do mend e as ndonjë analizë të thellë fakti, se pjesa dërrmuese e elitës shqiptare në trojet e saj emërtimin Islam në identitetin e shumicës shqiptare e konsideron si pengesë. Sipas tyre Islami si pjesë e identitetit shqiptar prish kohezionin brenda kombëtar, pengon integritet euroatlantike, i largon shqiptarët nga rrënjët e tyre evropiane... Më kujtohet një deklaratë e **Sali Berishës**, i cili tha se “prova se shqiptarët janë evropianë është qenia e tyre i vetmi popull katolik në Perandorinë Bizantine” dhe konkludimi i

përbashkët me **Nanon** se “për të dëshmuar përkatësinë evropiane të shqiptarëve duhen fshirë 555 vjet histori dhe mbi të gjitha jetë e shqiptarëve, për t'u rilidhur me periudhën e Perandorisë Bizantine”. Zëdhënësi i rikontvertimit katolik të shqiptarëve **Ismail Kadare** këtë hap e arsyeton me arsyen “kombëtare”, ngase Evropa nuk na mbështet pa u kthyer në katolik. Libri me titull “Nacional-islamizmi shqiptar” i autorit **Kastriot Myftaraj** është një provë e vërtetë e asaj që mundet të quhet islamofobi në aksion. Në këtë libër prej mbi treqind faqesh autori e quan Islamin: “asht një fe totalitariste” (fq. 110), një fe e cila e poshtëron njerëzimin: “Që islami është fe e

poshtnimit njerëzor, kjo kuptohet dhe nga fakti që ajo ka adoptu për ritin e faljes, ranien përmbys” (fq. 102). Sipas tij shqiptarët ndodhen para alternatives: “ose Islamin, ose shtetin e bashkum nacional shqiptar’ (fq. 91). Jehonën e këtyre thirrjeve për rikthim tek rrënjët e dëgjojmë edhe në trojet shqiptare jashtë Shqipërisë, por qëllimi i këtij shkrimi nuk është citimi i këtyre fjalëve që dëshmojnë qartë për paragjykimet e elitës shqiptare ndaj Islamit. Duke e vënë në spikamë këtë dukuri globale **Tarik Ramadan** shkruan: “Paragjykimet janë armiku i vërtetë i Islamit. Në të kaluarën mungesa e informacionit ishte shkak i mosnjohjes së kulturave, realiteteve dhe ndodhive. Sot informacionet jo të plota dhe sipërfaqësore krijojnë një iluzion të rrejshëm të diturisë.”

Qëllimi i këtij shkrimi është të riafirmojë nevojën për inkorporimin e vlerës islame në veprimtarinë e elitës shqiptare. Duke folur për identitetin kombëtar të shqiptarëve **Paskal Milo** ka shkruar: “Unë si historian e vlerësoj identitetin kombëtar të shqiptarëve, nuk po flas evropian ose jo, si një produkt të zhvillimit historik. Kombi dhe integriteti kombëtar janë një proces që zhvillohet gradualisht nën efektin e mjaft faktorëve, të cilët kanë si rezultate krijimin e kombit dhe identitetit shqiptar, që përgjithësisht në Ballkan kombet janë mbrujtur në shekullin XIX, por ka pasur tatim që kanë pasur një vonesë historike në mbrujtjen e tyre si komb.” Si pasojë i këtij zhvillimi historik sot shqiptarët, në pjesën dërrmuese të tyre janë një komb tek i cili përbërësi islam është një pjesë e pandarë e identitetit. Përkatesia e tyre fetare është një realitet i jetës së tyre dhe përcaktues i vlerave të tyre si genie shoqërore dhe kombëtare. Prandaj nuk duhet që ky përcaktues i identitetit të vendoset në grupin e tipareve “jo të preferuara” dhe

“...Nëse do të marrim si kriter parimin e racionale, atëherë shumë lehtë do të pohonim, se Islami është një religjion modern, ai nuk e njeh mëkatin e trashëguar, inkarnimin hyjnor e as trinitetin...”

vazhdimisht t’ia “kujtojmë” vetes prejardhjen (e cila si zakonisht ndalet tek ajo fetare) dhe rrënjët. Një tendencë e këtillë ndikon negativisht në vetëdijen kombëtare ngase një person i tillë mbetet në udhëkryq mes së kaluarës dhe së tashmes, i mjegullohet edhe e ardhmja, sepse mohimi i një pjese të identitetit do të rezultojë edhe me projektim jo të qartë në të ardhmen. Nëse një gjendje e këtillë do të lidhet me elitat shkencore, politike-shoqërore dhe joqeveritare, atëherë ndikimi negativ do t’i përfshijë të gjitha shtresat e kombit në shtrirjen e tyre horizontale dhe vertikale.

Islami përgjatë shekujve sipas dëshmimeve edhe të jo muslimanëve, ka qenë motivuesi dhe shtytësi kryesor i një qytetërimi madhështor, që deri sot nuk e ka humbur shkëlqimin e tij, një sistem i mrekullueshëm dhe origjinal idesh, veprash dhe vlerash, i shumëllojshëm por i unifikuar, që përshin të gjitha aspektet jetës individuale dhe shoqërore. Ai ishte nxitësi kryesor i një ndryshimi rrënjësor në aspektin shpirtëror dhe moral, ndryshoi njeriun dhe shoqërinë. Islami prej atyre që e përqaftuan atë nxori një faktor krijimtari me ndikim epokal historik. Një realitet kaq ndikues dhe kaq motivues nuk duhet të mbetet jashtë faktorëve përcaktues të veprimtarisë

elitare. Me mohimin e tij ne lejojmë që të ndikohemi vazhdimisht nga rryma të ndryshme, që i përcaktojnë tiparet e identitetit të “preferuar” dhe të bëhemi një komb që vazhdimisht përdoret për të testuar ide të ndryshme, siç ndodhi me komunizmin.

Prandaj në kohën e globalizimit kur identitetet përcaktohen dhe ri-përcaktohen nën ndikimin e ndryshimeve të shpejta, ndryshime të cilat sipas Gidens-it e detyrojnë njeriun të shpikë mekanizma efektivë për ripërtëritjen e identitetit personal, Islami si botëkuptim ofron shumë parime dhe vlera që jetën individuale dhe atë shoqërore e bëjnë më të lehtë, më të bukur dhe me vizon më të qartë për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Islami nuk është gjë që duhet të na bëjë të turpërohem apo ta mohojmë përkatësinë tonë islame si pjesë e identitetit tonë. **Murad Hofmani** një diplomat gjerman si përgjigje ndaj kërkesës që të flasë për temën: “Çfarë kërkon Islami në Gjermani” ka shkruar: Për këtë lloj pyetjesh amerikanët kanë një terminologji të veçantë. Ajo quhet **loaded question**, që nënkupton përgjigjen negative d.m.th., **këtu nuk ka Islam dhe këtu nuk ka vend për Islamin**. Për këtë shkak e shoh të nevojshme t’ju kujtoj për historinë e gjatë të Islamit në Evropë. Do t’ju kujtoj monumentet e arkitektonike islame në Sicili, Spanjë, në Ballkan dhe në Azinë e mesme. Spanja ka qenë islame për një kohë më të gjatë, se sa është sot katolike. Në Evropë sot jetojnë 30 milionë muslimanë. Në SHBA dhe Kanada numri i muslimanëve është tetë milion. Vetëm në Moskë jetojnë gjysmë milioni muslimanë. Nuk ka dyshim se Islami është këtu. Pas pyetjes në fjalë fshihet paragjykimi i gabuar për Islamin, si një religjion oriental, i cili nuk është i përshtatshëm për Evropën dhe Amerikën. Një pohim i këtillë krijon neveri për shumë

historianë të kulturës, që e dinë shumë qartë se Islami si Hebraizmi dhe Krishterimi vijnë nga Lindja e Afërt, dhe se shkrimet e shenjta janë shpallur në të folmet e së njëjtës grup gjuhësh, atyre semite. Nëse e krahasojmë Islamin me Krishterimin me të drejtë do të konkludonim, se Krishterimi ka shumë më tepër tipare orientale se sa Islami. Inkarnacioni, triniteti, sakramentet, murgjëria, priftëria, qëndrimi negativ ndaj seksuale janë tipare që Krishterimi i ka ngërthyer në vetvete nën ndikimin e religjioneve të Lindjes së Largët. Nëse do të marrim si kriter parimin e racionale, atëherë shumë lehtë do të pohojmë, se Islami është një religjion modern, ai nuk e njeh mëkatin e trashëguar, inkarnimin hyjnor e as trinitetin.

Për ndikimin e Islamit në zhvillimin e kulturës evropiane është e lehtë të gjenden prova. Njerëzit në Perëndim nuk duhet të përkujtohen për sistemin numerik arab, për njohuritë mjekësore etj... Në këto kushte të flitet për Evropë të Krishterë dhe për kulturën e saj judeo-krishtero-perëndimore është një gabim dhe një fyerje ndaj muslimanëve. E vërteta është se duhet të flasim për humanizmin evropian me tiparet e tij hebreje, të krishtera dhe islame. Prandaj Islami jo vetëm që është këtu, por me të drejtë është këtu (në Gjermani).

Njeriu në thelb është një krijesë, e cila vazhdimisht është në kërkim të njohurive më të plota për atë që nuk e njeh. Kjo ia bën atij të domosdoshëm kërkimin e një kuptimi për vetveten, për botën që e rrethon dhe mbi të gjitha për Zotin. Ky është një kërkim thelbësor, të cilit ai nuk mund t’i shmanget. Njeriu i pjekur e di vendin e tij në këtë realitet dhe identiteti fetar, Islami, feja që e ka vërtetuar pamundësinë e përplasjes mes arsyes së shëndoshë dhe shpalljes hyjnore, e ndihmon të arrijë te kjo njohje, që e ia bën të qartë udhën ku ai duhet të ecë... ■

MËNYRAT E PËRFITIMIT

Nuk ka dyshim se zemra zë ndryshk, ashtu sikurse enët metalike prej argjendi, të cilat bëhen të papërdorshme. Kështu që ndryshku i zemrës rafinohet nga dhikri (përmendja e Allahut) i vazhdueshëm

NGA IBËN KAJIM EL XHEUZIJE

Gjashtë rregulla për të mësuar

Janë gjashtë fazat e marrjes së diturisë:

1. Të pyesësh në mënyrën më të mirë.
2. Të qëndrosh i qetë dhe të dëgjosh me vëmendje
3. Të kuptosh mirë
4. Të nxënit përmendësh (memorizimi)
5. Mësimi
6. Veprimi sipas njohurive të marra dhe përmbajtja rreth kufijve të tyre.

Frytet e nënshtrimit

Një nga selefët (gjeneratat e para) tha: “Vërtet një rob mund të kryejë një mëkat dhe të hyjë në Xhenet, ndërsa një tjetër mund të kryejë një vepër të mirë dhe të hyjë në zjarr.” është pyetur: Si ka mundësi kjo? ” Ai u

përgjigj: “Ai që ka mëkatuar mendon vazhdimisht për mëkatën e bërë, kjo i shkakton frikë, pendim, lot, ndihet i turpëruar para Krijuesit të tij të Lartmadhëruar, pikërisht kjo e bën të qëndrojë para Allahut me zemër të thyer, kokulur dhe i nënshtruar. Pra, ky mëkat është shumë më i dobishëm për të, se sa shumë vepra të bindura, ngase kjo ka bërë që të jetë i nënshtruar dhe përlur, që shpie në shërbim të lumturisë dhe suksesit, aq sa ky mëkat të bëhet shkak për të hyrë në Xhenet. Ndërsa kryerësi i veprës së mirë, nuk e llogarit atë si dhuratë nga Zoti i tij, përkundrazi ai bëhet arrogant, mburret me veten e tij e thotë: “Unë kam arritur kaq e kaq”. Pra, kjo gjë e ndihmon në rritjen e mëtejshme të vetëmburrjes, krenarisë dhe arrogancës, derisa kjo të bëhet shkak për shkatërrimin e tij.

Pastrimi i zemrës

Nuk ka dyshim se zemra zë ndryshk, ashtu sikurse enët metalike prej argjendi, të cilat bëhen të papërdorshme. Kështu që ndryshku i zemrës rafinohet nga dhikri (përmendja e Allahut) i vazhdueshëm. Dhikri pastron zemrën derisa ajo bëhet si një pasqyrë me shkëlqim.

Megjithatë kur dhikri braktiset do të thotë që ndryshku është rikthyer, por pastaj kur fillon, zemra nis të pastrohet prapë. Pra, zemra është duke u bërë me “ndryshk” për dy arsye: nga mëkatet dhe gafleti (neglizhenca për përmendjen e Allahut). Gjithashtu pastrohet dhe lustruhet nga dy gjëra, nga Istigfari (kërkimi i faljes) dhe dhikri.

Lufta (xihadi) kundër vetvetes

Lufta kundër “unit” ka katër faza.

1. Të luftoni të udhëhequr nga mësimet e fesë së vërtetë, pa të cilën nuk do të kishte sukses. Në të vërtetë nuk mund të ketë lumturi të vërtetë, as ndonjë kënaqësi në këtë botë apo në botën tjetër, veç përmes saj.

2. Përpjekje për të vepruar sipas asaj që është mësuar, prej diturisë pa veprim nuk do të përfitojmë, ajo do të na shkaktonte më tepër dëm.

3. Përpjekja për të ftuar të tjerët për të mësuar atë që nuk e dinë, përndryshe mund të konsiderohesh prej atyre që e fshehin atë që Allahu e ka shpallur nga udhëzimet me shpjegime të qarta. Njohuritë e tilla nuk sjellin dobi, as nuk e mbrojnë një person nga dënimi i Allahut.

4. Përpjekja për të qenë i durueshëm dhe këmbëngulës kundër atyre që e kundërshtojnë këtë thirrje drejt Allahut dhe ndaj atyre që përpiqen të shkaktojnë dëm. Duke pasur të gjitha këto vështirësi të kemi parasysh sjelljen e durimtarëve për hir të

“Një dijetar nuk mund të quhet i devotshëm deri sa ai të njohë dhe të dijë të vërtetën, ta zbatojë atë dhe t’ua mësojë atë të tjerëve..”

Allahut.

Kur këto faza të jenë përfunduar atëherë një person i tillë konsiderohet të jetë në mesin e të devotshmëve. Selefët janë pajtuar se një dijetar nuk mund të quhet i devotshëm deri sa ai të njohë dhe të dijë të vërtetën, ta zbatojë atë dhe t’ua mësojë atë të tjerëve. Pra, kushdo që ka njohuri, vepron me të dhe ia mëson të tjerëve konsiderohet nga të devotshmit.

Sprovat e zemrës

Ibën Kajimi thotë duke komentuar mbi hadithin vijues: “Sprovat dhe fatkeqësitë do t’i prezantohen zemrës si rrogëz kallami i thurur shkop me shkop. Çdo zemër që i përthith këto sprova do të ketë një shenjë të zezë në të. Çdo zemër që i refuzon këto sprova do të ketë shenja të bardha në të. Kështu që zemrat do të jenë dy llojesh. Njëra do të jetë si guri i bardhë, e cila nuk do të jetë e dëmtuar për sa kohë që toka dhe qielli do të ekzistojnë. Ndërsa tjetra do të jetë e errët dhe e ndryshkur si anija e përmbysur, nuk është në gjendje të njohë të mirën, as të refuzojë të ligën”.¹

Fitnet (sprovat) që i paraqiten zemrës dhe që janë shkak për dobësimin e saj janë: Sprovat që kanë të bëjnë me epshin dhe sprovat që kanë të bëjnë me dyshimet.

Zemrat kur i janë ekspozuar këtyre fitneve janë dy lloje:

¹ Sahih, shih: Sahihu Muslim nr. 144

Lloji i parë: Një zemër, e cila i është ekspozuar këtyre sprovave i thithë ato si një sfungjer që përthith ujë, duke lënë në të një njollë të zezë. Një zemër e atillë vazhdon t'i thithë këto sprova, që i janë paraqitur deri sa të nxihet dhe të prishet. Kështu që pasi ndodhë kjo, dy sëmundje të rrezikshme dhe vdekjeprurëse e mbajnë atë të zhytur deri në shkatërrim.

a) Hutimi për veprat e mira dhe të këqija. As nuk e njeh të mirën, as nuk e refuzon të keqen. Kjo sëmundje mund ta mbajë atë deri në atë masë, saqë ai beson të mirën për të keqe dhe të keqen për të mirë. Sunetin e bën bidat, ndërsa bidatet sunet, të vërtetën të pavërtetë, ndërsa gënjeshtrenë të vërtetë.

b) Duke gjykuar në bazë të tekave dhe dëshirave, edhe përkundër asaj që i Dërguari i Allahut paqja dhe mëshira e Tij qoftë mbi të, erdhi duke i robëruar dëshirat dhe tekat e tij, si dhe udhëheqjen sipas tyre gjithashtu.

Lloji i dytë. Një zemër e bardhë në të cilën drita mbetet e ndritshme dhe shkëlqimi i saj është ndriçues. Pra, kur sprovat i janë paraqitur një zemër të tillë ajo i refuzon dhe largohet prej tyre. Kjo ia rrit edhe me tepër fuqinë e dritës dhe të shkëlqimit të saj.

Katër parimet e adhurimit:

Ajeti **“Vetëm Ty të adhurojmë”** (Ijjake nabudu) është ndërtuar mbi katër parime:

Përcaktimi se Allahu dhe i Dërguari i Tij duan dhe janë të kënaqur me:

- a) Thëniet e zemrës
- b) Të gjuhës
- c) Veprimet me zemër dhe
- d) Veprimet me gjymtyrë

Pra, **el Ubudijeh** (të qenit rob dhe adhurues ndaj Allahut) është një term gjithëpërfshirës për të gjitha këto katër faza, që në të vërtetë realizojnë fjalën **“Vetëm Ty të adhurojmë”**.

- a) Thënia me zemër është besimi për atë

“...Kjo sëmundje mund ta mbajë atë deri në atë masë, saqë ai beson të mirën për të keqe dhe të keqen për të mirë. Sunetin e bën bidat, ndërsa bidatet sunet...”

që Allahu na ka njoftuar në mënyrë të përsosur për sundimin e Tij, rreth emrave të Tij, rreth veprimeve të Tij, engjëjve të Tij, dhe të gjitha ato që Ai ka dërguar me gjuhën e Pejgamberit të Tij paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi te.

b) Thënia me gjuhë është të informojë dhe të përcjellë atë që Allahu e zbriti, për të thirrur në të, për ta mbrojtur atë, për të shpjeguar risitë e rreme, të cilat e kundërshtojnë atë, për të krijuar një memorie, për të transmetuar atë që ai urdhëron.

c) Veprimi me zemër, si: dashuria për Allahun, mbështetja në Te, pendimi tek Ai, duke pasur frikë dhe shpresë tek Ai, duke e bërë fenë krejtësisht në mënyrë të sinqertë për Te. Duke pasur durim në atë që Ai urdhëron dhe ndalon, si dhe duke qenë të kënaqur me Te. Duke pasur besnikëri dhe armiqësi për hir të Tij. Duke e nënshtuar veten para Tij, duke qenë i përlur para Tij, përveç kësaj veprimet e zemrës, janë të lidhura vërtet me veprimet e gjymtyrëve... dhe veprimet e gjymtyrëve pa veprimin e zemrës janë shumë pak të dobishme.

d) Veprimi i gjymtyrëve: si namazi, kujdesi për pjesëmarrje në tubime të hairit, ndihmesa ndaj të paafteve, shfaqja e butësisë dhe mirësisë ndaj krijesave, si dhe vepra të tjera të ngjashme me këto. ■

Përktheu: Burbuqe REXHA

KUR VIZITA E VARREVE KTHEHET NË IDHUJTARI!

Me të vërtetë dijetarët hanefi kanë luajtur një rol të madh në luftimin e idhujtarisë dhe pastrimin e adhurimit për Allahun Një të vetëm e pa shok

SHKRUAN: BLEDAR HAXHIU

Lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve, paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi Profetin tonë, Muhamedin, familjen, shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë me devotshmëri deri në Ditën e Fundit. Po shkruajmë rreth kësaj teme për faktin se sot shumë njerëz kanë rënë në kthetrat e idhujtarisë në të cilën kanë qenë njerëzit para Islamit, dhe për shkak se janë injorantë e konsiderojnë atë si pjesë të fesë apo adhurim të Allahut. Në përpilimin e këtij shkrimi jemi mbështetur në broshurën me titull: **“Vizita e varreve në përputhje me fenë dhe kur ajo kthehet në idhujtari”** të autorit: **Muhjidin Muhamed Berkeviut** nga dijetarët e mëdhenj të medhhebit hanefi, kjo për faktin që të nxirret në pah, se me të vërtetë dijetarët hanefi kanë luajtur një rol të madh në luftimin e idhujtarisë dhe pastrimin e adhurimit për Allahun Një të vetëm e pa shok.

Ky dijetar ndër të tjera thotë në broshurën e tij: “Shumë prej njerëzve në këtë kohë i kanë kthyer disa varre në idhuj, duke u falur në to, duke therur kurbane dhe duke i dedikuar atyre vepra dhe shprehje të cilat nuk janë të denja për besimtarët, ndaj dhe dëshirova që të sqaroj për ta atë që ka ligjëruar Sheriati, në mënyrë që të dallohet

e vërteta nga e kota”. Dije, se lumturia e vërtetë dhe nderi më i madh që mund të arrijë njeriu në këtë botë dhe në tjetrën vjen në sajë të pasimit të Profetit të Allahut, nderimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, porse shejtani, i cili është armik i hapët për njeriun, e devijon atë me kurthet e tij nga rruga e drejtë dhe e fton atë për në gjynahet e mëdha, që të jetë prej banorëve të zjarrit, ndaj dhe qëllimi më i madh tek ai është rrëmbimi i besimit, që më pas të jetë prej banorëve të përjetshëm në zjarrin e xhehenemit.

Nga kurthet më të mëdha në të cilat ai i ka hedhur njerëzit është ajo tek e cila i ka ftuar në kohët e hershme dhe të sotmet, në madhërimin e varreve aq sa më në fund disa i morën ato si idhuj, të cilët i adhuruan në vend të Allahut. Fillimi i kësaj sëmundjeje të madhe ka nisur me popullin e Nuhut alejhi selam, sikurse na thotë Allahu: **“Nuhu tha: ‘O Zoti im, ata më kundërshtuan mua dhe u dhanë pas atyre njerëzve, pasuria dhe fëmijët e të cilëve nuk kanë sjellë gjë tjetër, veç shkatërrimit. Ata kurdisë një kurth të madh, dhe thanë: ‘Mos i lini kursesi zotat tuaj! Mos e lini kursesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën, as Nesrin!’”**¹ Ibën Abasi dhe të tjerët kanë thënë: Këta kanë qenë disa njerëz të mirë ke populli i Nuhut, kur ata vdiqën njerëzit filluan të

¹ Nuh, 21-23

qëndronin te varret e tyre dhe u bënë atyre buste dhe pasi kaloi një kohë ata filluan t'i adhurojnë".²

Kjo ishte shkëndija e parë në adhurimin e idhujve dhe këta njerëz ranë në dy fitne: fitnen e varreve dhe fitnen e busteve/përmendoreve. Këto që të dyja i ka përmendur Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*, në një hadith të saktë që përcillet nga Aishja, se Umu Seleme i përmendi Profetit një kishë, të cilën e kishte parë në Habeshe³ me emrin Maria dhe gjëra të tjera në të, ai tha: *"Ata janë njerëz, që kur u vdes ndonjë njeri i mirë ndërtojnë mbi varrin e tij faltore dhe pikturojnë aty piktura; ata janë njerëzit më të këqij tek Allahu i Madhëruar"*.⁴

Në këtë hadith është përmendur bashkimi midis skulpturave dhe varreve dhe meqenëse shkëndija dhe shkak i adhurimit të idhujve janë varret, atëherë Profeti e parandaloi umetin e tij nga ky lloj sprovimi në mënyra të shumta: prej tyre: Se Profeti ka ndaluar që ato të shndërrohen në xhami sikurse është pohuar një gjë e tillë në librin e saktë të Muslimit nga Xhundub ibën Abdullah Bexheliu, se ai ka dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem, pesë ditë përpara se të vdiste të thoshte: *"Vërtet ata që kanë qenë përpara jush i merrnin varret e profetëve të tyre si faltore, prandaj mos i merrni varret si xhami, sepse unë jua ndaloj një gjë të tillë"*. Ndërsa në të dy librat e saktë përcillet nga Aishja, se Profeti salallahu alejhi ue selem, në sëmundjen e vdekjes tha: *"I mallkoftë Allahu hebrenjtë dhe të krishterët, ata i morën varret e profetëve të tyre si faltore"*.⁵ Duke na tërhequr vërejtjen prej asaj që ata vepruan. Një numër i konsiderueshëm dijetarësh nga të gjitha medhhebet janë shprehur qartë mbi

“Lumturia e vërtetë dhe nderi më i madh që mund të arrijë njeriu në këtë botë dhe në tjetrën vjen në sajë të pasimit të Profetit të Allahut...”

ndalesën e ndërtimit të xhamive mbi varre.

Prej tyre: se Profeti salallahu alejhi ue selem, ka ndaluar vendosjen e kandilave⁶ tek varret sikurse ka transmetuar Ahmedi dhe autorët e Suneneve, nga Ibën Abasi se Profeti salallahu alejhi ue selem, *i ka mallkuar vizitueset e varreve, ata që ndërtojnë mbi to xhami dhe ata që vendosin në to kandila*.⁷ Çdo gjë që e ka mallkuar Profeti, veprimi i saj konsiderohet nga gjynahet e mëdha dhe mallkimi për ndriçimin e varreve ka ardhur për shkak se me këtë veprim ka shpenzime të padobishme të pasurisë, ka shfaqje ekstreme në madhërimin e varreve duke i përngjarë ato me idhujt, ndaj dhe për këtë dijetarët kanë thënë: nuk lejohet që dikush të zotohet për varret se do të japë vaj, qirinj apo çfarëdo gjëje tjetër. Nuk lejohet kryerja e këtij zotimi në mënyrë kategorike, madje as nuk duhet të dhurojë diçka për shkak të varrit, sepse kjo dhuratë nuk është e saktë dhe nuk merret parasysh.

Prej tyre: Ndalimi i lyerjes së varreve me gëlqere dhe ndërtimit mbi to, sikurse na ka përcjellë Muslimi në librin e tij të saktë nga Xhabiri, se Profeti salallahu alejhi ue selem, *ka ndaluar lyerjen me gëlqere të varreve dhe që të ndërtohet mbi to*. Ky ndalim përmban në vetvete dy aspekte: ndalimin e

² Buhariu.

³ Abisini.

⁴ Buhariu.

⁵ Buhariu dhe Muslimi.

⁶ Në kohën tonë neonë, qirinj, apo zbukurime të tjera ndriçuese.

⁷ Ebu Daudi, Nesaiu, Tirmidhiu dhe Ahmedi.

ndërtimit dhe ngritjes së tyre me gurë apo të ngjashme me to,⁸ ndërsa tjetri: që të ndërtohen mbi to tyrbe dhe kube, sepse kjo është vepër e injorancës para-islame.

Prej tyre: Ndalimi i mbishkrimeve në varre, Ebu Davudi ka përcjellë në Sunenin e tij nga Xhabiri, se Profeti salallahu alejhi ue selem, *ndaloj që të shkruhen në varre, apo që ato të ngrihen*.⁹ D.m.th. me dhë tjetër veç dheut që nxjerr vetë varri.⁹ Çdokush që hyn sot nëpër varreza përballet me mbishkrime të panumërta që vihen tek varret, ku disa tregojnë lavde për të vdekurin, disa të tjerë thurin poezi e disa flasin rëndë dhe shajnë edhe Allahun, Allahu na ruajt!

Prej tyre: Ndalimi i faljes në varreza sikurse është përcjellë nga Muslimi në Sahihun e tij nga Ebu Merthed Ganeviu, se Profeti salallahu alejhi ue selem, *ka ndaluar për uljen mbi varre dhe faljen në to*.¹⁰ Ndërsa Ebu Seid Hudriu përcjell se Profeti salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Toka është e gjitha e pastër, me përjashtim të nevojtores dhe varrezave”*.¹⁰ Hadithet që e ndalojnë një gjë të tillë janë të shumta, kjo për faktin se specifikimi i kryerjes së faljes nëpër varreza është i ngjashëm me madhërimin e idhujve, kur dikush bie në sexhde para tyre, ndaj dhe Profeti salallahu alejhi ue selem, i mallkoi hebrenjtë dhe të krishterët, sepse ata i kthyen varret e profetëve të tyre në faltore. Këta njerëz faleshin në vendet ku kishin varrosur profetët, edhe për faktin se mendonin se sexhdeja në varret e tyre ishte madhërim për këto varre dhe kjo është një idhujtari e qartë; prandaj Profeti thoshte: *“O Allah, mos e bëj varrin tim idhull që adhurohet”*.¹¹ Ose duke menduar se drejtimi për nga varret në momentin e faljes është

më i mirë, sepse ndërtohet nga dy gjëra: adhurimi Allahut dhe madhërimi i profetëve dhe kjo është idhujtari e fshehtë.

Prej tyre: Profeti salallahu alejhi ue selem, ka ndaluar që varri i tij të merret si vend feste, pra, që të vizitohet në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike. Na përcillet nga Ebu Hurejre, se Profeti salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Mos i ktheni shtëpitë tuaja në varre dhe mos e bëni varrin tim vend festë, më çoni selam sepse selamet tuaja më arrijnë kudo që të jeni”*.¹² Me këtë hadith Profeti i tërheq vërejtjen besimtarëve, që shtëpitë e tyre të mos i bëjnë si varre duke mos u falur e përkujtuar Allahun në to, përkundrazi njeriu duhet ta gjallërojë shtëpinë e tij me namaz dhe dhikër, duke e dalluar atë nga varret tek të cilat nuk kryhen vepra të tilla. Po ashtu në këtë hadith paralajmërohem dhe na tërhiqet vërejtja për mos-madhërimin e varrit të tij, duke e marrë atë si vend i cili vizitohet në kohë të caktuara, përkundrazi Profeti e nxit umetin e tij që të dërgojnë salavate për të aty ku janë dhe në vendet e tyre, sepse Allahu ka vendosur melaqe, të cilët ia përçojnë Profetit selamet e umetit të tij. Këtë paralajmërim Profeti e bëri nga frika se mos muslimanët bien në gabimin e idhujtarisë – duke ndërmarrë udhëtime me qëllim vizitën dhe madhërimin e varreve -, sikurse ranë në këtë gabim popujt para tyre, të cilët i madhëruan varret e Profetëve, aq sa i kthyen ato në idhuj. Prandaj Profeti salallahu alejhi ue selem, ndër të tjera ka thënë: *“Nuk ndërmerret udhëtimi për adhurim, veçse për në tre xhami: në xhaminë time, në xhaminë e Qabesë dhe në xhaminë Aksa”*.¹³

⁸ Ndërsa në kohën tonë me mermer, qeramikë; ndërtojnë buste, vendosin foto dhe portrete etj.

⁹ Varri sipas Islamit nuk duhet të ngrihet më shumë se një pëllëmbë.

¹⁰ Ahmed, Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe Hakimi. Hadithi është i saktë.

¹¹ Ahmed, Maliku dhe Abdurrezaku.

¹² Ebu Daudi, Sahih Albani.

¹³ Buhariu dhe Muslimi.

Imagjino kur Profeti i Zotit ndalon të bëhet një gjë e tillë me varrin e tij ndërkohë që ai ka qenë njeriu më i mirë që ka shkelur mbi këtë tokë, atëherë çfarë mund të thuash për varret e të tjerëve? Ndaj muslimani duhet t'i thërrasë arsyet dhe të mos bjerë pre e mashtrimeve të shejtanit i cili kërkon nga njerëzit të largohen nga adhurimi dhe madhërimi i Allahut, për t'i hedhur më pas në adhurimin e çdo kotësie ku një nga të cilat janë varret e njerëzve të mirë. Aspekt tjetër që duhet ta pohojmë këtu është fakti se: në momentin që njerëzit i marrin varret e njerëzve të mirë si vende vizite, ata domosdoshmërisht bien në kundërshtime me parimet e larta Islame dhe adhurimin e Allahut. Një, të cilat shqetësojnë çdo kënd që në zemrën e tij ka qoftë dhe një grimë nënshtrimi për Allahun, apo që ka xhelozë për atë që cenon njësimin e Allahut dhe që e urren idhujtarinë.

Nga dëmet e marrjes së varreve si vende pelgrinazhi mund të përmendim: se njerëzit e teprojnë në madhërimin e tyre, i sheh se si që nga larg i përkulen e i nderojnë varret, vendosin ballin e tyre në pjesën e varrit dhe e puthin, kërkojnë prej tyre strehim apo zgjidhjen e problemeve dhe të nevojave, rrotullohen rreth tyre dhe presin për to kurbane; kështu që të gjitha këto veprime që ata ia dedikojnë varreve, nuk janë gjë tjetër vetëm se forma adhurimi, të cilat i përkasin vetëm Allahut, që është i Gjalli i pavdekshëm, Atij që i përgjigjet nevojtarëve dhe që e largon të keqen. Allahu thotë në Kuranin Famëllartë: ***“Nëse nga Allahu të godet ndonjë fatkeqësi, atëherë askush përveç Tij nuk mund të të shpëtojë. E nëse të dhuron ndonjë mirësi, dije se vetëm Ai është i Fuqishëm për çdo gjë”***.¹⁴

■
14 Enam, 17.

15 Junus, 106-108.

16 Zumer, 38.

Ndërsa në një ajet tjetër thotë: ***“Përveç Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm. Nëse do ta bëje këtë, atëherë ti do të ishe vërtet keqbërës. Nëse Allahu vendos që të të godasë ndonjë e keqe, askush nuk mund të ta largojë atë, përveç Tij, e nëse Ai do të të bëjë ndonjë të mirë, s’ka kush që ta pengojë mirësinë e Tij. Ai ia jep atë mirësi kujt të dojë prej robërve të Tij. Ai është Falës dhe Mëshirëplotë. Thuaj: “O njerëz, ju erdhi e Vërteta nga Zoti juaj. Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është udhëzuar për dobinë e vet dhe kush e humb rrugën e drejtë, ka humbur në dëmin e vet, ndërsa unë nuk jam mbikëqyrësi juaj”***.¹⁵

Po ashtu thotë: ***“Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata (paganët) se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën, me siguri që do të të thonë: “Allahu”. Thuaju: “Si mendoni, nëse Allahu dëshiron të më shkaktojë ndonjë dëm, a mund ta largojnë atë idhujt që ju i adhuron krahas Tij?! Po nëse Ai dëshiron të më mëshirojë, a mund ta pengojnë ata mëshirën e Tij?!” Thuaju: “Mua më mjafton Allahu. Tek Ai le të mbështeten ata që kërkojnë mbështetje”***.¹⁶

Ndaj le të jetë ky shkrim një thirrje për të gjithë muslimanët që të kryejnë në varreza vetëm atë që është e urdhëruar, dhe të largohen nga çdo gjë që është e ndaluar, në mënyrë që të jenë të shpëtuar dhe që vizita e varreve të mos kthehet në idhujtari të shëmtuar. E lusim Allahun ta pastrojë besimin tonë dhe të na largojë nga çdo lloj idhujtarie dhe adhurimin tonë ta bëjë vetëm për Allahun të vetëm e pa shok. ■



të gjitha betimet që i dëgjojmë aty-këtu, si: për kokë të nënës, apo babait, apo fëmijëve, për besë, pasha flamurin, për nderin e fraza tjera të shumta janë gabime që duhet t'i mënjanojmë

BETIMET — RREGULLA DHE SQARIME

SHKRUAN: AGIM BEKIRI

Betimi ose të bërit be nënkupton përmendjen e një emri apo cilësie të Allahut për ta siguruar dikë se themi të vërtetën, ose se do të kryejmë një veprim patjetër. Në gjuhën arabe bëhet me pjesëzat: “uav”, “ba” dhe “ta” që i përshtaten parafjalëve të gjuhës shqipe: “për” dhe “pash”. Arabisht thuhet: vallahi, bilahi, tallahi që do të thotë: pasha ose për Allahun. Si shembull betimi, duke përmendur një cilësi të Zotit mund të sjellim një pjesë të hadithit, ku thuhet: *“Zjarri vazhdimisht do të përsëris: A ka më (njerëz për të hyrë në të), derisa Zoti Krenar të vendosë këmbën e Tij në të e atëherë do të thotë: pasha krenarinë Tënde, mjaft, mjaft”*¹

Sipas pikëpamjes së besimit islam ndalohet rreptësisht betimi te dikush tjetër

pos Allahut pa marrë parasysh, sa i shtrenjtë është ai në të cilin betohemi, ngase i madhëruari i vetëm i denjë është Allahu, kurse krijesat nuk mund të madhërohen deri në atë shkallë saqë të betohemi në to. Mu për këtë i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Ka bërë kufër ose shirk ai që betohet në dikë tjetër pos Allahut”*². Nga kjo kuptojmë se të gjitha betimet që i dëgjojmë aty-këtu, si: për kokë të nënës, apo babait, apo fëmijëve, për besë, pasha flamurin, për nderin e fraza tjera të shumta janë gabime që duhet t'i mënjanojmë. Betim mëkatar apo i gabuar gjykohet edhe kur përmendim një frazë pa pasur qëllim betimin, siç bëjnë disa njerëz, të cilët shpeshherë betohen në Qabenë, Profetin, ndonjë të dashur të tyre, edhe pse ai mund të mos ketë për qëllim betimin. Për të kuptuar sa mëkat i madh është betimi në dikë tjetër pos Allahut do të përmendim fjalën e Abdullah ibën Mesudit,

¹ Buhariu dhe Muslimi

² Tirmidhiu

që ka thënë: “Për mua më e dashur është të betohem në Allahun rrejshëm, se sa në dikë tjetër me sinqeritet.”³ Kjo thënie e tij na tregon shumë, sidomos nëse marrim parasysh se betimi në Allahun rrejshëm është mëkat i madh. Përmendja e Allahut apo e ndonjë cilësie të Tij i jep peshë betimit dhe për hir të kësaj duhet që të pranohet fjala e shoqëruar me betim, sidomos kur argumentet mungojnë dhe betimi vjen nga një njeri i drejtë. Buhariu dhe Muslimi na përcjellin se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Isai i biri i Merjemes kishte parë një njeri teksa po vidhte. I kishte thënë atij: A po vjedh? Jo, pasha Atë pos të cilit zot të vërtetë nuk ka - ishte përgjigjur ai. Isai i tha: Unë i besova Allahut dhe përgënjeshtrova syrin tim.”

Llojet e betimit:

Betimet janë tre lloje: a) betimi i paqëllimtë (el-jemin el-legu), b) betimi fundosës (el-jemin el-gamus) c) betimi i plotfuqishëm (el-jemin el-mun’akide)

Betimi i paqëllimtë:

Më lart përmendëm se: nëse dikush betohet te dikush tjetër pos Allahut, mirëpo pa pasur si qëllim betimin, kjo fjalë e tij gjykohet si një mëkat që duhet mënjanuar. Tani kemi një situatë tjetër dhe bëhet fjalë për atë shprehje që ka formën e betimit (në Allahun apo në ndonjë cilësi të Tij), mirëpo nuk thuhet për t’u betuar, por thjesht një fjalë goje me të cilën është mësuar gjuha. Ky betim nuk sjell pasoja dhe detyrime ndryshe nga betimet e tjera, të cilat sipas Legjislacionit Islam në raste kur ato shprehen bëhen detyra që duhet kryer. Këtë do ta sqarojmë më poshtë, kur do të flasim për dy llojet e betimeve, atë fundosës dhe të

“...Për mua më e dashur është të betohem në Allahun rrejshëm, se sa në dikë tjetër me sinqeritet...”

plotfuqishëm.

Betimi i paqëllimtë është i falur nga Allahu i Madhëruar. Ai në Kuranin e Tij thotë: “*Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por ju merr për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër. Allahu është i butë dhe fal shumë.*”⁴, “*Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet e juaja të paqëllimta (për betim), por ju merr për ato që jeni betuar qëllimisht*”⁵ Aishja, radijallahu anha, thotë: fjala e Allahut: “*Allahu nuk ju merr në përgjegjësi...*” ka zbritur për fjalët: vallahi jo, vallahi po...⁶.

Betimi fundosës (ose betimi i rremë):

Është betimi i rrejshëm, i cili nëpërkëmb të drejtat e njerëzve, betim me të cilin synohet mëkati dhe tradhtia. Quhet “fundosës”, ngase e fundos në mëkat pastaj në zjarr atë që e thotë. Konsiderohet prej mëkateve më të mëdha dhe nuk ka shpagim të caktuar, ngase nuk hyn në fuqi. Allahu i Madhëruar thotë: “*Mos i përdorni betimet tuaja për dredhi mes jush, e të rrëshqitni pas forcimit, e ta shijoni të keqen (e dredhisë), për shkak se penguat (të tjerët) nga rruga e Allahut, e ju do të keni dënim të madh.*”⁷ Imam Taberiu duke komentuar këtë ajet mes të tjerash thotë: “Mos i bëni betimet e juaja derë për mashtrim e tradhti, duke u munduar ta siguron palën tjetër, e në fakt fshihni mashtrimin.”⁸ Në lidhje me këtë Ebu Hurejra na përcjell se Pejgamberi,

³ Taberaniu
⁴ Bekare: 225

⁵ Maide: 89
⁶ Buhariu

⁷ Nahël: 94
⁸ Tefsir Taberi: 14/166

sal-lallahu alejhi ue selem ka thënë: “Pesë gjëra nuk ka shpagim për to⁹: shirku, vrasja pa të drejtë, shpifja mbi besimtarin, ikja nga fronti dhe betimi që domosdoshmërisht ia merr pasurinë tjetrit pa të drejtë.”¹⁰

Betimi i plotfuqishëm.

Është betimi i drejtë që bëhet me këmbëngulje për të vërtetuar veprimin apo mosveprimin e diçkaje. Nëse e çon në vend betimin e tij, atëherë s’ka gjë për të, në të kundërtën ai detyrohet me shpagim. Allahu i Madhëruar thotë: **“Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por ju merr për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër...”**¹¹ Shpagimi për thyerjen e betimit është i përcaktuar në Kuranin Famëlartë. Allahu thotë: **“Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet e juaja të paqëllimta (për betim), por ju merr për ato që jeni zotuar qëllimisht. E shpagimi i tij (i betimit të bërë) është duke i ushqyer dhjetë të varfër me ushqim mesatar që ushqeni familjen tuaj, ose duke i veshur ata (të dhjetë), ose duke liruuar një rob. E kush nuk ka mundësi t’i bëjë këto, le të agjërojë tri ditë. Ky është shpagim për betimet tuaja kur i thyni ato. Ruani betimet tuaja. Kështu Allahu ju sqaron dispozitat e veta, ashtu që të jeni mirënjohës.”**¹² D.m.th. kush thyen betimin e tij ai zgjedh mes tre shpagimeve:

1. ushqimi i dhjetë të ngratëve
2. veshja e tyre
3. lirimi i një robi

Nëse nuk mund t’i bëjë këto, atëherë ai agjëron tre ditë, pra, pika e katërt mund të zgjidhet vetëm nëse nuk mund të bëjë asnjërën prej tri të parave.

⁹ Nuk ka shpagim (kefaret) do të thotë: nuk fshihet mëkati i tyre me agjërim, lëmoshë apo lirim robëri-sh, ngase kështu shpaguehet betimi i plotfuqishëm. Kjo nuk mohon faktin, se këto mëkate të mëdha

mund të shlyhen me pendim të sinqertë dhe duke kërkuar falje nga të dëmtuarit.

10 Ahmedi, kurse hadithin e vlerësojnë hasen Sujutiu dhe Munaviu.

¹¹ Bekare: 225

Disa rregulla:

1. Betimi vlerësohet në bazë të nijetit të atij që betohet, d.m.th. kush betohet për diçka, mirëpo dëgjuesi kupton diçka tjetër, vlerësimi bëhet në bazë të nijetit të atij që është betuar, nëse nuk cenon të drejtën e dikujt, përndryshe rregulli themelor është se betimi vlerësohet në bazë të asaj që kupton kërkuesi i betimit, siç ka thënë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*: **“Betimi merret në bazë të nijetit të atij që e kërkon atë.”**¹³ Argument për të parën është rasti që na përcjell Suvejd ibën Handhali, i cili thotë: U nisëm për tek i Dërguari i Allahut e me ne ishte Vail ibën Huxhri, të cilin e rrëmbeu një armik. Unë u betova se ai ishte vëllai im dhe e lëshuan, ndërkohë që të tjerët ngurruan (sepse në fakt nuk ishte vëllai i tij). Kur u takuam me të Dërguarin e Allahut dhe i treguam për ngurrimin e tyre dhe se unë isha betuar se e kam vëlla, më tha: **“Ke thënë të drejtën, muslimani është vëlla i muslimanit.”**¹⁴

2. Është i falur ai që e thyen betimin e tij gabimisht ose në harresë, Allahu i madhëruar thotë: **“Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë”.**¹⁵

3. Nëse ndonjëri gjatë betimit bën përjashtimin, duke thënë “inshaAllah – nëse do Allahu”, për të nuk ka thyerje betimi. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: **“Kush betohet për diçka duke thënë “nëse do Allahu” është i lirë ta përmbushë betimin apo ta lërë atë.”**¹⁶

4. **“Kush betohet për një gjë, pastaj sheh diçka më të mirë, le ta bëjë më të mirën dhe le të shpaguej betimin e tij të parë.”**¹⁷

5. Kush betohet se do t’ia ndalojë vetvetes diçka që e ka të lejuar, ajo gjë nuk i ndalohet dhe betuesi ngarkohet me shpagim. ■

¹² Maide: 89

¹³ Ibën Maxhe, sahih

¹⁴ Ibën Maxhe, sahih

¹⁵ Bekare: 286

¹⁶ Ibën Maxhe, sahih

¹⁷ Muslimi



PROPOZIME KREATIVE

E kaluara ka shkuar dhe ka ikur, ndërsa ne tani jetojmë në një ditë të re, që i ka karakteristikat dhe prurjet e saj të reja. Shpreso dhe mendo mirë vazhdimisht.

PËRMBLODHI: AGRON TERZIQI

1. Si qëndrojnë raportet e tua me Allahun, cili është preokupimi yt kryesor gjatë ditës?
2. Nëse dështon, atëherë mos u dëshpëro, por përkundrazi kremto, ngase mossuksesi në fillim të çfarëdo projekti gjithsesi në mbarim përmban një përfundim të suksesshëm.
3. Parashtroja vetes këtë pyetje: “Çfarë mund të bëj tani, që nëse e bëj rregullisht do të ketë ndikim të dobishëm dhe me vlerë në jetën time?”
4. Suksesi dhe dështimi qëndron në mendjen dhe intelektin tonë. Në jetë nuk ekziston diçka që quhet e pamundur, kjo ekziston vetëm në mendjen e të falimentuarve. Kur të ballafaqohesh me ndonjë detyrë mbështetu tek Allahu dhe thuaj; mundem ta kryej... e thjeshtë... e lehtë....! Pra, për njerëzit e suksesshëm konsiderohet diçka e mundur për t'u realizuar, ndërsa për dështakët e pamundur.
5. Çdo pengesë para suksesit tënd konsideroje sfidë.
6. Në shumicën e rasteve ti je rezultat i mendimeve dhe i botëkuptimeve të tua.
7. Njerëzit e suksesshëm janë optimist. Optimizmi përbën një përqindje të konsiderueshme të suksesit. Shumica e njerëzve të suksesshëm nuk mendojnë për të kaluarën dhe problemet e saj. E kaluara ka shkuar dhe ka ikur, ndërsa ne tani jetojmë në një ditë të re, që i ka

- karakteristikat dhe prurjet e saj të reja. Shpreso dhe mendo mirë vazhdimisht.
8. Vetëm ti je përgjegjës për të gjitha veprimet dhe botëkuptimet e tua.
 9. Shembulli ynë në këtë botë është sikurse shembulli i bujkut, sepse atë që mbjellim sot do ta korrim në të ardhmen. Prandaj, medito se a je vërtetë duke mbjellë në mendjen tënde mendime të frytshme? Zëvendëso mendimet e dështuara dhe të pashpresa me mendime të mira dhe produktive. Përse të mos synosh që shprehjet negative, të cilat i ke bërë zakon t'i përdorësh t'i transformosh në fjalë frytdhënëse dhe kështu do të vësh shumë shpejt në jetë efektin e tyre pozitiv. Bëhu prej atyre që i kontrollojnë mendimet dhe fjalët e tyre.
 10. Injoro dhe braktis ata persona që në mënyrë të përsëritur deklarojnë: e parealizueshme, e vështirë, e pamundur etj. Dije se ai që i thotë këto fjalë është injorant, ngaqë me lejen dhe ndihmën e Zotit çdo gjë është e mundshme.
 11. Varësisht prej sasisë së angazhimit dhe preokupimit tënd rreth një çështjeje, me dëshirën e Zotit do të arrish suksese dhe rezultate të caktuara. Të suksesshmit pas mbështetjes në Allahun dhe mendimit të mirë në Të, besojnë në aftësitë e tyre dhe kanë vetëbesim të lartë.
 12. Që të ndryshojnë të tjerët dhe rrethi ku jeton lipset që së pari ti të ndryshosh.
 13. Nëse përqendrohesh në kërkim të zgjidhjes, nëse mendja jote pyet për zgjidhjen, me lejen e Zotit do ta gesh zgjidhjen e duhur. Në të shumtën e rasteve ne e arrijmë atë që përqendrohemi në të.
 14. Përmes të menduarit për suksesin ti ke gjasa më të mëdha që t'i zbulosh edhe mënyrat e duhura që të çojnë drejt zgjidhjes finale. Një gjë është e përbashkët gati për të gjithë njerëzit e suksesshëm, se ata gjithmonë mendojnë dhe meditojnë për suksese dhe për arritje. Ata kanë një moto, se çfarëdo përvoja që përfundon me mosrealizim të kënaqshëm është një hap i rëndësishëm drejt një suksesi të madh, ngase për ta nuk ekzistojnë veprime të dështuara, por vetëm përvoja.
 15. Ngulmi mund të përkthehet thjesht edhe si sukses paraprak. Këmbëngulja dhe zelli çojnë drejt shumë zgjidhjeve të reja dhe kreative.
 16. Ai që është më fleksibël është edhe më i suksesshëm me veten dhe të tjerët. Prandaj ji fleksibël.
 17. Çdo gjë fillon me hapin e parë. Dyshimi dhe hezitimi janë pengesat e para që shfaqen në rrugën e suksesit.
 18. Forca jote kryesore pas besimit tek Allahu i Madhërishëm prehet në fuqinë e vullnetit, durimit dhe të mundësisë së kalimit të pengesave për të hulumtuar dhe testuar mundësitë e ndryshme, gjersa të arrish të gesh zgjidhjen e artë për vete dhe për të tjerët. Ai që zotëron vullnet, ai zotëron edhe fuqinë.
 19. Mendo për përvojat e tua të suksesshme dhe shkruaj me saktësi, se çfarë dëshiron të arrish në ditën e sotme.
 20. Askush nuk ka mundësi të ndikoj tek ti vetëm nëse ti personalisht e pranon një gjë të tillë.
 21. Mos shkatërro asgjë para se të jesh i përgatitur për të ndërtuar diçka më të mirë në vend të saj. Ku qëndron dobia të prishësh një pallat e të ndërtosh në vend të tij një tendë?
 22. Mos u merr me atë që ke punuar në të kaluarën, por preokupohu me atë se çfarë do të bësh sot dhe në të ardhmen.
 23. Kujdesu çfarë po sheh, çfarë po dëgjon dhe po lexon. Kushtoji kujdes ushqimit shpirtëror duke falur namaz, duke u lutur, agjëruar dhe duke u përkushtuar në adhurim në pjesën e tretë të natës, atëherë kur Allahu Fuqiptotë zbret në qiellin e

kësaj bote dhe pyet: a ka kush ndonjë kërkesë që t'ia plotësoj...

Ushqeje shpirtin me leximin e Kuranit dhe librave të dobishëm. Caktoji vetes një orar të veçantë për të dëgjuar dhe lexuar libra, që lidhen drejtpërsëdrejti me avancimin tënd personal.

24. Medito rreth jetës së njerëzve të suksesshëm dhe do të mësosh, se që të gjithë janë ballafaquar me pengesa të shumta gjatë rrugëtimit të tyre drejt suksesit. Madje ndoshta ata që më së shumti kanë tentuar e dështuar janë më të suksesshmit dhe më të pasurit. Në jetë dështimi konsiderohet një shkollë mahnitëse për të gjithë ne, sepse prej tij mësojmë, durimin, ngulmin dhe mësimin nga gabimet.
25. Hezitimi dhe frika nga marrja e vendimeve, përballja me probleme, të folurit para publikut janë sëmundje me ndikime fatale. Ka ardhur koha që me vetëbesim të ballafaqohesh me çdo sfidë që ke përpara. Vetëbesimi dhe frika nuk mund të qëndrojnë në një vend në jetën e askujt. Ti je trim, nismëtar, i guximshëm dhe iniciator.
26. Të gjithë liderët, kolosët, administruesit dhe mendimtarët, të cilët kanë udhëhequr popullin kanë pësuar disfata. Dallimi i vetëm ndërmjet këtyre dhe dështakëve është se ata pas dështimeve i kanë marrë përsipër përgjegjësitë dhe u ngritën në shkallët e suksesit duke pyetur veten: "Çfarë kërkohet prej meje që të veproj për të arritur..." Ndërsa dështakët qysh në disfatën e parë tërhiqen dhe zbrapsen, dhe nuk e kanë më kurajën dhe guximin që të tentojnë sërish.
27. Mos i cakto zgjidhjes së problemit tënd vetëm një alternativë, por mendo dhe vendos më shumë se një zgjidhje, sepse si do të veprosh nëse mundësia jote e vetme të mos funksionojë? Çfarë do të ndodhë,

“Mos shkatërro asgjë para se të jesh i përgatitur për të ndërtuar diçka më të mirë në vend të saj...”

- nëse rrethanat do të ndryshonin? Cili do të jetë reagimi yt? Prandaj gjithmonë mendo për më shumë se një zgjidhje dhe mos harro që t'i shkruash ato në letër.
28. Ai person që nuk ka një synim të caktuar madhor është njeri i humbur. Shembulli i tij është sikurse shembulli i anijes, e cila lundron në oqean pa busull.
 29. Të shumtë janë ata që pretendojnë se dinë gjithçka dhe kur ballafaqohen me ndonjë problematikë rreth së cilës nuk kanë njohuri tregojnë mendjemadhësi ndaj së vërtetës dhe veprojnë me hamendje. Nëse ke guximin dhe dëshirën të arrish deri te zgjidhjet kreative prano së pari para vetes se nuk di aq sa duhet, porse ke nevojë për njohuri më të shumta. Ky miratim konsiderohet fuqi për ty dhe për të tjerët. Ky lloj pranimi do të kontribuoj dukshëm që t'i të përparosh dhe të bëhesh i dijshtëm për t'u njohur me zgjidhjet përmes kërkimit të dijes dhe njohurive shkencore.
 30. Nëse dëshiron t'i përfitosh të tjerët, nëse ke dëshirë që të gëzosh popullaritetin te njerëzit, nëse synon që të ecësh në rrugën e gjetjes së zgjidhjes, atëherë zbulo te njerëzit anët e tyre pozitive dhe inkurajoj, lavdëroji dhe uroji për to, e më pas bëju një kritikë konstruktive kur të jeni vetëm. Askush nuk ka dëshirë që të kritikohet në prani të të tjerëve, sepse njeriu është qenie emocionale dhe gjakësor nën lëkurë. Lavdëro, uro dhe përgëzo e pastaj kritiko e përmirëso.
 31. A e ke kapur lapsin në dorë për të shkruar çfarë dëshiron të arrish sot. Nëse e bën një

gjest të tillë shprehi, atëherë kjo me lejon e Zotit do të ndikojë që jeta jote të ndryshojë për të mirë, ku do të çojë në realizimin e synimeve të tua.

32. Mendo, medito dhe pyet cilët janë ata persona, me të cilët unë po shoqërohem më shumë? Sa është përkushtimi i tyre ndaj fesë? Çfarë është të menduarit e tyre? Cili është perceptimi i tyre për jetën? Si ndihem unë kur dëgjoj fjalët dhe mendimet e tyre? Nëse zbulon se disa prej tyre nuk të inkurajojnë dhe nuk të frymëzojnë fare, mirëpo vetëm ndikojnë në vonimin tënd drejt suksesit, atëherë cila është arsyeja që të detyron të vazhdosh të qëndrosh me ta? Ndeja me çfarëdo personi që përhap informata negative dhuron pesimizëm dhe ndikon për keq në të menduarit tënd, duke t'i mbyllur dyert e zgjidhjeve, është humbje. Prandaj përcakto se kush janë ata dhe largohu prej tyre psikikisht dhe fizikisht. Mendo për njerëzit e devotshëm, për kolosët e këtij umeti dhe rri me njerëz të suksesshëm, të garantoj se shumë shpejt do ta vësh dallimin.
33. Përcilli me kujdes arritjet e tua ditore dhe do të arrish sukses me një shpejtësi të madhe. Vijimësia e pandërprerë është prej çelësave të suksesit.
34. Nëse për një punë shpenzon mundin maksimal dhe papritur ndodh diçka e pakëndshme, e cila ndikon që punët të mos ecin për së mbari, mos e qorto dhe mos e mallko veten, por thuaji fjalë shpresëdhënëse dhe inkurajuese, si p.sh. Allahu kështu ka caktuar dhe atë që ka dashur ka vepruar, të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi.
35. Optimisti i gjen dyert e zgjidhjes gjithmonë të hapura para vetes. Liderët kanë arritur që të qëndrojnë stoikisht para sfidave të jetës, ndërsa vështirësitë që i kanë hasur gjatë rrugëtimit të tyre i kanë

“...Nëse veprimtaria jote është në përputhje me kënaqësinë e Allahut, pse atëherë të ekzistojë droja dhe frika prej njerëzve. Nisu qysh sot dhe thuaje qartë atë që dëshiron, ngase Zoti ty të krijoi të jetosh i lirë...”

shndërruar në raste dhe mundësi.

36. Nëse je plotësisht i bindur se ke të drejtë, atëherë prej kujt frikësohesh? Nëse veprimtaria jote është në përputhje me kënaqësinë e Allahut, pse atëherë të ekzistojë droja dhe frika prej njerëzve. Nisu qysh sot dhe thuaje qartë atë që dëshiron, ngase Zoti ty të krijoi të jetosh i lirë.
37. Askush nuk mund të jetë i lirë plotësisht përderisa nuk bëhet i sinqertë dhe besnik ndaj vetes.
38. Ti je rezultat i asaj çfarë mendon, sjellja jote është produkt i mendimeve të tua, nëse sheh dikë duke qeshur dhe është i lumtur dije se mendimet e tij të brendshme janë pozitive. Ndrysho të menduarit tënd në drejtim të sferës së shpresës, optimizmit dhe zgjidhjes, kjo me dëshirën e Zotit do të reflektohet dhe kthehet në sjelljet dhe raportet e tua me të tjerët, duke të ofruar rehati dhe sukses.
39. Nëse një mendim mund të ndikojë, që të sëmuresh, atëherë ka mundësi gjithashtu të veprojë, që të ndihesh i shëndetshëm.
40. Ai që në jetë ka më shumë armiq se sa miq, le ta kontrollojë mënyrën e të menduarit të tij. ■


PREZANTIM I LIBRIT:

PRIJËSI I DREJTË DHE ASKET OMER BIN ABDULAZIZ

Ai nuk i honepste njerëzit që nuk punonin, qofshin këta edhe njerëz të ditur dhe nga ana tjetër ai i ndihmonte dijetarët nga arka e shtetit dhe nuk i linte ata në mëshirën e njerëzve.

SHKRUAN: GENC PLUMBI

Libri “Prijësi i drejtë dhe asket Omer bin AbdulAziz” me autor të madhin e letrave islame Ibën Xheuzin, nuk është tjetër veçse një përpjekje e autorit për të hedhur pakëz dritë mbi figurën e të ashtuquajturit me të drejtë, si Kalifi i Pestë i Drejtë. Themi pak dritë për arsye se figura e Omer ibën AbdulAzizit përfaqëson liderin e gjithëpranuar nga miqtë dhe armiqtë, nëpërmjet të cilit Allahu i dha mundësinë njerëzve në përgjithësi dhe muslimanëve në veçanti, që të njihen në praktikë dhe nga afër me drejtësinë dhe mëshirën që përcjell Islami. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, kur dihet se Omer ibën AbdulAzizi rrjedh nga një familje fisnike, si ajo e kalifit të madh Omer ibën Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur me të) dhe që në figurën e tij prej lideri përfshihen shumë virtyte dhe cilësi, që i jepnin atij mundësinë për të mbartur barrën e Islamit, pavarësisht moshës së tij të re. Për këtë arsye autori –Allahu e mëshiroftë– është përqendruar tek këto cilësi dhe virtyte, të cilat të gjitha së bashku krijuan figurën madhore të Omer ibën AbdulAzizit, e cila edhe pse në një kohë të



largët prej sot qëndron shumë afër zemrave të muslimanëve në të gjitha kohët.

Autori e fillon me një njohje të shkurtër me Omer ibën AbdulAzizin dhe prejardhjen e tij, ku vihet theksi në faktin se babai i tij ishte Asimi, i biri i Omerit dhe nëna e tij ishte vajza që e ndaloi nënën e vet të përziante qumështin me ujë nga frika se Allahu po i shihte. Kjo në vetvete do të thotë se Omeri ibën AbdulAzizi ishte një fëmijë që lindi nga një familje që e donte dhe e respektonte drejtësinë, dhe mbi të gjitha i ruhej Allahut nga padrejtësitë. Më tej autori vazhdon me rininë e Omer ibën AbdulAzizit, e cila karakterizohej në fillim nga shkujdesja, pëlqimi i rrobave dhe i aromave të mira, por që më vonë ndryshoi tërësisht rrjedhën e jetës së tij duke iu përkushtuar dijes, gjuhës arabe dhe qëndrimit me dijetarët. Autori bën edhe dallimin mes kësaj periudhe dhe periudhës kur Omer ibën AbdulAzizi mori kalifatin, ku vihet re shumë qartë thjeshtësia dhe përkushtimi i Omerit për botën tjetër, si dhe përpjekjet e tij për t'i qëndruar larg

dëshirave të kësaj bote.

Një karakteristikë tjetër e Omerit ishte edhe gatishmëria e tij për t'u këshilluar me njerëzit e dijes, një cilësi kjo tepër e theksuar e udhëheqësve muslimanë. Gjithashtu Ibën Xheuzi, si një njohës i mirë i shkencës së hadithit, na tregon edhe një anë tepër fisnike të Omer ibën AbduAzizit, që ishte përcjellja e haditheve të Profetit nëpërmjet një grupi të njohur sahabesh dhe tabi'inësh, siç është Ibën Omeri, Ibën Ebi Seleme, Ubade ibën Samit, Mugira ibën Shube, Aishja dhe të tjerë. Ibën Xheuziu tregon se përpara se të merrte detyrën e kalifit, Omer ibën AbduAzizi kishte kryer me nder dhe drejtësi shumë detyra të tjera, siç ishte administrimi i Medinës, Mekës, Hixhazit dhe Taifit. Pas marrjes së kësaj detyre Omer ibën AbduAzizi shfaqti një thjeshtësi të madhe. Si një lider i madh Omer ibën AbduAzizi në një hytbe të vetme parashitri qëllimet dhe objektivat e kalifatit të tij. Gjithashtu autori tregon se Omerit nuk i pëlqenin debatet e kota në fe, madje ai i kritikonte ashpër ata njerëz të cilët nuk kishin punë tjetër veç debateve dhe polemikave pa dobi. Ai shpesh thoshte: **“Kur të shohësh disa njerëz që distancohen nga të tjerët në çështjet fetare, atëherë dije se ata po themelojnë një humbje.”**

Një nga metodat efikase që përdorte për të orientuar dhe për të udhëzuar njerëzit ishte këshilla nëpërmjet letrave. Ai këshillonte nëpunësit e tij për drejtësi me njerëzit dhe u fliste ashpër atyre që përpiqeshin ta përdornin pushtetin e tyre për të përfutur apo për të bërë padrejtësi. Në libër autori sqaron faktin se drejtësia e Omerit, edhe pse për një periudhë shumë të shkurtër kohore prej 2 vjet e gjysmë, pati ndikimin e saj në mbarëvajtjen e jetës së tyre në aspektin e sigurisë, begatisë dhe marrëdhënieve mes njerëzve.

Ibën Xheuzi shfaq edhe një aspekt tjetër të rëndësishëm në jetën dhe suksesin e Omer

“Gjithashtu autori tregon se Omerit nuk i pëlqenin debatet e kota në fe, madje ai i kritikonte ashpër ata njerëz të cilët nuk kishin punë tjetër veç debateve dhe polemikave pa dobi...”

ibën AbdulAzizit, që është kujdesi i tij i jashtëzakonshëm për të ruajtur dhe mirë-administruar pasuritë e muslimanëve. Ai e ndalonte familjen e tij, që të përfitonin nga të ardhurat e muslimanëve, apo që të përdornin mjetet e shtetit. Për të arritur diçka të tillë ai emëronte njerëzit e duhur, që i frikësoheshin Allahut për gjithçka, e vogël apo e madhe goftë, haptazi apo fshehurazi, të cilëve ai u kërkonte llogari për çdo qindarkë. Gjithashtu Omer ibën AbduAzizi ishte një gjykatës i drejtë, i cili nuk mbante anën e asnjë pale. Për të i varfri ishte i fortë derisa të merrte hakun e tij dhe i pasuri ishte i dobët, derisa të merrte ndëshkimin e merituar për padrejtësitë e tij. Një nga veprat e mëdha që arriti të bënte Omeri në pak kohë ishte ngritja e arsimit dhe afrimi i njerëzve me dijen fetare. Ai dërgonte dijetarë dhe mësues në të gjitha anët për t'i mësuar njerëzit. Gjithashtu Omeri ibën AbduAzizi ishte një njeri që e donte dhe respektonte punën. Ai nuk i honepste njerëzit që nuk punonin, qofshin këta edhe njerëz të ditur dhe nga ana tjetër ai i ndihmonte dijetarët nga arka e shtetit dhe nuk i linte ata në mëshirën e njerëzve. Ai e urrente që njerëzit të ushqeheshin nga harami dhe i dënonte rëndë njerëzit që pinin verën, e cila ishte kthyer në një nxitëse të gjakderdhjes, imoralitetit dhe trazirave. Ai gjithashtu jepte lëmoshë aq shumë, sa shpeshherë vinte në vështirësi familjen e tij, edhe pse ishte kalifi i muslimanëve. Omeri gjithmonë sillte në

kujtesë Ditën e Gjykimit dhe qëndrimin e tij para Allahut dhe kjo e ndihmonte atë që të tregohej i drejtë me njerëzit edhe në raste zemërimi, apo atëherë kur dikush i bënte padrejtësi.

Siç na e përcjell Ibën Xheuzi –Allahu e mëshiroftë- Omerit i pëlqente që të merrte këshilla nga Hasan Basriu për shumë aspekte të drejtimit të muslimanëve. Gjithashtu ai merrte këshilla edhe nga dijetari i madh Tavusi dhe Ibën Ed’hemi. Omerit nuk i pëlqenin njerëzit servilë dhe përfitues, qofshin këta funksionarë apo poetë, të cilët i thurnin lavde të tepruara për ndonjë përfitim të pavlerë, por gjithmonë ai zgjidhte ata njerëz që fjala u kishte peshë dhe që e këshillonin sinqerisht. Omeri ishte një njeri asket. Në shumë gjëra ai i ngjau gjyshit të tij Omer ibën Hatabit. Atij i ndodhte shpeshherë që të vonohej në ditën e Xhuma për të mbajtur hytben, sepse priste që t’i thaheshin rrobat e vetme që kishte. Në ndryshim nga rinia e tij, rrobat e tij sa vinin dhe bëheshin më të thjeshta dhe më të lira. Miqtë, shokët dhe të afërmit e tij betoheshin se Omeri nuk kishte rroba të tjera përveç atyre që vishte mbi trup. Ai nuk e pranonte mendjemadhësinë brenda familjes së tij dhe gjithmonë i këshillonte fëmijët, që të mos blinin sende të shtrenjta për t’u dukur. Edhe ushqimi i tij ishte tejet i thjeshtë. Aq i thjeshtë ishte Omeri, saqë shpeshherë ai hante hudhra të shtypura me vaj apo thjerrëza. Njerëzit habiteshin nga thjeshtësia e tij, aq sa ishte vështirë ta dalloje në mes të njerëzve të tjerë, se ai ishte kalifi, derisa dikush të fliste dhe ta prezantonte. Ai nuk ngurronte që të ngrihej në këmbë dhe t’i shërbente të tjerëve ose miqve dhe thoshte: “U ngrita si Omer dhe u ula si Omer.” Ai kurrë nuk pranonte dhurata, sepse shpeshherë njerëzit përpiqeshin që nëpërmjet saj të kishin përfitime prej tij dhe t’i fitonin zemrën. Kur ndodhej ngushtë Omeri kërkonte edhe borxh për të mbajtur

familjen. Autori na tregon se Omeri ishte një adhures i madh. Ai kishte një dashuri të madhe për Allahun dhe për Profetin të Tij, Ai e kalonte natën në adhurim dhe shpesh vishte disa rroba të leshta, që i kishte trashëguar nga i Dërguari i Allahut. Ai agjëronte çdo të hënë dhe të enjte. Ai lexonte Kuranin çdo ditë, edhe pse nuk zgjatej. Gjatë adhurimit atij i dëgjohej e qara, derisa i binte të fikët. Ai merrte pamjen e njeriut të heshtur dhe të përulur dhe dukej se të gjitha shqetësimet e umetit rëndonin mbi të. Duke e parë në këtë gjendje shumë njerëzve u vinte keq për të. Shumë prej tyre nuk e kishin parë Omerin të buzëqeshte derisa ndërroi jetë. Omeri gjithmonë këshillonte dhe tërhiqte vëmendjen e veçimit me një grua të huaj. Ai thoshte: “Ki kujdes! Mos u veço me një grua, edhe nëse të thotë vetja se mund t’i mësosh Kuranin.” Omeri gjithashtu ishte një dijetar që përhapte dijen. Ai mbante këshilla dhe mësimë për besimtarët, por gjithsesi ai nuk i ndahej dijetarëve dhe mësimëve të tyre. Ai gjithashtu i nderonte dhe i vlerësonte gratë. Së fundmi, shumë fëmijë të Omerit vdiqën para tij dhe kjo e dëshpëroi shumë. Në fund të jetës së tij Omeri u sëmur rëndë dhe thuhet se i kanë dhënë helm. Para vdekjes së tij Omeri lexoi Kuran derisa sa Allahu ia mori shpirtin. Omeri u varros në një tokë që ia bleu një murgu, i cili kishte dëshirë të madhe që t’ia dhuronte atë tokë Omerit, por ai refuzoi dhurimin.

Shembulli i Omer ibën AbdulAzizit është një pishtar, i cili do të ndriçojë sa të jetë bota rrugën e muslimanëve në udhëtimin e tyre në jetën e dynjasë. Ai do të mbetet një shembull i përkryer i forcës që i jep Islami njeriut për të ruajtur të drejtat që i takojnë Allahut dhe të drejtat që u takojnë krijesave. Lusim Allahun që ta përfshijë Omerin në mëshirën e Tij të pakufishme. Gjithashtu edhe autorin e këtij libri, të madhin Abdurrahman ibën Xheuziun. ■

FËMIJËT DHE GURBETI

Prindi që e kupton rrezikun që i kanoset fëmijës së tij duhet të angazhohet që fëmija të edukohet me frymën islame, ngase ai është shpëtimi i vetëm që të mos devijojë, apo të asimilohet fëmija.

PËRGATITI: ENVER AZIZI

Duke pasur parasysh se një numër i madh i popullit tonë është shpërndarë nëpër vende të ndryshme të botës për të siguruar jetën e tyre materiale ata kanë tërhequr me vete edhe familjet e tyre. Një gjë duhen ta kenë parasysh ata, se kudo që të jenë nuk përjashtohen nga detyra, e cila janë të detyruar për kujdesin dhe edukimin e familjes së tyre. E parë nga ky prizëm shohim se një numër i madh i tyre e kanë neglizhuar një gjë të tillë, duke u arsyetuar se jetojnë në një mjedis, i cili kujdeset për fëmijët e tyre si në aspektin e arsimimit ashtu edhe në atë të edukatës. Por, nuk janë të vetëdijshëm se ata jetojnë nën hijen e një sistemi, i cili është i materializuar tërësisht. Kjo gjë i ka detyruar ata t'i dorëzohen situatës. Mirëpo prindi që e kupton rrezikun që i kanoset fëmijës së tij duhet të angazhohet që fëmija të edukohet me frymën islame, ngase ai është shpëtimi i vetëm që të mos devijojë, apo të asimilohet fëmija.

Në këtë shkrim të shkurtër do të



përmendim disa elemente apo kritere, të cilat kurbetçinjtë duhen të lidhen pas tyre.

E para. Jetën e tyre ta lidhin ngushtë me xhamitë ekzistuese atje. Kjo arrihet vetëm atëherë kur u bëhet me dije atyre, se xhamia është vendi më i pastër dhe në të pastrohen njerëzit. Një gjë e tillë mund arrihet duke i marrë me vete në xhami dhe duke i nxitur ata që të dëgjojnë ligjëratat dhe të ndjekin mësimet të cilat zhvillohen aty.

Kjo është metoda profetike e realizuar nga i Dërguari i Allahut, kur shkoi në Medinë. Hapi i parë që ai zbatoi ishte ndërtimi i xhamisë, që në të edukohen njerëzit, të krijohen personalitetet dhe ata të ndihmojnë në procesin e thirrjes në rrugë të Allahut.

E dyta. Nëse ata shkojnë nëpër xhami dhe i mësojnë mirë mësimet e fesë, prindi duhet t'i pyesë rregullisht ata, se a i kanë kryer obligimet e tyre pa u bërë tek ata i urryer dhe monoton, por ai duhet të mundohet që të

kultivojë metodën më të mirë dhe më efikase. Ky është një imperativ hyjnor, ku neve për çdo sfidë që na paraqitet duhet të përdorim urtësinë, që të ballafaqohemi me fëmijën.

E treta. Duke pasur parasysh se ne trashëgojmë një kulturë, e cila është e bazuar në Islam, ata duhet t'i stimulojmë që ta kultivojnë atë kulturë. Atyre duhet t'i bëjmë me dije se Islami ka qenë faktori kryesor për ruajtjen e kulturave njerëzore.

E katërta. Prindi duhet ta përcjellë gjithnjë e të jetë në shoqërinë fëmijës së tij, duke u bërë "antivirus", i cili ia largon shoqërinë e degjeneruar. Kjo sepse shoqëria është elementi më kyç, i cili ndikon në zhvillimin e fëmijës, qoftë në aspektin pozitiv apo në atë negativ. I Dërguari *sal-lallahu alejhi ue selem* thotë: *"Njeriu është në fenë shokut të tij, pra, le të shikojë secili, se me kë po shoqërohet."* Në një thënie tjetër thotë: *"Mos u shoqëro pos me besimtarin, dhe mos ushqe pos të devotshmit."*

E pesta. Prindi nuk duhet t'i mbyllë sytë ndaj fëmijëve të tij për asnjë çast. Ai gjithnjë duhet të jetë në përcjelljen dhe këshillimin e tyre, sepse ai mbart mbi supe detyrimin ndaj tyre. Ky është një imperativ nga Krijuesi i tij, i cili në Kuranin Famëlartë thotë: *"O ju që keni besuar ruani veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..."*. Tahrimë, 6.

Prindi është shtylla e shtëpisë. Ai duhet të pyetet për çdo gjë. Resulullahu *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *"Çdonjëri prej jush është çoban dhe përgjegjës në shtëpinë e tij. Burri është çoban në shtëpinë e tij, e ai është përgjegjës për shtëpinë e tij. Gruaja është çobaneshë në shtëpinë e saj, e ajo është përgjegjëse në shtëpinë e burrit të saj...!"*

SHQIPTARJA DHE MBULESA E SAJ FETARE

do të përpiqemi që në këtë diskutim të ofrojmë disa dëshmi e fakte kulturologjike-historike nga këndvështrimi se si nënçmohet e pse nënçmohet një shqiptare besimtare me mbulesë

SHKRUAN: VALBONA KELMENDI

Kultura dhe qytetërimi Islam është ballafaquar dhe ka përthithur kultura dhe qytetërimi nga më të ndryshmet në pikëpamje nacionale, fetare, gjuhësore madje nga të gjitha hapësirat e globit prej një skaji në skajin tjetër. Mjaft e vështirë është të përcaktohet kontributi dhe merita e popujve muslimanë në formimin, sajimin dhe zhvillimin e kësaj kulture e qytetërimi në botë dhe ndër ne, por për pjesën tonë ballkanike rëndësi të veçantë kanë osmanlinjtë, që njëherësh paraqesin nyjën e fundit në zinxhirin e traditave islame. Megjithatë është gabim i madh shkencor që kultura dhe qytetërimi Islam në Ballkan, të cilësohen si turke dhe t'u përshkruhen turqve, sepse i gjithi ky zhvillim dhe kjo ngritje kulturore e materiale u arrit me anë të Islamit si fe, që është program e sistem



jete.

Të dhënat historike e shkencore tregojnë se lidhjet e popujve ballkanikë, veçanërisht ato iliro-shqiptare me arabët datojnë qysh para erës së re, dhe përkundër rëndësisë që ka bota arabe në përgjithësi dhe roli i fesë në veçanti për fenomenin shqiptar, kjo fushë e gjerë dhe e pasur ka mbetur pothuajse e paprekur deri sot nga institucionet tona. Problemi është i një natyre komplekse sociologjike, etnokulturore, politike e religjioze-ideologjike, si dhe kërkon një qasje interdisiplinare, duke u çliruar nga

paragjykimet dhe pasaktësitë e ndryshme.

Duke u nisur nga niveli dhe gjendja ekzistuese në shoqërinë tonë, qoftë edhe nga ajo shkencore, e cila po përjeton një trysni nga palë të ndryshme gjeneratash edhe në këtë shekull, në vazhdim do të përpiqemi që në këtë diskutim të ofrojmë disa dëshmi e fakte kulturologjike-historike nga këndvështrimi se si nënçmohet e pse nënçmohet një shqiptare besimtare me mbulesë. Me fjalë të tjera, mbulesa nuk është imponim, dhunë, prapambetje, turqizëm, traditë arabe etj., por është bindje ndaj urdhrit të Zotit dhe nder për femrën.

Ky diskutim nuk është i virgjër në hapësirat e plasimit, qoftë ato mediatike, publicistike, debatuese etj., ky diskutim është edhe njëherë mbarështrim për një sqarim shtesë për ata të cilët nuk i njohin vlerat kulturore dhe të vërtetat historike e religjioze, dhe mund të themi se i ftojme që t'i qasen studimeve reale për njohjen e kuptimit të drejtë e pa paragjykime për vlerat e besimit islam, dhe rëndësisë së mbulesës së gruas. Besimi Islam me të vërtetë që është feja, e cila e pastron planetin nga idhujt. I ndalon çoroditjet e nëpërkëmbjet. U garanton të drejta njerëzimit e veçanërisht femrës, e kufizon poligaminë, e ndalon imoralitetin, prostitucionin, forcon lidhjet familjare. Moralin e përgjithshëm e pastron me forcën e pesë shtyllave të fesë, ndërsa tek femra thekson vlerat e larta edhe për mbulimin e saj. Kjo fe nuk i njeh, as mitologjinë, as besëtytninë. Mësimet e saj janë të rëndomta e racionale. I drejtohet arsyes e vetëdijes njerëzore, ku në Kuran thuhet kështu: **“...Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë? Mësim marrin vetëm të mençurit”.** (Zumer: 9)

Zoti ia bëri njeriut detyrim parësor

mësimin dhe përdorimin e lapsit, kurse si kriter vendosi devotshmërinë. E nëse mendja e shëndoshë qëndron në themelet e këtyre parimeve, a do të ishte diçka e pakapshme apo e rëndë, që t'i bindet femra këtij urdhri kuranor: (Nur: 31).? Përveç se ajo zbaton urdhrin hyjnor, tregon devotshmëri ndaj Zotit dhe nga kjo përfiton shkëlqimin e të respektuarit dhe ngritjes morale. Kurani e trajton femrën në mënyrën e duhur: si qenie njerëzore, si nënë, vajzë, fëmijë, si bashkëshorte, si motër, besimtare e singertë, bukuri të xhenetit etj. Pastaj edhe Muhamedi *alejhi salatu ue selam* i ka dhënë rëndësi të madhe të drejtës dhe respektimit të femrës. Të dy këto burime (Kurani dhe Suneti) e shohin femrën si faktor relevant në veprimtarinë shoqërore, në punë, arsimim, në përzgjedhjen e bashkëshortit, në zotërimin e pasurisë vetjake etj.

Trajtimi i femrës në Islam mund të llogaritet i përsosur. Kjo mund të shihet më mirë, nëse i bëhet një vështrim krahasues femrës besimtare dhe asaj jo-besimtare, madje edhe te ne shqiptarët. Për vlerën dhe nderin që meriton të ketë femra, Profeti *alejhi salatu ue selam* thotë: “*Kjo botë është pasuri, kurse pasuria e saj më e madhe është gruaja e mirë.*” Në këtë kontekst neve sot ndodhemi ballë për ballë me një peizazh të çuditshëm. Pse, sepse besimi dhe shoqëria Islame aq shumë e nderon femrën sa s'mund të ndihet kurrë e lënë anash ajo, as edhe për një çast të vetëm, kurse besimet dhe shoqëritë e tjera e nënçmojnë femrën, saqë asaj i duhet të harxhojë mund dhe energji dy herë më shumë se sa normalja vetëm që të dëgjohet zëri i saj e më pas të lë përshtypjen, se po flet diçka të rëndësishme. Në këtë rast do të bëjmë një krahasim.

Profetit Muhamed *alejhi salatu ue selam* një vit iu pamundësua kryerja e

pelegrinazhit në vendin e shenjtë Qabe dhe kjo ndodhi gjatë udhëtimit të disa pelegrinëve medinas për në Mekë. Në vendin ku hasën pengesën nga jobesimtarët mekas Profeti i urdhëroi pelegrinët, që ta përfundojnë aty këtë udhëtim dhe që t'i therin kurbanet e meshkujt t'i qethin flokët (rregull fetare për kryerjen e haxhit). Pelegrinët nuk vepruan menjëherë, dhe Profeti u mërzit, kështu që hyri te gruaja e tij, e cila e këshilloi Profetin që fillimisht ai le të thërë kurbanin dhe të qethë flokët. Profeti mori këshillën e saj, gjë e cila ndikoi që të gjithë shokët t'i therin kurbanet dhe ti qethin flokët.

Në anën tjetër, në ditët tona ndodhin gjëra të çuditshme, kemi pasur rastin që të shohim dhe të dëgjojmë para pak ditësh, se si po “nderohet” e “civilizuara” nga shoqëria dhe nga shtresa më e lartë e një aparati administrativ shtetëror. Nga radhët e deputeteve tona kemi rastin e deputetes parlamentare, që të paktën një herë shpërtheu dhe e nxori vrerin e akumuluar të nënçmimit që po përjeton gjinia femërore nga gjinia e kundërt. Në bisedë e sipër në studio, ajo (Besa Gaxherri-LDD) thotë: “... ne femrat jemi shumë të zonjat, por ne duhet të punojmë dy fish më shumë se sa duhet. Përveç obligimeve familjare, obligimeve ndaj burrit, ne duhet gjithmonë të shkojmë të përgatitura në punë dhe në parlament, për shkak se në radhë të parë nuk na dëgjohet fjala kollaj vetëm pse jemi femra, si dhe nëse e kemi idenë të qëlluar e analizojnë më shumë se sa duhet, e nëse i jep kritika të thuhet: hajt se këtë e ka thënë një femër...”.

Nëse ndodh kështu në shtresën më të lartë të një shteti dhe brenda atyre që s'kanë të bëjnë me fenë, çfarë mund t'ju thonë atyre që janë fetare e me mbulesë? Një gjë tjetër që duhet theksuar është se të

“Mbulesa e çdo besimtareje, po ashtu edhe e asaj shqiptare është nder dhe bindje dhe bartet me nder e me bindje, nuk është dhunë dhe nuk mund të bartet me dhunë...”

gjitha nënçmimet që po përjeton shqiptarja besimtare me mbulesë, i vijnë asaj si shkak se po përballlet me interesat e atyre (jobesimtarëve), të cilët po e shohin si rivale në profesione e lëmi të caktuara. Dhe për këtë shkak nuk po i jepet asnjë hapësirë që ajo të tregojë aftësitë e saja profesionale dhe zotësitë e saj arsimore. Prandaj përveç se është diçka banale është edhe injorancë e thellë të marrë dikush guximin e të thotë, se femra besimtare me mbulesë është e prapambetur, primitive, po e ndryshon identitetin e saj të kulturës, mbulesa e tyre e ka prejardhjen nga turqit, e kanë vënë me para etj...

Këtë banalitete e injorancë të thellë ua hedh poshtë vetë fakti, se në të njëjtën kohë i nënshtrohen provimit, edhe shqiptarja pa mbulesë, edhe ajo me mbulesë, ose mund të jenë në rangun e kolegjalitetit studimor, ku i nënshtrohen provimit njëkohësisht dhe që të dy palët presin rezultatin e tij.

Dua të theksoj edhe një fakt. Nuk mund të mohohet tashmë fakti i kolegjalitetit, i cili pasqyron realitetin e përparimit për një shkollim të lartë të femrës së mbuluar shqiptare, kurse për sa i përket përparimit të tyre edhe në jetën e përditshme, mendoj

dhe them se e dimë shumë mirë të gjithë ne, se në çdo familje ose në çdo fis ka të paktën një të mbuluar brenda rrethit të tyre, kështu që aty mund të gesh modelet e vërteta, të cilat i hedhin poshtë të gjitha shpifjet dhe paragjykimet e mundshme të atyre që me të vërtetë kanë probleme me vetveten dhe vizionin e vet. Kurse shkollimi i çdo njeriu, po ashtu edhe i shqiptares besimtare me shami është një proces, i cili zhvillohet paralelisht nëpër gjenerata, kështu që nuk jemi diçka më ndryshe në parim, përveç rasteve kur rritet e zhvillohet përparimi për shkak të përkushtimit e përkujdesjes individuale. E nëse kësaj ia ka frikën ndokush dhe e shfrytëzon lirinë e tepruar për të shpifur e për të bërë shantazh, themi se sot është e kotë kjo gjë për vetë faktin se gjërat reale dhe gjërat e vërteta nuk ka mundësi t'i përpijë toka apo t'i zhdukë ndokush, por ato do të jenë të lira dhe do ta gëzojnë zhvillimin e tyre në një të ardhme jo të largët, si diçka normale e më shumë se kjo, si e admiruar nga të tjerët.

Për ta përmbyllur me një fjalë, mbulesa e çdo besimtareje, po ashtu edhe e asaj shqiptare është nder dhe bindje dhe bartet me nder e me bindje, nuk është dhunë dhe nuk mund të bartet me dhunë. Është pastërti dhe nuk mund ta njollosë askush, e aq më pak nuk është biznes apo tregti, se sikur të ishte e tillë do të ishte më e falimentuara në sferën e tregtisë e të biznesit, sa që do të kishin ikur të gjithë të irrituar prej saj. Prandaj duhet kuptuar dhe duhet mësuar nga të gjithë, se Islami është feja e parë dhe e vetme që rregullon, përmirëson, garanton dhe respekton të drejtën dhe pozitën e gruas në shoqëri. ■



KUSH E NDEROI KËTË POPULL

“O njerëz, Ne ju krijuam nga një mashkull dhe një femër dhe ju bëmë popuj e fise që të njiheni mes vete. Më i nderuari prej jush tek Allahu është më i devotshmi ndër ju. Värtet Allahu është i Dijshëm dhe i njoftuar mirë”. (Huxhurat 13).

SHKRUAN: OMER BERISHA

Krijuesi i njerëzve i krijoi njerëzit të ndryshëm, dhe nuk i la të jenë vetëm një popull, dhe kjo sigurisht ka urtësinë e vet, përndryshe **“po të donte Allahu do t’ju bënte një popull të vetëm”** (Nahël 97). Në ajetet e sipërpërmendura

Allahu na thërret neve njerëzve të na sqarojë se të gjithë njerëzit janë të barabartë nga aspekti i përkatësisë së tyre, duke na përkujtuar krijimin e parë. Allahu të gjithë njerëzit i bëri nga një shpirt dhe prej tij bëri edhe çiftin e tij. Krijoi Ademin dhe Havanë, *paqja qoftë me ta*, e prej tyre bëri familjet, fiset dhe popujt.

Vullneti dhe dëshira e Allahut ishte që

“...Këtij populli nuk i pëlqen braktisja e Islamit e as mosbesimi. Çdo popull që e bëri këtë gjë e çoi atë në një prapambetje të dukshme...”

të ndodhë kështu, por kjo nuk nënkupton përçmimin e një popullit ndaj popullit tjetër e as epërsinë. Qëllimi i këtij ndryshimi brenda-njerëzor është **“që të njiheni mes vete”**. Pra, secili nga ne ka përkatësinë e tij të pandryshueshme, siç themi: jam biri i filanit nga ai fis e nga ai vend. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Mësojini prejardhjet tuaja që t’i mbani lidhjet familjare, meqë mbajtja e lidhjeve familjare shton dashurinë në familje, rrit pasurinë dhe shton pasardhësit”*. Kështu prezantohemi dhe njihemi me të afërmit tanë dhe me njerëzit tjerë për të shtuar çdo ditë dashamirët dhe miqtë tanë pavarësisht cilit popull i takojnë ata. Çdo njeri duhet të jetë i kënaqur me përkatësinë që ka dhe të mos e lakmojë përkatësinë e tjetrit, se përkatësia fisnore apo kombëtare e njerëzve nuk i bën njerëzit të mirë, apo të këqij, por besimi i pastër dhe punët e mira, të cilat nuk janë monopol i askujt. Këtë e mësojmë nga pjesa e ajetit: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është më i devotshmi ndër ju”**.

Këtë të vërtetë e thekson edhe Muhamedi, *paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të*, duke na thënë: *“Vërtet Allahu nuk shikon pamjet dhe pasuritë tuaja, porse zemrat dhe punët tuaja”*. (Muslimi)

Të qenit i nderuar tek Allahu i Madhërishëm padyshim është një privilegj, që të gëzon pamasë, ndërsa

arritja e këtij privilegji mund të bëhet me pak lodhje dhe duke qenë i devotshëm ndaj Zotit, që nënkupton respektimin e urdhëresave dhe ndalesave të Allahut. Kush e bën më mirë këtë do të jetë më i nderuari tek Allahu, pavarësisht cilit komb i përket dhe cilën gjuhë flet ai. Nderimi nga ana e Zotit d.m.th. përkrahja e Tij për ty në gjithçka, që është e mirë dhe e dobishme, qoftë në këtë botë apo në tjetrën.

Mirëpo dikush e ka keqkuptuar këtë dhe mendon se për të qenë i nderuar apo më mirë të them i integruar në botën perëndimore neve duhet të bëjmë ndryshime rrënjësore te populli jonë në çdo aspekt. Por shumica dërrmuese e popullit shqiptar kanë zgjedhur për fe Islamit dhe tani çfarë duhet të bëjnë për t’u integruar te një popull tjetër? Të zhvishen nga feja dhe traditat e tyre?! Kjo është pamundur, sepse Islami i ka mbushur thellësitë e zemrave të tyre, madje edhe të atyre që deklarohen si muslimanë, por që nuk falin namaz, nuk agjërojnë e as nuk bëjnë haxhillëk. Të gjithë janë të përqendruar në këtë fe, sepse e dinë se kjo fe deri më sot i ka ruajtur nga kthetrat e ndryshme ushtarake dhe ideologjike përgjatë historisë. Këtij populli nuk i pëlqen braktisja e Islamit e as mosbesimi. Çdo popull që e bëri këtë gjë e çoi atë në një prapambetje të dukshme. Kush e injoron këtë, ose është i shkujdesur dhe nuk e di çfarë bën, është partizan i atyre që nuk ia duan të mirën këtij populli.

Pse nuk e marrim për shembull Japoninë, e cila ka synime të qarta për të mbartur zhvillimin perëndimor në vendin e tyre nga njëra anë, por këmbëngulin në ruajtjen e besimeve dhe traditave të tyre nga ana tjetër, ndërsa disa prej nesh hutohen dhe mendojnë të shpikin një identitet tjetër, duke dyshuar a jemi popull

evropian pagan apo shqiptarë muslimanë? Kjo do të na çojë në një situatë pa zgjidhje, sikurse me vozitësin kur një person i thotë shko në të djathtë e tjetri i thotë shko në të majtë, ndërsa vozitësi hutohet dhe mbetet në një vend, nuk mund të shkojë, as prapa, as përpara. Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur nga ai*, ka thënë: “Ne jemi popull që Allahu na bëri krenarë me Islam, kurdo që ta braktisim atë Allahu do të na nënçmojë”.

Qëllimi i ekzistimit të popujve të ndryshëm – siç thamë – është njohja mes tyre, çdoherë që devijohet nga ky qëllim, atëherë do të shkaktohet një nacionalizëm ekstrem, duke e shndërruar kombin që është përkatësi në një komb që do të jetë fe dhe besim, për të cilin do të jetojë, do të luftojë, do të vdesë dhe do t'i përçmojë të gjithë ata që nuk i përkasin atij kombi, sikurse përjetuam në shekullin e kaluar të zezat e nazizmit, fashizmit, komunizmit etj.

“Vërtet Allahu është i Dijshëm dhe i njoftuar mirë”. Allahu di gjithçka për ju dhe është i njoftuar për gjithçka që veproni, ndaj udhëzon kë të dojë, e devijon kë të dojë, e mëshiron kë të dojë, e ndëshkon kë të dojë, e ngre kë të dojë dhe ul kë të dojë, sepse Ai është i Urti, i Dijshmi dhe i Fuqishmi.

Vërtet njeriu është krijesë e bukur dhe e nderuar, Allahu ka thënë: **“Njeriun e kemi krijuar në formën më të bukur”**; gjithashtu: **“Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit”** si dhe shumë ajete të tjera, ku lëvdohet krijesa njeri. Mirëpo nëse ai nuk e njeh Allahun dhe braktis rrugën e drejtë Allahu për këtë njeri do të thotë: **“...pastaj e kthyem në gjendjen më të poshtër”**, përveç nëse i është përmbajtur fesë së Allahut: **“përveç atyre që besuan dhe vepruan punë të mira”**. Ai që devijon nga kjo rrugë s'është më i nderuar tek Allahu: **“Kush e nënçmon Allahun, atë (njeri) nuk**

...Allahu di gjithçka për ju dhe është i njoftuar për gjithçka që veproni, ndaj udhëzon kë të dojë, e devijon kë të dojë, e mëshiron kë të dojë, e ndëshkon kë të dojë...”

do ta nderojë askush”.

Kjo nuk nënkupton që jobesimtarët të mos i thërrasim në Islam dhe t'ua bëjmë të dashur këtë fe, duke ua kumtuar drejt, duke ua dashur të mirën, duke qenë të drejtë me ta, duke mos ju bërë padrejtësi. Allahu i Madhërishëm ka thënë: **“Allahu nuk ju ndalon që ndaj atyre që nuk ju luftojnë dhe nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja të bëni mirë dhe të jeni të drejtë me ta. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë”**.

Kështu na mëson Sheriati Islam, feja jonë e drejtë dhe e mesme, e cila na urdhëron të sillemi me drejtësi ndaj të gjithë njerëzve, qofshin muslimanë apo jo. Ndërsa ajo që e prish gatishmërinë e popullit tonë, dhe shkakton përçarje është pretendimi i dikujt, se Islami është fe e prapambetjes, dhe kështu bën një përzierje të palogjikshme midis Islamit dhe zhvillimit perëndimor, kinse ato kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Nejse, padija bën çudira! Allahu na drejtoftë të gjithëve. ■



ËMBËLSIA E IMANIT

Na përcillet se Enes ibën Maliku ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: “Tri gjëra kush i zotëron ai e ka shijuar ëmbëlsinë e besimit: të jetë Allahu dhe i Dërguari i Tij më i dashur se çdo gjë tjetër, ta dojë njeriun vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë kthimin në kufër, ashtu si e urren hedhjen në zjarr”.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Ky hadith përcillet nga sahabi i nderuar Enes ibën Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të. Ndërsa atë e shënojnë shumë dijetarë në librat e tyre të hadithit, prej tyre do të veçonim: imam Buhariu, nr. 16, 21, 6041 dhe 6941. Muslimi, nr. Nr. 163, 164 dhe 165. Tirmidhiu, nr. 2624, Nesaiu, nr. 5003 dhe Ibën Maxhe, nr. 4033. Pra, ky hadith përmendet në gjashtë librat bazë të haditheve përveç Ebu Davudit që nuk e shënon atë.

Rëndësia e hadithit: Hadithi i lartpërmendur është bazë në kapitullin e tij,

ku përmes tij i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na tregon jo vetëm për besimin, por për ëmbëlsinë e tij dhe si arrihet ajo. Pra, të kesh besim është një gjë madhështore dhe dhuratë e madhe nga Zoti, por ta ndjesh ëmbëlsinë e tij është edhe më madhështore, ngase shumëkush ka besim, por besimi i tij është aq i dobët sa nuk e ka shijuar ëmbëlsinë e tij. Kjo i ngjan njeriut të sëmurë që për shkak të problemeve të tij edhe pse e ha mjaltin atij nuk i duket i ëmbël, jo se mjalti e ka humbur shijen, por i sëmuri për shkak të problemeve të veta nuk e ndien atë ëmbëlsi. Hadithin e lartpërmendur shumë dijetarë e përmendin bashkë me hadithin: “Kënaqësinë e besimit e ka ndjerë njeriu, i cili është i kënaqur me

Allahun për Zot të tij, me Islamin fe të tij dhe me Muhamedin profet të tij.”, ku thonë se këta dy hadithe e plotësojnë dhe shkojnë krahas me njëri-tjetrit.

Komentimi i hadithit:

“Tri gjëra kush i zotëron ai e ka shijuar ëmbëlsinë e besimit”

Fjala “ëmbëlsi” ka si qëllim anën e saj figurative, ngase besimi nuk është diçka që mund të hahet apo të pihet, por me të kuptohet, se njeriu që i zotëron këto tri cilësi ai ndien në veten e tij një kënaqësi, e cila buron nga zemra dhe i ngjan ëmbëlsisë. Ashtu sikurse njeriu kur han diçka të ëmbël dhe pastaj e ndien në vetvete atë ëmbëlsi dhe i vëren në trup gjurmët e saj, ashtu edhe besimtari e ndien në vetvete kënaqësinë e besimit dhe gjurmët e tij. Mirëpo në dallim nga gjurmët e ëmbëlsirës së këndshme, të cilat i ndien vetëm trupi, ëmbëlsinë e besimit e ndien si trupi ashtu edhe shpirti.

“...të jetë Allahu dhe i Dërguari i Tij më i dashur se çdo gjë tjetër”

E tërë Feja Islame ngrihet mbi dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ta duash Allahun është shumë më e vlefshme, se vetëm t'i frikësohesh Atij. Dashurinë e robit ndaj Allahut dhe Muhamedit, *alejhi salatu ue selam*, imam Bejdaviu e komenton me këto fjalë: “Me fjalën ‘dashuri’ është si qëllim dashuria, e cila ngrihet mbi themelet e arsyes dhe të logjikës. Ajo nënkupton t'i japësh përparësi çdo pune, të cilën mendja e shëndoshë e konsideron të arsyeshme, edhe nëse kjo punë është në kundërshtim me dëshirat e epshit trupor. Kjo që përmendëm ngjan me njeriun e sëmurë, të cilit edhe pse nuk ia dëshiron epshi pirjen e ilaçeve të hidhura ai për shkak të arsyeve të shëndosha logjike i pi ato për një dobi më të madhe se kënaqësia e stomakut.” Në momentin që e kupton këtë gjë, atëherë ky besimtar e ndien në vetvete shumë qartë

“...njeriu nuk mund ta dojë tjetrin për hir të Zotit përderisa vetë Zotin akoma nuk ka arritur ta dojë...”

ëmbëlsinë e besimit të tij edhe atëherë kur ndonjë adhurim mund t'i duket i vështirë.

Allahu është vendosur në radhë të parë për shkaqet, të cilat çdo besimtar i di, ngase çdo e mirë është vetëm prej Tij. Ai jep dhe merr, urdhëron dhe ndalon... dhe çdo kush pas Tij është pasues i Allahut dhe i urdhrave të Tij. Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është përmendur së bashku me Allahun jo se ai është i njëjtë me Zotin, por për shkak se ai është shpjeguesi i rrugës së Zotit mësimet e të cilit, nëse nuk ndiqen, sado që të mundohet dikush t'i përkushtohet mësimëve të Kuranit larg Sunetit të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ai prapë do të jetë i devijuar. Jo vetëm kaq por mospranimi i Muhamedit si i Dërguar i Zotit këtij njeriu nuk i vlen besimi në Allahun, sado që mendon se mund ta ketë të sigurtë atë besim tek Allahu. Përveç kësaj që përmendëm, pra, dashurisë së Allahut dhe Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është detyrim edhe dashuria e atyre që e duan Allahun dhe të Dërguarin. Pra, duhet të duam çdo gjë që e do Allahu dhe këdo që Allahu e do dhe këtë dashuri ndaj tyre ta bëjmë vetëm për hir të Allahut.

Në fund të kësaj pike nuk mund të lë pa përmendur edhe çështjen, se respekti i urdhrave të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në Fenë Islame është i domosdoshëm dhe hadithet e tij sipas dispozitave fetare duhet të respektohen dhe praktikohen mu ashtu si urdhrat e përmendura në Kuran nga Allahu. Kjo për arsye se Allahu e shpalli Fenë Islame dhe ia

mësoi njerëzve përmes dy mënyrave, përmes shpalljes tek Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e cila do të shënohet në Kuran dhe pjesa tjetër, e cila nuk do të shënohet në Kuran. Kjo na jep të kuptojmë se këto shpallje në obligueshmërinë e tyre nuk kanë dallim mes vete, sepse që të dyja janë nga Zoti. Gabon rëndë ai që mendon se hadithi burimin e vet e ka nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e asgjë më shumë. Profeti çdo gjë që e ka thënë nuk ka qenë nga mendja e vet, por ka qenë shpallje nga Zoti.

Këtë e përmenda si këshillë për ata që mendojnë se çdo fjalë e ardhur nga Allahu në Kuran është farz, ndërsa çdo fjalë e Profetit është sunet, i cili edhe nëse lihet nuk paraqet ndonjë problem. Ky mendim përveç që është gabim ai është edhe rrezik për besimtarin, sepse e largon nga kryerja e shumë farzeve që janë bazë në fe. Besimtari duhet ta dijë se ka rregulla të përmendura në Kuran, të cilat nuk është farz kryerja e tyre dhe e kundërta ka dispozita në hadith, të cilat janë farz për t'u kryer. Tërë këto që i përmenda, kam si qëllim se rregullat e përmendura në Kuran dhe hadith e kanë të njëjtën vlefshmëri për t'u pasuar nga njerëzit, e argumentojmë me fjalën e lartpërmendur në këtë pjesë të hadithit. Gjithashtu mendimin e lartpërmendur e argumentojmë edhe me fjalën e Allahut: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejojnë punët tuaja”**. (Nisa, 59) Në këtë ajet Allahu, edhe për vete, edhe për Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ka përsëritur veçan fjalën: **“bindjuni”**, ndërsa për njerëzit që udhëheqin punët tona nuk i ka veçuar me fjalën: **“bindjuni”**, ajet ky për të cilin komentuesit e Kuranit thonë se urdhrat e Allahut dhe të Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kanë trajtim të njëjtë në fe për t'i kryer ato, apo për t'i respektuar, ndërsa

urdhrat e udhëheqësve tanë nuk janë të pavarura nga dy të parat, këta të fundit nëse urdhrat i kanë në pajtim me ato të Allahut dhe të Profetit, atëherë duhet respektuar, përndryshe jo.

Fjala në hadith: “ta dojë njeriun vetëm për hir të Allahut”

Në një transmetim tek Nesaiu shtohet edhe fjala: **“ta dojë dhe ta urrejë vetëm për hir të Allahut...”**

Ky është kushti i dytë për ta shijuar besimtari ëmbëlsinë e imanit. Ai që analizon pak në radhitjen e këtyre gjërave njëra pas tjetrës vëren qartë pse është bërë kjo radhitje mjaftë domethënëse. E para, është përmendur dashuria ndaj Allahut dhe Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e pastaj ka ardhur dashuria e të tjerëve për hir të Allahut. Sikur të përmendeshin në radhitje të kundërt, atëherë nuk do të kishte kuptim, pra, njeriu nuk mund ta dojë tjetrin për hir të Zotit përderisa vetë Zotin akoma nuk ka arritur ta dojë. T'i duash të tjerët për hir të Allahut nënkupton që të mos i duash për interesa të kësaj bote, t'i duash pse e duan Allahun dhe të jetë e njëjtë kjo dashuri, si për atë që e njeh, si për atë që nuk e njeh (duke mos përjashtuar faktin se atë që e njeh pastaj mund ta duash edhe për shkak të afërsisë, por duke e pasur dashurinë bazë për të gjithë besimtarët njësoj, e cila thamë se është dashuria për Allahun). Të duash për hir të Allahut do të thotë të duash çdo gjë që Ai e do, çdo gjë që Ai urdhëron për ta dashur, të duash çdo gjë që Allahun e do dhe ta kesh këtë dashuri vetëm për hir të Tij.

Fjala e tij: **“dhe të urrejë kthimin në kufër, ashtu si e urren hedhjen në zjarr”**

Kjo pjesë e hadithit në një transmetim përmendet edhe me shtojcën: **“Të urrejë kthimin në kufër pasi Allahu e shpëtoi prej tij...”**, ndërsa në një tjetër përmendet shprehja: **“Futja në zjarr të jetë më e dashur**

për të, se sa kthimi në kufër pasi Allahu e shpëtoi prej tij”.

Besimtari është në gjendje të hidhet në zjarr vetëm e vetëm ta ruajë fenë e tij, për të është më e lehtë të pranojë të digjet nga zjarri i kësaj bote vetëm që të shpëtojë nga zjarri i botës tjetër. Ai është në gjendje të bëjë gjëra të tilla, sepse e ka kuptuar kush është Zoti dhe Profeti i tij, e ka kuptuar se cila është feja apo mësimi të cilin e urdhërojnë ata të dy.

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*; **“pasi Allahu e shpëtoi prej tij”** në shikim të parë na jep të kuptojmë, se me këtë fjalë është si qëllim vetëm njeriu, i cili ka qenë në kufër e pastaj Allahu e ka udhëzuar. Po kjo është e vërtetë, mirëpo në këtë fjalë në mënyrë indirekte futet edhe ai njeri, i cili kurrë nuk ka qenë në kufër dhe ia ka frikën kufrit. Dijetarët e komentojnë këtë fjali me mendime të ndryshme, ku prej tyre thonë se njeriu, i cili ka qenë në kufër dhe i ka provuar të gjitha haramet, lezetet dhe epshet e kësaj bote e pastaj pasi është udhëzuar e urren kufirin më shumë se hedhjen në zjarr, atëherë personi që nuk është futur në këto haramet dhe Allahu e ka lindur në Islam e ka shumë më të lehtë të ruhet prej tyre. Ka mendimtarë që fjalën e lartpërmendur e kanë arsyetuar me faktin se Profeti kur e tha këtë hadith ishte duke i folur shokëve të tij, të cilët zakonisht kishin qenë në kufër e pastaj u udhëzuan në Islam, prandaj ishte e arsyeshme që t’u fliste atyre për gjendjen që ata e kishin përjetuar. Sido që të jetë këto mendime nuk janë në kundërshtim mes tyre, por të gjitha janë të mundshme, ndërsa ajo që është me rëndësi është fakti se në këtë fjalë hyn çdo gjendje paraprake, e cila është më e lehtë se kufri, si p.sh., mëkatet e mëdha, ato të voglat, bidatet etj.

Dobi të hadithit: Nga hadithi i lartpërmendur do të veçonim disa dobi:

Ta duash Allahun dhe të Dërguarin e Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është puna më e vlefshme në Islam.

Dashuria ndaj Allahut dhe Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ndahet në dashuri e obliguar (farz) dhe e preferuar (mendub). Ajo farz ndaj tyre dëshmohet apo demonstrohet, duke kryer urdhrat dhe duke u larguar nga ndalesat e tyre, kurse dashuria e preferuar dëshmohet përmes kryerjes së suneteve dhe punëve vullnetare (nafile).

Dashuria pa kryerjen e obligimeve fetare është vetëm pretendim i kotë, i cili nuk vlen aspak dhe pretenduesi i kësaj dashurie nuk bën gjë tjetër, veçse është duke mashtruar vetveten.

Hadithi i lartpërmendur përmes tri pikave të cekura në të përmbledh në vetvete çështjet bazë të fesë, të cilat janë:

-Pika e parë aludon në dashurinë e fesë dhe në interesimin për respektimin e saj dhe kjo arrihet duke respektuar Allahun, zbritësin e kësaj feje dhe të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, komentuesin e kësaj feje.

-Pika e dytë simbolizon largimin nga dynjaja dhe dashuria e saj. Pra, çdo gjë të kësaj bote që e duam mos ta duam për asgjë tjetër vetëm se për hir të Zotit.

-Pika e tretë sinjalizon rrezikun e kufrit dhe të xhehenemit, ku përmes kësaj fjalie Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na këshillon duke na dhënë të kuptojmë se zjarri i kësaj bote, të cilin ju e konsideroni shumë të rrezikshëm në krahasim me atë të botës tjetër, i cili është përgatitur për njerëzit e këqij nuk është ai që mendoni ju, prandaj kini kujdes prej mëkateve dhe kufrit, sepse do të bëheni pishman dikur.

Allahu e di më së miri! ■

IRANI, A THUA SA ËSHTË ISLAMIK?



SHKRUAN: DRITON LEKAJ

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

- *Emri i plotë:* Republika Islamike e Iranit.
- *Kryeqyteti:* Teheran.
- *Sipërfaqja:* 1.648,195 km².
- *Banorët deri më 2009 :* 74,196,000
- *Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005):* 1.4 %
- *Përqindja e muslimanëve:* 96 %.
- *Gjuha :* Persiane.
- *Monedha :* Rijal (IRR)
- *Themelimi i parë:* 1906
- *Deklarimi si republikë Islamike:* 1 Prill 1979
- *Anëtar i Kombeve të Bashkuara:* 14 Dhjetor 1955
- *Anëtar i Konferencës Islamike:* 1969



Ana Gjeografike

Republika “Islamike” e Iranit është njëri ndër shtetet e vendosur në perëndim të Azisë. Emri i saj Iran është përdorur qysh nga periudha e Sasanidëve, por është zyrtarizuar në vitin 1935. Emri “Parsi” është përdorur për të treguar aspektin kulturor, ndërsa emri “Iran” është përdorur më tepër për përfaqësim zyrtar. Irani është vendi i tetëmbëdhjetë në botë për nga sipërfaqja, si dhe ka një pozitë të rëndësishme gjeostrategjike për shkak të vendndodhjes së saj qendrore në Euroazi.

Irani kufizohet në veri nga Armenia, Azerbajxhani dhe Turkmenia. Irani gjithashtu ka dalje në detin Kaspik. Kazakistani

dhe Rusia janë edhe fqinjët e drejtpërdrejtë të Iranit në veri. Irani kufizohet në lindje nga Afganistani dhe Pakistani, në jug me Gjirin Persik dhe Gjirin e Omanit, në perëndim nga Iraku, dhe në veriperëndim nga Turqia.

Irani përbëhet nga rrafshnaltat iraniane me përjashtim të brigjeve të Detit Kaspik dhe kufirit me Kazakistanin. Ky është një nga vendet më malorë të botës, peizazhi i tij dominohet nga vargjet malore, të cilat ndajnë basenet e veçanta dhe rrafshnaltat e ndryshme nga njëra-tjetra. Pika më e lartë e Iranit është mali Damavand që arrin 5.610 m, i cili nuk është vetëm maja më e lartë e vendit, por edhe pika më e lartë malore në

tokën Euro-Aziatike, në perëndim të vargmaleve të larta Hindu Kush.

Ana Historike

Historia e kulturës iraniane kthehet mbrapsht në kohë para më shumë se dy mijë viteve, atëherë kur fiset beduine endacake ariane (persiane dhe kurde) u përqendruan në Iranin e sotëm. Irani nuk njohu asnjëherë në këtë periudhë unitetin dhe sigurinë, por u zhyt në luftëra fisnore. Pushtetet e ndryshme, të cilat ndërroheshin njëra pas tjetrit cilësoheshin si tiranike. Në këtë periudhë besimi i popullit ishte Zeradetishtja.

Në vitin 559 para erës sonë Kurshi i Madh themeloi perandorinë e parë persiane, ku bashkoi në të Medianitët, Kaldeasit dhe Ledianët. Pas vdekjes së tij pushtetin e mori djali i tij Kumbuzi, i cili futi nën pushtetin e tij Egjiptin e vjetër dhe kufijtë e perandorisë së tij arritën deri në Maqedoninë e vjetër. Pas tij pushtetin e mori djali i tij Dari i Parë, ku nën udhëheqjen e tij perandoria persiane përfundimisht u bë më e fuqishmja në botë. Më pas vazhduan luftërat me grekët dhe romakët, ku persianët u dobësuan mjaft, por në vitin 226 p.e.s. mbreti Erdeshir i parë themeloi perandorinë sasanide persiane, e cila qëndroi në këmbë, derisa e rrëzuan muslimanët me çlirimet e tyre të mëdha në shekullin e shtatë.

Muslimanët gjatë udhëheqjes së Omer b. Hatabit dhe nën komandën e Sad b. Ebi Vekasit arritën t'i mposhtin persianët në betejën e njohur të Kadisijes dhe kjo hapi rrugën për depërtimin e islamit në Persi. Pas çlirimit nga muslimanët Irani u bë vatër e dijes dhe pikënisje e çlirimeve të tjera islame, edhe pse mbeti në anën tjetër burim trazirash dhe orientimesh të ndryshme fetare dhe filozofike, për shkak të natyrës së tij gjeografike, si dhe historisë së tij të pasur me kultura dhe besime të ndryshme. Iranin e kanë udhëhequr një numër i madh

familjesh mbretërore duke filluar nga: El Muadhafferije, Et Tejmuriye, Es Saffuriye, pastaj El Kaxharije dhe në fund El Dehlevije, të cilën e pati themeluar Rida Shah Ed Dehleviu në vitin 1925.

Ana politike (Rregullimi shtetëror):

Më pas në vitin 1979 revolucioni i udhëhequr nga Homeini, lideri fetar shiit korri sukses dhe përfundoi me rrëzimin e regjimit të Shahut dhe Irani u shpall Republikë Islamike. Udhëheqës suprem në Iran konsiderohet **El Velijjull Fakih**, i cili tashti për tashti udhëhiqet nga Ali Hamenei. Ky institucion është themeluar për të garantuar orientimin shiit të Iranit. Ai udhëhiqet nga Komisioni i Ekspertëve të Udhëheqjes dhe jo nëpërmjet votimit të drejtpërdrejtë. Pas tij vjen kryetari, i cili zgjidhet çdo katër vjet dhe ka të drejtë të rizgjidhet vetëm një herë. Vendimet e tij dhe sistemi iranian në përgjithësi i nënshtrohet Komisionit për mbrojtjen e Kushtetutës. Gjithashtu Irani ka Mexhlisin Shura në të cilin përfaqësohen të gjitha grupet brenda Iranit.

Politika Iraniane dhe zgjerimi shiit:

Kur flasim për Iranin dhe sistemin e tij na duhet patjetër të flasim edhe për drejtimin Shiit. Shiizmi si drejtim i ka fillet e veta tek Abdullah b. Sebe, i cili ka qenë një çifut, që pranoi Islamin me qëllim që ta shkatërronte nga brenda, sikurse veproji Pali me Krishterimin. Ai shfrytëzoi konfliktin rreth udhëheqjes mes muslimanëve dhe fillimisht duke e paraqitur mendimin e tij si politik vazhdoi gjersa pretendoi se Aliu ishte Zoti. Shiitët pas tij u ndanë në shumë grupe dhe orientime, por ajo që i bashkon është lufta e tyre për ta çrrënjësuar Islamin e vërtetë dhe muslimanët. Grupi i "Ithna Asherijje" është grupi më i përhapur shiit, mbi parimet e të cilit është ngritur sot Republika "Islamike" e Iranit.

“Irani duke qenë i udhëhequr nga drejtimi shiit luan një rol shkatërrimtar në rimëkëmbjen e umetit...”

Ndër parimet e tyre më të rëndësishme janë:

Imamati: Ku pretendojnë se udhëheqja është e përkufizuar në pasardhësit e Aliut dhe se pas fshehjes së imamatit të dymbëdhjetë atë e zëvendëson El Velijj El Fekih. Dymbëdhjetë imamëve iu veshin attribute, që nuk i meriton askush pos Allahut të Lartësuar, si: njohja e të fshehtës e të tjera. Besojnë se kur të dalë imami i tyre i dymbëdhjetë do t'i ndëshkojë kundërshtarët e shiave e që sipas librave të tyre janë muslimanët.

Et Tekije: Fshehja e fesë dhe gënjeshtria (shtirja), të cilën e konsiderojnë si një prej parimeve bazë të drejtimit të tyre. Prandaj edhe sot e kësaj dite është vështirë të debatohet me ta, ngase e përdorin gënjeshtren dhe mashtrimin dhe çfarë është më e çuditshmja ata dhe pasuesit e tyre krenohen me të.

Mus'hafi i Fatimes: Ata pretendojnë se ekziston një kopje tjetër e Kuranit, të cilën e kishte Fatimja dhe është në zotërimin e tyre. Edhe pse gjatë gjithë historisë ka mbetur thjesht një pretendim dijetarët e tyre e pohojnë vazhdimisht këtë nëpër librat e tyre, prandaj nuk i duhet vënë veshi atyre që e mohojnë këtë, sepse përdorin tekijen.

Qëndrimi i tyre ndaj Sahabëve të Pejgamberit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), ku besojnë se shumica e tyre janë renegatë dhe librat e tyre janë të mbushur plot shpifje dhe intriga ndaj tyre.

El Mut'a: që ka si qëllim martesën e përkohshme. Kjo është e lejuar tek ata, dhe kështu i ka hapur derën amoralitetit masiv, dhe është një ndër armët e tyre për mashtrimin e muslimanëve të tjerë.

Këto ishin disa nga dallimet mes tyre dhe muslimanëve të tjerë, të cilat i bëjnë të kenë dallime thelbësore në besim dhe jo vetëm në disa çështje të fikhut, siç kanë pretenduar më parë shumë prej atyre, që ftojnë për bashkim mes shiave dhe muslimanëve.

Shiizmi, Irani dhe historia bashkëkohore:

Irani duke qenë i udhëhequr nga drejtimi shiit luan një rol shkatërrimtar në rimëkëmbjen e umetit. Duke u fshehur nën ombrëllën e Islamit dhe mbrojtjes së tij ata kanë arritur të mashtrojnë shumë muslimanë anekënd botës. Ndërsa realisht ata nuk janë asgjë tjetër më shumë se dora e djathtë e çdokujt që ia do të keqen Islamit dhe muslimanëve. Mjafton për këtë të shihen lëvizjet e tyre të fundit në Irak, Afganistan, trazirat e shënuara në shumë shtete islame, shtypja ndaj sunitëve në Iran dhe mund të kuptohet lehtësisht, se të gjitha ato mbesin parulla propagandistike, që përdoren për mashtrimin e muslimanëve të thjeshtë.

Shembujt për këtë janë të shumtë, por mjafton të përmendet se ata pretendojnë se mospajtimi mes tyre dhe Perëndimit është i lidhur në qëndrimin e tyre pozitiv ndaj çështjes palestineze, ndërsa realisht ata vranë me mijëra palestinezë në Liban gjatë luftës civile dhe vranë me qindra sosh dhe persekutuan në Irak, edhe pse statusi i tyre është statusi i refugjatit dhe e tëra kjo është një pjesë e vogël e historisë sonë bashkëkohore.

Gjithashtu Shiitët nuk kanë qenë asnjëherë partnerë të denjë të muslimanëve në rrugëtimin e tyre dhe pjesëmarrja e tyre në kongreset për afrimin me muslimanët nuk është asgjë tjetër vetëm se mashtrim dhe përfitim në kohë për zbatimin e protokollëve të tyre.

Sunitët në Iran:

Informacionet për përqindjen e sunitëve në Iran janë të ndryshme. Sipas statistikave

zyrtare ata përbëjnë 10%, por ajo që është më e saktë është se ata përbëjnë rreth 20% të popullsisë. Ata ndahen në tri nacionalitete: Kurdë, Beluçi dhe Turkmenë.

Gjatë revolucionit të Homeinit edhe sunitët morën pjesë dhe ndihmuan në realizimin e tij, mirëpo pas tij ata u privuan nga të drejtat e tyre themelore. Edhe pse përbëjnë një të pestën e banorëve ata nuk përfaqësohen në qeveri dhe pushtet konform përqindjes së tyre. Ata jo vetëm që janë të privuar nga postet e larta, por edhe prej të drejtave themelore, si xhamitë p.sh., ku Teherani llogaritet të jetë kryeqyteti i vetëm në të cilin nuk ka xhami dhe sunitët detyrohen të falen në hapësirat e ambasadës saudite dhe pakistaneze. Kjo flet mjaft për gjendjen e mjerueshme të sunitëve në Iran.


Shqiptarët dhe Irani.

Shiizmi paraqet edhe një sfidë tjetër për muslimanët shqiptarë. Edhe pse gjeografikisht larg Iranit dhe ndikimit të tij prapë se prapë shqiptarët janë sfiduar nga regjimi i Iranit dhe drejtimi i tij Shiit. Fillimisht duke përmirësuar imazhin e tyre dhe duke iu shmangur realitetit nëpërmjet literaturës së llojllojshme që kanë shpërndarë dhe për këtë shfrytëzuan edhe mendimin e mirë për ta nga ana e “Vëllezërve Muslimanë” mes shqiptarëve. Por në denoncimin e mendimeve dhe orientimit të tyre pas Allahut të Lartësuar rol të madh luajtën Bashkësitë Islame dhe fryma e vetëdijesimit për rolin e Kuranit dhe Sunetit në trojet shqiptare, të cilat ishin të vëmendshme ndaj rolit shkatërrimtar shiit dhe nuk pranuan t’iu nënshtroheshin ofertave të tyre tërheqëse. Shprejsojmë se kjo lloj rezistence do të vazhdojë edhe më tej dhe sidomos kur në kohët e fundit e tërë bota islame është sensibilizuar ndaj veprimeve qëllimkëqija të Iranit në shumë sfera, dhe se në këtë spektri islam shqiptar duhet të jetë i bashkuar dhe i një fjale.

“...Teherani llogaritet të jetë kryeqyteti i vetëm në të cilin nuk ka xhami dhe sunitët detyrohen të falen në hapësirat e ambasadës saudite dhe pakistaneze...”

Ekonomia Iraniane:

Ekonomia e Iranit është e dominuar nga eksportet e naftës dhe gazit, të cilat përbëjnë 50-70% të ardhurave të qeverisë dhe 80% të ardhurave të eksportit ndërmjet 2006 dhe 2008. Gjithashtu ekonomia në masë të madhe i takon sektorit publik, me rreth 60% të ekonomisë së kontrolluar direkt nga qendra dhe të planifikuara nga shteti. Një tipar unik i ekonomisë së Iranit është fryrja e madhe e buxhetit për fondacionet fetare, buxhetet e të cilave së bashku janë sa gjysma e atij të qeverisë qendrore. Rritja e çmimeve të naftës i ka lejuar Iranit të mbledhë një shumë të madhe rezervash, megjithatë kjo nuk ka arritur të lehtësojë vështirësitë ekonomike, të cilat përfshijnë dy sfera atë të papunësisë dhe të inflacionit. Shumë iraniane detyrohen të largohen nga vendi, për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike. Industria iraniane mbështetet kryesisht në fushat, si: prodhimi i makinave, materialeve të ndërtimit, pajisjeve shtëpiake, ushqimeve dhe mallra bujqësore, armatimet, farmaceutikë, si dhe në energji dhe materiale petrokimie. Irani llogaritet për nga rezervat e naftës si vendi i katërt në botë, ndërsa i dyti për nga rezervat e gazit natyror. Gjithashtu ai zotëron edhe një pasuri të madhe në bagëti. ■



NACIONALIZMI DHE RACIZMI NUK KANË PRIORITET PARA FESË ISLAME

NGA: ALI SHABANI

Pyetje: Shpesh na ndodh që në mexhlise të debatohet çështje si: feja apo kombi. Si e shqyrton Feja Islame këtë çështje?

Përgjigje: Së pari, themi se të gjitha këto dilema rrjedhin nga mosnjohja e Fesë

Islame, se ne këtë çështje e shqyrtojmë nëpërmjet Fesë Islame, e jo krahasimi i kombit me fenë pa marrë parasysh se cila është ajo fe. Çdo herë ka ndikime në popull nga rryma të huaja, nga fe të tjera dhe kështu që idetë shekullariste, që feja të ndahet nga jeta e përditshme ka çuar që sot në mesin e muslimanëve të diskutohet,

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

nëse feja vjen së pari apo kombi? Duhet të dihet një herë e përgjithmonë, se feja është para se gjithash, e në prizmin e fesë, d.m.th., të asaj islame shikohet kombi. Allahu është që i ka krijuar njerëzit, racën e tyre, gjuhën e tyre, karakteristikat e tyre e kështu me radhë. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëzit.”*** Rum 22; të gjithë njerëzit e kanë prejardhjen nga Ademi alejhi selam dhe Havaja; dhe prej këtyre të dyve janë shpërndarë njerëzit në popuj dhe fise, kombe të ndryshme, raca të ndryshme. Krijimi i kombit është paraqitur shumë më vonë, ndërsa feja ka ekzistuar shumë, shumë më para kombit. Kur Allahu e ka marrë zotimin prej shpirttrave tanë, pesëdhjetëmijë vjet para se të na krijojë neve dhe na ka thënë: ***“Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuues të vetes së tyre*** (duke u thënë): ***“A nuk jam Zoti juaj?”*** Ata thanë: ***“Po, dëshmuam!”***. Të mos thoni në Ditën e Kijametit: ***“Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur”***. Araf 172, a ka qenë në bazë të kombit, apo të fesë? Nënkuptohej se është bërë në bazë të fesë. Për këtë shkak edhe parashtrimi i kësaj çështjeje nuk është logjik?

Pyetje: A i lejohet muslimanit të mburret me përkatësinë e tij kombëtare duke i nënvlerësuar të tjerët?

Përgjigje: Kjo nuk lejohet në Fenë Islame. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Më i nderuari prej jush është ai që i frikësohet më shumë Atij”***. (Huxhurat 13). Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem ka thënë: ***“O***

njerëz, Zoti juaj është Një, babai juaj është një, dijeni se arabi nuk ka dallim me joarabin, as joarabi me arabin, as i kuqi me zezakun dhe as zezaku me të kuqin, përveçse në devotshmëri”.¹

Në Islam nuk lejohet që të nënçmohen popujt dhe kombet e tjerë. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira, se ato që përqeshin*** (duke e nënçmuar njëri-tjetrin) ***dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë.”*** Huxhurat 11. Me rëndësi është udhëzimi në Fenë Islame, siç ka thënë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem: ***“Më i miri që ka qenë gjatë injorancës, do të jetë më i miri në Islam, nëse e kuptojnë mirë këtë fe”***.²

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem, ndërmjet sahabëve të tij kishte Bilalin, që ishte nga Etiopia me racë të zezë dhe ishte myezini i Pejgamberit. Kishte Selman Farisiun që ishte persian, kishte Suhejb Rumin që ishte bizantin, kishte Abdullah ibën Selamin me prejardhje çifute, kishte gruan e tij Marije Kibtijen, që ishte nga koptët egjiptianë, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë.

Pyetje: Disa e ndiejnë veten më të çmuar vetëm pse i takojnë racës së bardhë?

Përgjigje: Të gjitha këto dallime mes njerëzve Allahu i Madhëruar i ka bërë me urtësinë e Tij të pakufishme dhe askund nuk na ka njoftuar, se raca e bardhë e

¹ Sahih ligajrihi, shih: Sahihu Tergib nr. 2964

² Sahih, shih: Sahihul Xhami nr. 3267

çmon njeriun ndaj racës së zezë, por është diçka tjetër që e dallon njeriun prej njeriut. Këto dallime janë argumente të Allahut rreth të cilave duhet të meditohet.

Në suazat e ajeteve që flasin për këtë temë, i Dërguari i Allahut e ka edukuar gjeneratën e sahabëve. Kur u ligjësuat ezani, Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* e urdhëroi Bilalin ta thërrisë ezanin. Kur u ngjiti Bilali radijallahu anhu ta thërrisë ezanin, e ai ishte etiopian i racës së zezë, Muadhi radijallahu anhu tha: A ky i biri i të zezës do të na thërrisë për në namaz?!... Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* u zemërua shumë dhe i tha: *"Ti, o Muadh, ke ende mbeturina të xhahilijetit"*. Pastaj Muadhi u pendua dhe kërkoi nga Bilali që t'ia falë. Pra, Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* e ka theksuar se ky dallim, nëse shihet si nënçmim, i takon xhahilijetit, injorancës. Islami e dënon këtë lloj dallimi. Po ashtu Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* nuk e ka lejuar që në mesin e muslimanëve të bëjnë dallim sipas racës dhe ka thënë: *"O njerëz, Zoti juaj është Një, babai juaj është një, dijeni se arabi nuk ka dallim me joarabin, as joarabi me arabin, as i kuqi me zezakun dhe as zezaku me të kuqin, përveçse në devotshmëri"*.³

Pyetje: Disa duke e ditur prejardhjen e tyre dhe përkatësinë kombëtare deklarohen se i përkasin një kombi tjetër. Çfarë thotë feja islame për këtë gjest?

Përgjigje: Nuk lejohet që njeriu duke e ditur se i takon një kombi, të deklarohet se i takon një kombi tjetër. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *"Kush thirret në emër të dikujt tjetër përveç*

*babait të tij duke e ditur se nuk është babai i tij, xheneti është haram për të."*⁴, gjithashtu ka thënë *"Kush thirret në emër të dikujt tjetër përveç babait të tij apo thotë se e ka liruar dikush tjetër nga robëria, atij i takon mallkimi i Allahut, i melaqeve dhe i gjithë njerëzve. Allahu nga ai nuk pranon, as farzet, as nafilet"*.⁵ Shejh Uthejmini rahimehullah ka thënë: Njeriu e ka për obligim të identifikohet sipas përkatësisë që i takon, familjes, babait, gjyshit dhe nuk i lejohet të identifikohet me fis tjetër.

Shtojcë: Në këtë shtojcë desha të theksoj një gjë që pas hapjes së kufijve të Shqipërisë, patëm fatin që menjëherë të shkojmë dhe të vizitojmë vëllezërit tanë shqiptarë atje, mirëpo vërejtëm një gjë se ata në Shqipëri nuk na trajtonin si shqiptarë, por na thoshin maqedonas dhe shqiptarëve të Kosovës, kosovarë, e shqiptarët thoshin ata, se janë ata që janë në shtetin e Shqipërisë. A thua vallë, edhe shqiptarët që kanë mbetur në Greqi (Çamëri), duhet të trajtohen si grekë?! Si do të ishte halli po të ishim ne shqiptarët e Maqedonisë nën shtetin e Bullgarisë, e kosovarët, mos të kishin Kosovën? Si do t'i trajtojmë shqiptarët e Preshevës, që jetojnë në shtetin e Serbisë?

Kudo që të jemi, jemi ata që jemi. ■

³ Sahih ligajrihi, shih: Sahihu Tergib nr. 2964

⁴ Sahihul Buhari nr.4326

⁵ Sahihu Muslim nr. 1370

A E PRANUAM ISLAMIN ME DHUNË?



Kthimi i shqiptarëve nga të krishterë në muslimanë është bërë shpesh objekt i debateve publike tendencioze, ku shteti osman është akuzuar për konvertime masive me dhunë nëpërmjet taksave, xhizjes e devshirmesë. Historiografia komuniste i ka shtrembëruar faktet e shtyrë nga një metodologji tejet e politizuar, ndërsa sot akoma ka njerëz që i mëshojnë këtyre shtrembërimeve, po ashtu për arsye të tjera të politizuara

SHKRUAN: ROALD HYSA

Kthimi i shqiptarëve nga të krishterë në muslimanë është bërë shpesh objekt i debateve publike tendencioze, ku shteti osman është akuzuar për konvertime masive me dhunë nëpërmjet taksave, xhizjes e devshirmesë. Historiografia komuniste i ka shtrembëruar faktet e shtyrë nga një metodologji tejet e politizuar, ndërsa sot akoma ka njerëz që i mëshojnë këtyre shtrembërimeve, po ashtu për arsye të tjera të politizuara.

Ndryshimi i strukturës konfesionale (besimeve) te shqiptarët qoftë të veriut dhe ato të jugut, pra, qysh nga Tregu i Ri që është pika më veriore e deri në Artë e në të gjithë Çamërinë ishte relativisht i ngadalshëm dhe mbetet një habi për të gjithë studiuesit për ndryshimet e mëdha, që solli nga ana

demografike për ndjekësit çdo feje. Pas futjes nën sundimin e osmanëve të të gjithë trojeve shqiptare, edhe të atyre pak qyteteve bregdetare që ishin nën kontrollin e venedikasve, u shoqërua natyrshëm edhe me ndryshimin e strukturës konfesionale në të gjithë vendin. Megjithatë na duhet të themi për hir të së vërtetës se sundimi osman nuk ishte ai që solli kontaktet e para me Islamin, që ishte feja dhe doktrina shtetërore dhe ligjore e tyre. Kontaktet me Islamin të shqiptarëve janë shumë më të hershme se kaq dhe ka shumë të dhëna historike. Një nga kontaktet më të hershme dhe që na ve më shumë në mendime është ekzistenca e Xhamisë së Mlikut, e cila sipas një dokumenti të ardhur nga Halepi i Sirisë daton rreth viteve 1205 e deri më 1291¹. Pra, rreth një shekull më parë se të ndodhte, në mos dhe më tepër, Beteja e Fushë-Kosovës dhe të

shfaqeshin turqit osmanë si fuqi e kohës. Sipas disa të dhënave historike kemi edhe rastin e Jakub Shpatës, një nga princat e parë shqiptarë që u kthye e u bë musliman. Hapat e parë drejt islamizimit masiv të shqiptarëve nuk janë bërë prej pushtetit osman, siç mund të paraqitet rëndom nga historianët. Ato janë bërë prej tarikateve të ndryshme, siç mund të përmendim bektashinjtë me Sari Salltëkun në Krujë, në Tetovë Kalkandelët dhe në Janinë teqeja e Sheh Hashimit, të cilët janë vendosur në territoret shqiptare para hyrjes së osmanëve². Duhet pasur parasysh se për të krishterët ortodoksë dhe për muslimanët, integrimi me të krishterët katolikë ishte një poshtërim, rënie në një nivel më të ulët³. Vetë osmanët nuk kishin treguar ndonjë interes të veçantë ndaj prozelitizmit të popullsisë të krishtera, si dhe përjashtimi i konvertimeve me dhunë nga pikëpamja shtetërore, i dha një kuptim të veçantë parullës së ortodoksëve bizantinë “Më mirë çallma turke, sesa tiara papale”⁴. Sipas të gjitha të dhënave historike ndryshimi i strukturës konfesionale nuk ka qenë i shpejtë dhe ndryshime të ndjeshme janë bërë pas më se një shekulli që sundimi osman zuri vend në trojet shqiptare. Ndërkaq me hyrjen e Mehmet Fatihut në Kostandinopojë, ai arriti një marrëveshje me Patriarkun Ortodoks Genad Skolarin, duke sjellë në jetë kështu sistemin e milletit osman, ku fillimisht përfshihehin të krishterët armenë, ortodoksët, hebrenjtë dhe muslimanët. Disa historianë arsyet e konvertimit të shqiptarëve i shohin tek taksa e xhizjes, porse sipas regjistrave të xhizjes, në shek.

XVI në Ballkan nuk kishte më tepër se 300 konvertime në vit⁵. Një numër jo-domethënës ky. Ndërkaq po të ishte kaq e madhe në sasi taksa e xhizjes, osmanët nuk do të kishin asnjë interes për ta konvertuar popullsinë e krishterë, porse do të kishin tendencën për të ruajtur atë gjendje për të vjelë vazhdimisht xhizjen. Ndërkaq në fqinjët tanë ku mbizotëronte ortodoksia dhe marrëveshjet e sulltan Mehmetit u respektuan nga ana e shtetit osman deri ditën kur pushoi së qeni, nuk pati ndryshime të ndjeshme, kjo edhe për meritë të marrëveshjes së osmanëve me Patriarkanën. Kështu në gjysmën e parë të shek. XVI, Arbëria vazhdoi ta ruante fizionominë e saj të krishterë, procesi i islamizimit eci shumë ngadalë, gjë që tregon se qeveria osmane nuk ndoqi dhunën e drejtpërdrejtë për kthimin e të krishterëve në fenë islame dhe në sanxhaqet shqiptare shtëpitë e krishtera përbënin 98.3%, kurse ato muslimane 1.7%⁶. Ndërsa në gjysmën e dytë të shek. XVI kemi nga 84 qytetet kryesore ballkanike në 60 qytetet më të mëdha mbizotëronin ende të krishterët, ku ritme më të shpejta kanë qytetet shqiptare⁷. Ndërkaq feudalë të mëdhenj nuk u detyruan nga osmanët që të kthenin fenë për të ruajtur zotërimet, porse u përshtatën me sistemin e ri të timareve dhe kështu në regjistrat osmanë do të gjesh deri në dy breza të tjerë timariotë të krishterë⁸. Një nga tezat e ngritura prej disa studiuesve është ajo e kthimit me dhunë nëpërmjet sistemit të devshirmesë, ose e thënë më mirë të marrjes së të krishterëve dhe futja e tyre në repartet e jeniçerëve, apo në shkollat e

¹ “Në gjurmët e faltoreve të vjetra”, Fatri Maqellara, Qytetërimi Islam, bulletin periodik, nr. 1/1999, fq. 9.

² Kujtime, v. I (1885-1912), Eqerem bej Vlora, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë 2001, fq. 207.

³ Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar, Jack Le Goff, Botimet Toena – Fondacioni Soros, Tiranë 1998, fq. 182.

⁴ Historia e Perandorisë Osmane, nën drejtimin e Robert Mantranit, Dituria, Tiranë 2004, fq. 283 dhe fq. 285.

⁵ Po aty, fq. 285.

⁶ Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit 1506-1839, fusha fetare I, Petrika Thëngjilli, Tiranë 2002, fq. 25-26.

⁷ Po aty, fq. 38.

⁸ Zgjidhimi kombëtar shqiptar, Stavro Skëndi, Phoenix & Shtëpia e Librit, Tiranë 2000, fq. 18.

larta sulltanore, ku përgatiteshin për të shërbyer në pallatet e sulltanëve, apo të funksionarëve të lartë shtetërorë osmanë. Megjithatë le të shohim se çfarë thonë shifrat, ndërkohë që rekrutimi bëhej një herë në tre vjet ose në shtatë vjet dhe merreshin 1.000-3.000 djelmosha⁹ në të gjithë Ballkanin, ku kishte më tepër të krishterë. Me lejimin nga ana e Sulltan Muratit III në vitin 1582 të shtetasve osmanë të inkuadroheshin në oxhakun e jeniçerëve, pushon së ekzistuari sistemi i devshirmesë. Sipas të gjithë të dhënave historike mesatarja e kësaj takse në vit shkonte 1.000 djem dhe nga fillimi i zbatimit të këtij sistemi në shek. XV e deri në fund të shek. XVI, numri i djemve të krishterë të rekrutuar është ndërmjet 200.000-300.000 vetëve. Pra, siç mund të shihet se edhe kjo tezë e humbet vlerën e vet nga pikëpamja kohore, e sipërfaqes së madhe gjeografike ku kryhej rekrutimi dhe nga pikëpamja numerike, që nuk përbën ndonjë rritje të ndjeshme. Të rekrutuarit e devshirmesë për disa vjet me radhë merrnin një edukim jashtëzakonisht të përzgjedhur nën kujdesin e mësuesve më të mirë, që përfshinte të gjitha disiplinat: sportive, ushtarake, intelektuale dhe artistike. Kjo gjë bëhej me qëllim që ata të përgatiteshin për t'u bërë të përsosur në të gjitha drejtimet, por duke zhvilluar njëkohësisht dhuntitë e veçanta të çdonjërit. Në të njëjtën kohë, ata formoheshin për të marrë përsipër të tëra detyrat shtetërore dhe për t'i kryer ato me frymën e nënshtrimit të plotë dhe të besnikërisë së patundur ndaj sulltanit. Në të vërtetë ata e ndërronin fenë, porse nuk humbnin, përkundrazi përfitonin nga ky sistem dhe i mirëprisnin¹⁰ të dërguarit

osmanë, që merreshin me rekrutimin e tyre. Ndërkaq popullsia e krishterë, veçanërisht ajo katolike, gjendej pa drejtuesit e saj, ose edhe ato priftërinj që ishin, ishin injorantë siç vërehet edhe nga studiues të huaj. Nga ana tjetër serbët nëpërmjet kishës svetisaviane i serbizonin të krishterët katolikë me dhunë, duke ua ndërruar deri edhe emrat dhe po ashtu vepronin edhe ortodoksët grekë, që për nga pikëpamja e milletit nuk përbënin ndonjë ndryshim të madh për sundimin osman, sepse i nënshtroheshin Patriarkanës. Duke u gjendur para presioneve të tilla, ku "...deri në katër mijë frymë të krishtera me një prift të vetëm keqbërës, konkubinar dhe që jep shembull të keq"¹¹, nuk është për t'u habitur se si zona të tëra pak nga pak filluan të islamizohen. Pra, arsyet janë komplekse dhe nuk mund të jenë thjesht ato që janë paraqitur si presion i padurueshëm i të ashtuquajturit pushtim osman. Megjithatë një fakt domethënës është se në vendet e tjera të Ballkanit si grekët, serbët, malazezët dhe rumunët, megjithëse janë fqinjët tanë dhe kanë qenë nën sundimin osman gjithashtu, nuk shihet të ketë pasur konvertime në ndonjë numër të ndjeshëm. Ndërkaq zona të tëra në jug dhe në veri të trojeve shqiptare e kanë ruajtur identitetin e tyre të krishterë, katolik apo ortodoks. Debatit të islamizimit mund t'i sillnim edhe argumente të tjera, porse këto janë ato më kryesoret dhe më të debatueshmet në opinionin publik dhe fundja kaq na lejon kjo sprovë. ■

⁹ Historia e Perandorisë Osmane, nën drejtimin e Robert Mantranit, Dituria, Tiranë 2004, fq. 283 dhe fq. 170; dhe "Histori e Ballkanit", Georges Castellan, Sh.B. Çabej, fq. 117.

¹⁰ Historia e Perandorisë Osmane, nën drejtimin e Robert Mantranit, Dituria, Tiranë 2004, fq. 136.

¹¹ Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, V. III (1603-1621), përg. Injac Zamputi, A.SH.SH., Instituti i Historisë, Tiranë 1989, fq. 37.